

ETIKA



EDUKATA E DHURIMIT
OSMAN NURI TOPBASH



SADIK DANA
RUAJTJA NGA PËRGOJIMI



FATIH OKUMUSH
DHIKRI



MESAZHI I FJALËS SË BUKUR
JASHAR KANDEMIR



GRUAJA E PARË MYSLIMANE
ADEM SARAÇ



MESUT KAJA
SHPËTIMI I MADH



1 Për një Shoqëri të Pirlytyshme

Nëntor 2013

VITI: VII
NUMRI: 68

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR & KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahusa

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

...Drejtësia, matura, toleranca, familjariteti me të tjerët, këmbëngulja dhe vendosmëria, paqedashja, solidariteti, vetëmjaftueshmëria, bujaria, bindja dhe dorëzimi (ndaj Allahut), urtësia, garimi në mirësi, fytyra e qeshur, drejtësia në matje dhe peshim, pjekuria, guximi dhe heroizmi, përshëndetja, mosdëmtimi i të tjerëve, sjellja e mirë, ruajtja e amanetit, urdhërimi për të mirë dhe pengimi nga e keqja, ruajtja e lidhjeve faqefisnore, edukimi fetar i fëmijëve, respektimi i të mëdhenjve, mëshirimi dhe dashuria ndaj të vegjëlve, ruajtja e të drejtave të familjes, bindja ndaj prindërve, larja e borxheve, gostitja e komshinjve, dhënia e borxhit, pajtimi i njerëzve, mbrojtja e nderit dhe namusit, të bësh dua për të tjerët, vëllazëria, miqësia, dashuria, ndihma, të flasësh fjalë të drejta e të vërteta, mikpritja, turpi, ruajtja nga gjynahet dhe devotshmëria, teubeja/pendimi, durimi, tevekkuli/mbështetja në Allahun, modestia, butësia, falënderimi, ruajtja e gjuhës, mbajtja e sekreteve, këshillimi me të tjerët, besnikëria, falja, shoqëria, ruajtja e miqësisë, optimizmi, trimëria, dashuria për atdheun, këshilla, burrëria, pastërtia, dhurimi...

Allahu Tela urdhëron:

"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin." (Ib-rahim, 24-25.)

Ndërsa Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Është një shprehje, e cila rrjedh që prej pejgamberëve të parë dhe që ka ngelur në mendjen e popullit: Po nuk pate turp, bëj ç'të duash!..."

...Ndërsa në një shoqëri, ku është pakësuar ndjenja e mikpritjes, janë dobësuar lidhjet fqinjësore, ka humbur ndjenja e besnikërisë, ku nuk ka falënderim, mirënjohje, e pastërti, ku nuk njihet as i vogli, as i madhi, ku mungon lutja, besnikëria, bashkëjetesa, butësia dhe durimi... një shoqëri frikacake, që i janë këputur lidhjet shpirtërore... dhe i janë shkatërruar ndjenjat e sigurisë, është një shoqëri që i është pakësuar Islami, e shprehur ndryshe, një shoqëri e zhveshur prej virtytit. Ky lloj njeriu dhe kjo lloj shoqërie, po shtohet. Madje edhe shoqëritë islame po i humbasin "pluset" e veta dhe po pësojnë erozion të virtyteve...

...Të pajisesh me një edukatë hyjnore.

Të pajisesh me moralin që ka ndër-tuar shpallja hyjnore.

Të ngjyrosesh me ngjyrën e Pejgamberit (a.s.)...

Thuhet, se "takvaja/devotshmëria", është virtyti themelor. Ndërsa të gjitha virtytet e tjera formohen në gjirin e saj. Takvaja është besnikëria ndaj Allahut, frikë-respekti dhe frika e humbjes së kënaqësisë së Tij... Pra, besimi, me degët dhe lulet e tij...

Përmbajtja



8

Hyni të gjithë në Islam
Hyni të gjithë në paqe!
Prof. dr. Omer Çelik



Edukata e dhurimit
Osman Nuri Topbash

34




12



24

Drita e diturisë
Idris Arpat

- 5 Për një shoqëri të virtytshme
Ahmet Tashgetiren
- 10 Hakmarrja e mjedisit ndaj femohuesve
Xhemal Nar
- 12 Mesazhi i fjalës së bukur
Prof. dr. Jashar Kandemir
- 14 Gruaja e parë myslimane
Adem Saraç
- 16 Pyete zemrën tënde
dhe këshillohu me të
Mustafa Erish
- 19 Thirrje për namaz
Hajredin Karaman
- 20 Varfëria, fanatizmi dhe fetaria e thatë
M. Muhtar esh-Shankiti
- 23 Ruajtja nga përgojimi
Sadik Dana



44

- Të burgosës veten në burgun me qiell të hapur 28
Dr. Adem Ergyl
- A mund të jetë populli burim i pushtetit? 30
Nuredin Nazarko
- Një Ajet - Një Hadith 32
Dhikri 41
Fatih Okumush
- Shpëtimi i madh 44
Mesut Kaja
- "Me u dashtë asht bukur, 49
ama me kenë mik asht tjetër, tjetër gja..."
Imam Muhamed Sytari
- Një jetë për të cilën mund të jepet llogari 52
Xhafer Durmush
- Modestia 54
Prof. dr. Sulejman Derin
- Zoti e pëlqen përsosmërinë 56
Ferid Piku



Mbrojtja e Sunetit është mbrojtje e Kuranit
Said Mermer

42



Drita e Ibadetit
Pabia Christine Brodbeck

49



Për një shoqëri të virtytshme...

Ahmet Tashgetiren

“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.” (Alak, 6-7.)

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve...” (Rum, 41.)

Po jetojmë në kohën, kur njeriu i ka kaluar caqet dhe e ka tepruar. Trazirat kanë pushtuar botën. Tokën dhe detet... Madje këto trazira po kacavirren edhe në qiell me luftën e yjeve...

Trazirat globale po e bëjnë njeriun të paguajë çmime globale...

Sapo njeriu t'i kalojë caqet, fillon dhe shtazërohet, madje bie edhe më poshtë se kafshët. Kjo, sepse njeriu që e përdor për keq vetëdijen, shfaq sjellje të atilla, që edhe kafshët i bën të turpërohen.

“E, kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë...” (Bekare, 205.)

Po, njeriu shkatërron të mbjellat dhe brezat...

Ai ka prodhuar armët më barbare dhe po shkatërron tjetrin... Luftërat po marrin jetët e nënave dhe foshnjave.

Njerëzillëku i njeriut po humbet...

Gjymtyrët po i çnjerëzohen një nga një. Siç shprehet

edhe Mevlana: “Ujqërit, gjarpërinjtë, hienat dhe majmunët brenda njeriut, po fillojnë të dalin jashtë.”

Prishja fillon te njeriu dhe vazhdon te shoqëria... Shoqëritë po tjetërsohen.

Kjo është një masakër vlerash. Erozion virtytsh.

Virtyti e bën njeriun njeri.

Në saje të virtytit, shoqëria fiton një identitet njerëzor.

Njeriu me zemër të mbushur me dashuri, nga njeriu që është tufan urrejtjeje dhe zemërimi, dallon në virtyte. Të turpshmit dhe të paturpshmit, nuk kanë parime të njëjta. Ai që dhuron dhe ai që e shtrëngon dorën, bujari dhe shpërdoruesi apo koprraci, nuk janë të njëjtë. Shpirtmiri dhe i pashpirti nuk shfaqin të njëjtën cilësi njerëzore. Mendoni një shoqëri të pashpirt dhe zemërgur. Si i gjakoset dora! Si egërsohet!

Fjala virtyt, që në gjuhën arabe do të thotë “**fadl**”, si rrënjë, ka kuptimin e “**shtimit, shumimit ose superioritetit**”. Ndërsa, kur përdoret si emër, nënkupton “**të kundërtën e mungesës, mbetje, tepricë ose mirësi**”. Ndërsa në fjalorët klasikë, niveli më i lartë i “**fadl**”-it, është shprehur me fjalën “**fadilet**”.

Fjala “**fadilet**” është përdorur në kuptimin e “**qëndrimit, që e bën njeriun të veçantë dhe superior**”

ndaj të tjerëve. Diçka që e lumturon atë". Ndërsa, antonimi i fjalës **"fadilet"**, është **"rezilet"**.

Në bazë të kësaj, fjala **"fadilet"** nënkupton një lloj **"shtimi të njerëzillëkut"**. Për rrjedhojë, me shtimin e **"fadilet"**-it, shtohet **"njerëzillëku"**. Pra, njeriu bëhet një krijesë **"më njerëzore"**. Në të kundërtën, me shtimin e **"rezilet"**-it, njeriu bëhet **"më pak njerëzor"**.

Shoqëritë moderne, me shkëputjen prej dritës së shpalljes hyjnore, përplasen drejt **"rezilet"**-it. Kurse Islami synoi ndërtimin e një **"shoqërie virtytsh"**. Njeriu i shpalljes hyjnore, është njeriu i virtytshëm.

Islami synon shtimin e virtytit në shoqëri dhe pakësimin e **"rezilet"**-it. Pra, synon të ndërtojë një shoqëri të përbërë nga njerëz të virtytshëm. Parimet e moralit islam shprehin kornizën e personalitetit të një njeriu të virtytshëm.

Në një hadith fisnik, të transmetuar nga Ebu Hurejra (r.a.), Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: *"Besimi është shtatëdhjetë (ose gjashtëdhjetë) degë. Më e virtytshmeja prej këtyre, është të thuash "La ilahe il-lall-llah / Nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut". Kurse më e ulëta, është të heqësh një pengesë nga rruga. Edhe turpi është një degë e besimit."* (Muslim, Iman, 58.)

- **La ilahe il-lall-llah**

- **Heqja e një pengese nga rruga...**

- **Turpi...**

Siç e shohim, **"kuadri i besimit"**, që ka përcaktuar Rasulallahu (a.s.), përfshin një fushë shumë të gjerë. Ai përfshin dimensionin e **"akides/besimit"**, ndërton formën morale të individit dhe zgjatet deri tek altruizmi në marrëdhëniet shoqërore.

Dijetarët islamë kanë bërë klasifikime të detajuara në kapitullin **"degët e besimit"** dhe si përfundim kanë nxjerrë në pah detajet më të imta të **"personalitetit të një besimtarit"**.

Nga një anë, në librat e moralit islam, cilësitë e mëposhtme radhiten nën kapitullin **"virtytet"** dhe nga ana tjetër u bëhet një lidhje me **"degët e besimit"**. Dhe kjo do të thotë se **"në Islam, besimi dhe personaliteti kanë lidhje të thella me njëri-tjetrin"**.

Drejtësia, matura, toleranca, familjariteti me të tjerët, këmbëngulja dhe vendosmëria, paqedashja, solidariteti, vetëmjaftueshmëria, bujaria, bindja dhe dorëzimi (ndaj Allahut), urtësia, garimi në mirësi, fytyra e qeshur, drejtësia në matje dhe peshim, pjekuria, guximi dhe heroizmi, përshëndetja, mosdëmtimi i të tjerëve, sjellja e mirë, ruajtja e amanetit, urdhërimi për të mirë dhe pengimi nga e keqja, ruajtja e lidhjeve farefisnore, edukimi fetar i fëmijëve, respektimi i të mëdhenjve, mëshirimi dhe dashuria ndaj të vegjëlve, ruajtja e të drejtave të familjes, bindja ndaj prindërve, larja e borxheve, gostitja e komshinjve, dhënia e borxhit, pajtimi i njerëzve, mbrojtja e nderit dhe namusit, të bësh dua për të tjerët, vëllazëria, miqësia, dashuria, ndihma, të flasësh fjalë të drejta e të vërteta, mikpritja, turpi, ruajtja nga gjynahet dhe devotshmëria, teubeja/pendimi, durimi, tevekkuli/mbështetja në Allahun, modestia, butësia, falënderimi, ruajtja e gjuhës, mbajtja e sekreteve, këshillimi me të tjerët, besnikëria, falja, shoqëria, ruajtja e miqësisë, optimizmi, trimëria, dashuria për atdheun, këshilla, burrëria, pastërtia, dhurimi...

Allahu Tela urdhëron:

"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin." (Ibrahim, 24-25.)

Ndërsa Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Është një shprehje, e cila rrjedh që prej pejgambereve të parë dhe që ka ngelur në mendjen e popullit: Po nuk pate turp, bëj ç'të duash." (Buhari, Enbija, 54, Edeb, 78.)

Fjala e bukur dhe turpi...

Të gjitha këto, por edhe më tepër... Imagjini një shoqëri të pajisur me këto ose një shoqëri të krijuar me një nga këto virtyte...

Ndërsa në një shoqëri, ku është pakësuar ndjenja e mikpritjes, janë dobësuar lidhjet fqinjësore, ka humbur ndjenja e besnikërisë, ku nuk ka falënderim, mi-

rënjojhe, e pastërti, ku nuk njihet as i vogli, as i madhi, ku mungon lutja, besnikëria, bashkëjetesa, butësia dhe durimi... një shoqëri frikacake, që i janë këputur lidhjet shpirtërore... dhe i janë shkatërruar ndjenjat e sigurisë, është një shoqëri që i është pakësuar Islami, e shprehur ndryshe, një shoqëri e zhveshur prej virtutit. Ky lloj njeriu dhe kjo lloj shoqërie, po shtohet. Madje edhe shoqëritë islame po i humbasin "pluset" e veta dhe po pësojnë erozion të virtuteve.

Dy tablo nga jeta, të cilat shfaqin dallimin e virtuteve dhe ngjallin mall.

Musa Efendiu, rahmetullahi alejhi, kishte shkuar në Mekë për të bërë umren. Gjatë natës bënte jash-tëzakonisht ftohtë. Në një nga këto net thirri Adilin, i cili i shërbente dhe i tha:

"Adil, biri im! Ne po qëndrojmë në një hotel të ngrohtë. A i pe ata që e gdhinin mëngjesin nëpër tunele, kur po vinim? Ne jemi përgjegjës për ta. Prandaj menjëherë shko gjej batanije aq sa të mundesh dhe shpërndajua atyre."

Ai i dha Adilit një shumë të majme parash. Ai nxitoi menjëherë të tregtarët e batanijeve, i ngarkoi ato në një kamionetë dhe mori rrugën për tek tunelet. Në këtë mënyrë, ata që vinin nga vende të ndryshme të botës islame dhe flinin nëpër tunele, sepse nuk kishin para për hotel, u gdhinë të mbështjellë me ngrohtësinë e zemrës së një besimtari.

Ishte një dimër, në të cilin qyteti i Konjës qëndroi nën dëborë për ditë të tëra. Në rrugën Ankara-Konja, zogjtë uleshin mbi rrugë për të gjetur qoftë edhe një kokërr gruri. Për këtë arsye, ata përplaseshin nga makinat që kalonin dhe jepnin shpirt duke u përpëlitur.

Doktor Hulusi Bajbal, rahmetullahi alejhi, thirri disa djem të rinj që ishin miq të tij dhe u tha:

- Sot, mirësia më e madhe që do të bëjmë, përveçse të bëjmë që të lëshojë tym oxhaku i të varfërve, është të shpëtojmë zogjtë që japin shpirt nëpër rrugë. Hajt pra, merrni ushqim të bollshëm për zogjtë dhe shpërndajeni në anët e rrugës. Kështu që zogjtë që

kërkojnë ushqim, të ulen në anë të rrugës e jo në mes e të përplasen nga makinat.

Pastaj u dha një shumë ta madhe parash dhe të rinjtë u nisën për rrugë. Një pjesë e tyre në rrugën e Ankarasë, një pjesë në rrugën Antalja-Izmir dhe një pjesë në rrugën e Aksarajit...

Duke ikur, ata shpërndanë grurë në anën e djathtë të rrugës. Ndërsa në kthim shpërndanë në anën e majtë... Ndërsa ishin duke bërë këtë punë, i ndaloi policia e trafikut dhe u kërkoi patentën dhe letrat e mjetit, të cilat për shkak të nxitimit kishin harruar t'i merrnin. Megjithatë, kur policët e kuptuan punën që po bënin, as që menduan t'u vinin gjobë.

Dikush i sheh e dikush nuk i sheh ata që po ngrijnë nga të ftohtit nëpër tunele. Por ata që i shohin, kanë "pluse".

Dikush i sheh e dikush nuk i sheh zogjtë që japin shpirt duke u përplasur nga automobilat. Por ata që i shohin, kanë "pluse".

Ky "plus njerëzie", është virtyt.

Për njeriun ka dy rrugë:

Njëra, ajo në të cilën është duke u zvarrisur dhe që më në fund do ta shkatërrrojë, rruga e "rezilet"-it dhe përplasja në thellësitë tronditëse të asaj që quhet "esfel-i saflin/më të ulët in e të ultëve"...

Ndërsa tjetra, hyrja në rrugën e përpjekjeve për t'u bërë përsëri njeri brenda kufijve të virtytit.

Një edukatë... Një prekje e re gjithëpërfshirëse... Një luftë virtyti...

Të pajisesh me një edukatë hyjnore.

Të pajisesh me moralin që ka ndërtuar shpallja hyjnore.

Të ngjyrosesh me ngjyrën e Pejgamberit (a.s.)...

Thuhet, se "takvaja/devotshmëria", është virtyti themelor. Ndërsa të gjitha virtytet e tjera formohen në gjirin e saj. Takvaja është besnikëria ndaj Allahut, frikë-respekti dhe frika e humbjes së kënaqësisë së Tij... Pra, besimi, me degët dhe lulet e tij...



Konfliktet, zënkat dhe luftërat ndërmjet gjallesave janë një realitet social. Vuajtjet dhe gëzimet, vështirësitë dhe lehtësitë, dhimbjet dhe ndjesitë e ëmbla, fatkeqësitë dhe sukseset gjithmonë vazhdojnë të jenë të pranishme.

Ne mund të flasim për shumë urtësi të këtij realiteti social. Jetën duhet ta shtjellojmë me të gjitha dimensionet dhe t'i marrim parasysh të vërtetat e domosdoshme të saj.

Por edhe në këtë pikë duhet t'ua vëmë veshin këtyre thirrjeve hyjnore:

"Allahu i thërret njerëzit për në vendin e shpëtimit (xhenet)..." (Junus, 25.)

Islami fal prehje dhe qetësi në këtë botë, ndërsa në ahiret, xhenetin, në të cilin çdo lloj paqeje, qetësie dhe lumturie është në kulmin e saj.

Në një ajet tjetër, bëhet kjo thirrje:

"O ju që keni besuar! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar." (Bekara, 208.)

Fjala "silm" në ajet, që ne e përkthejmë Islam, do të thotë: nënshtrim, bindje, paqe dhe kompromis. Për këtë arsye, shumica e komentuesve të Kuranit e kanë komentuar si "Islam", sepse fjala "Islam", i përfshin të gjitha këto kuptime.

Së pari, ajeti fisnik, i thërret hipokritët që kishin besuar vetëm me gjuhë, që të hyjnë në Islam me të gjithë qenien, veprat dhe moralin e tyre dhe të mos ndjekin hapat e shejtanit, duke shfaqur hipokrizi. Në të njëjtën mënyrë, i thërret edhe ata që janë bërë myslimanë prej ehli kitabit, të cilët, në njërin anë i besonin të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe në anën tjetër shfaqnin respekt për dispozitat e Tevratit si "shenjterimi i ditës së shtunë dhe konsiderimi mekruh i mishit e qumështit të devesë".

Ata i fton të hyjnë plotësisht në Islam dhe të mos pasojnë asnjë prej dispozitave të mëparshme, qoftë nga aspekti i besimit apo nga aspekti i veprave. (Razi, V, 176.)

Grupi bazë, ndaj të cilëve ajeti parashton thirrjen e tij, janë myslimanët. Atyre u jep këtë mesazh: **"O ju që keni besuar! Të gjithë hyjni në Islam në mënyrë të plotë! Zbatojini pa mangësi urdhrat e tij! Vazhdoni të jetoni si myslimanë edhe në atë pjesë të jetës që keni! Mos u ndani kurrë nga Islami dhe prej parimeve të tij! Mos ndiqni gjurmët e shejtanit, duke i marrë në konsideratë dyshimet që të devijuarit dhe të humburit përpiqen t'ju imponojnë!"**

Hyra në Islam e të gjithë njerëzve dhe arritja e paqes ka rrugët e saj:

Nëse je besimtar, kthehu dhe shiko veten tënde. Kontrollroje mirë jetën tënde brenda kornizës Iman-

Prof. dr. Omer Çelîk

HYNI TË GJIT HYNI TË GJIT

Islam-Ihsan. Sa e jeton atë sipas Islamit dhe sa jo? Pasi ta vërtetosh këtë, përpiku ta jetosh si mysliman edhe anën që nuk e jeton si i tillë. Dorëzoju Allahut Teala dhe fesë së Tij si Ibrahim, alejhi's-salam dhe Muhamedi, (a.s.). Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

"Zoti i tha (Ibrahimit): 'Dorëzoju (Allahut me të gjithë qenien tënde)! - ai u përgjigj: 'Iu dorëzova Zotit të gjithësisë!'" (Bekare, 131.)

Në këtë mënyrë, le të mos ngelë jashtë Islamit asnjë gjë e jotja, qoftë ajo edhe sa maja e gjilpërës!

Nëse je çifut apo i krishterë, ke edhe më shumë punë.

Së pari, duhet të rregullosh besimin tënd. Feja nuk mund të jetë sipas mendimeve personale dhe dëshirave vetjake, kështu që nuk mund të thuash: "Besoj si të dua dhe jetoj si të dua." Nëse thua kështu, kurrë s'do të gesh paqe e qetësi në këtë botë dhe nuk do të përfitosh prej mirësive të mrekullueshme të xhenetit. Atëherë, pa u ndalur qoftë edhe një çast, menjëherë hyr në Islam me gjithë qenien tënde! Mos të të ikë treni i Islamit duke ua vënë veshin murmuritjeve të nefsit, duke u kapluar prej vesveseve të djallit dhe duke u ankuar: "Më parë ishte ashtu e kështu, ndërsa tani përse është kështu?"

Nëse je politeist apo mohues i fesë dhe nuk e di se çfarë është besimi, libri i Zotit e Pejgamberi, duhet të përpiqesh edhe pak më shumë.

Së pari, duhet t'i pastrosh mirë papastërtitë e politeizmit që ke në zemër dhe t'i heqësh perdet e



THË NË ISLAM THË NË PAQË!

mohimit. Në këtë mënyrë, do të të hapet një rrugë e drejtë nga zemra për te Allahu Teala. Flladi freskues, qetësues dhe rehatues i besimit, le të depërtojë, së pari, në qelizat dhe thellësitë e zemrës tënde. Ndjeje atë kënaqësinë e papërshkrueshme të takimit me Krijuesin tënd dhe atë emocion madhështor të të thënit "Allah"! Pranoje me zemër se nuk ka zot tjetër përveç Allahut Teala dhe hap një periudhë të re e të gjallë në jetën tënde! Ngjallu me Të dhe bëhu i përjetshëm! Pastaj, me inkurajimin e besimit që ka filluar të zërë rrënjë në zemrën tënde, dalëngadalë fillo të lyhesh me bojën e Islamit! Së fundi, hyr i tëri në Islam!

Ja pra, nëse të gjithë, çfarëdo besimi që mund të kenë, përipiqen t'i ndjekin këto rrugë, i lënë dëshirat vetjake, kapen pas klimës shpirtërore, ndjekin rrugën e Islamit dhe udhëzimet e Kuranit dhe hyjnë në Islam me gjithë qenien e tyre, duke pasuar shembullin e shkëlqyer të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), atëherë bëhen myslimanë dhe menjëherë realizohet vetvetiu edhe synimi për të hyrë në paqe të gjithë. Ashtu si në jetën e xhenetit, ku të gjithë i thonë njëri-tjetrit vetëm selam-selam. Pastaj, çdo anë e kaplon paqja, lumturia e sigurisë dhe ngrohtësia e vëllazërisë islame.

Kur të gjithë të shohin punën e tyre dhe ta kryejnë atë në formën më të bukur, kjo lumturi, gëzim, dhe ngrohtësi do të shtohet edhe më shumë dhe çdo anë pothuajse do të kaplohet nga një fllad parajse. Ky është një ideal dhe një synim sublim. Allahu Teala është i fuqishëm

për çdo gjë.

Sa nevojë kemi në ditët e sotme, në vendin dhe botën tonë për këtë recetë paqeje që na jep Islami, veçanërisht në këto kohëra që luftërat pasojnë njëra-tjetrën, në të cilat derdhet gjaku i miliona njerëzve, në të cilat janë futur në luftë njerëzit dhe propagandohet për luftë të vazhdueshme për shkak të disa cytjeve të brendshme e të jashtme, që i bëjnë armiq vëllazërit me njëri-tjetrin, medhhebin ndaj medhhebit dhe njerëzit që patën jetuar në mënyrë vëllazërore e me dashuri përgjatë shekujve.

Në të vërtetë, siç kemi nevojë dhe jemi të etur për këtë paqe në shkallë vendi, edhe njerëzit e gjithë botës kanë nevojë ta kapin dorën e kësaj paqeje.

Allahu Teala thotë:

"Në paqe ka mirësi dhe begati të madhe." (Nisa, 128.) Por kjo nuk është e lehtë për t'u arritur. Sa bukur ka thënë poeti:

*E gjithë bota gjen paqe dhe begati me këtë fe,
Nëse do paqe, bëhu gati për të sakrifikuar për të.*

Paqja që imagjinojmë, patjetër duhet të jetë një paqe me në qendër Islamit, sepse paqen dhe qetësinë e vërtetë mund ta sigurojë vetëm nënshtrimi i plotë ndaj Islamit. Nëse mendohet një paqe e lidhur me një burim jashtë Islamit, atëherë ky do të bëhet një mjedis, prej të cilit Islami do të tërhiqet plotësisht, në të cilin Islami do të dalë jashtë funksioni dhe, nëse mund të themi, do të shkulet me gjithë rrënjë. Kjo gjendje, në fund nuk do të jetë në dobi të asnjërit. Atëherë, duhet të përipiqemi me të gjitha mundësitë tona për këtë synim sublim, që është receta e shpëtimit të individit, shoqërisë, botës islame dhe madje, e të gjithë shoqërisë.

Nëse marrim parasysh kuptimet "paqe, prehje, lënie e luftës dhe debatit" të fjalës "silm", ajeti fisnik pothuajse na jep këto urdhra:

O Besimtarë! Krijoni një vend islam madhështor me shoqëri të përkryer, duke hyrë të gjithë në Islam dhe duke iu nënshtruar plotësisht urdhrave të Allahut, në mënyrë që të mos ngelë gjurmë nga zënkat, grindjet, kontradiktat, lëndimet ndaj njëri-tjetrit, sjelljet e këqija, dhunimi i dispozitave të Allahut dhe të drejtave tuaja, përfundimisht, nga sjelljet që bien në kundërshtim me kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar! Kështu, të gjithë le të preokupohen me detyrat e tyre në siguri, me dashuri të ndërsjelltë e me një paqe të plotë dhe të përgatiten për ahiretin!

Të mos u jepet shans përçarjeve që mund ta shkatërrojnë këtë mjedis të sigurt dhe të qetë! (Elmallëllë, II, 736.)

Atëherë, kjo kohë është koha të bashkohemi dhe të punojmë për shpëtimin, paqen dhe qetësinë e njerëzimit brenda strukturës islame...

HAKMARRJA E MJEDISIT NDAJ FEMOHUESVE

Xhemal Nar

Gjithësia dhe njeriu janë të varur nga ligjet që ka vënë i njëjti Krijues. Thënë ndryshe, feja dhe ligjet natyrore (sunnetull-llah), që ka vënë Allahu i Madhëruar janë në një harmoni të përsosur. Pra, kur njerëzit kryejnë urdhëresat fetare, janë në një përshtatje të përsosur me gjithësinë. Nuk bien në kundërshtim, nuk i kundërvihen, nuk ngatërrohen me gjithësinë.

Por atëherë kur njerëzit jetojnë me femohim, me gjynahet dhe haramet e tyre, bien në kundërshtim, i kundërvihen dhe ngatërrohen me gjithësinë, duke u përplasur me ligjet e vëna në gjithësi. Gjithësia, parë nga ky këndvështrim, është e gjallë, e përgjegjshme dhe e madhëron Allahun e Madhëruar sipas gjuhës dhe gjendjes së vet, i bën ibadet Atij. Njeriu është gjithnjë i shqetësuar dhe i mërziur nga padrejtësia, që vjen si rrjedhojë e natyrshme e ateizmit që ka zgjedhur të ketë pjesë të karakterit, pasi vetë njeriu është ai që bëhet shkak për hakmarrje, për konflikt, si pasojë e moskryerjes së detyrës që ka. Kurse gjithësia është gjithnjë në një bindje të plotë.

Ja pra, ajo që thuhet në Kuranin Famëllartë: **“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve”**, nis pikërisht kështu. Një njeri që jeton me femohim, pra në kundërshtim të plotë me ligjet hyjnore, është në konflikt të përhershëm me atë që jeton në përputhshmëri të plotë me ligjet hyjnore. Konflikti, ngatërresa dhe kaosi kanë kuptimin e shkatërrimit total.

Duhet pasur frikë nga kaosi dhe shkatërrimi, që buron si pasojë e kësaj përplasjeje. Natyra që sjell kjo blasfemi dhe kryengritje, duhet pasur frikë që të mos përplaset me gjithësinë. Kjo gjë, në njëfarë mënyre, është zemërimi dhe hakmarrja e gjithësisë.

Me vullnetin e Allahut të Madhëruar, njerëzve kryengritës nganjëherë u ka shpërthyer uji nga toka e nganjëherë nga sipër dhe janë mbytur, ashtu sikurse me popullin e Nuhut (a.s.). Nganjëherë toka është tronditur fort nga tërmetet e mëdha, sikurse ndodhi me Ejkelët. Dhe ndonjëherë mbi njerëzit u hodhën gurë e zjarr nga qielli, sikurse ndodhi me popullin e Adit dhe

Themudit. Nganjëherë detet marrin shpirtra, ashtu sikurse ndodhi me fundin e Faraonit. Të gjitha këto, me vullnetin e Allahut të Madhëruar janë hakmarrja e gjithësisë ndaj njerëzve blasfemues dhe të pacipë.

Sikur të vinte një dënim i tillë mbi ata të ashtuquajturit sekularë e laikët e pafe, nuk do ta kuptonin se po u vjen nga Allahu i Madhëruar, ndaj dhe nuk do të marrin mësim e as shembull. Madje, do të thonë: “Kjo është një fatkeqësi natyrore; e ç’lidhje ka me fenë, besimin e Allahun?” Ja pra, për arsye të këtij mosperceptimi, do ta meritojnë këtë dënim, por xhahili sërish nuk do ta kuptojë as këtë.

Shprehja: “Këto fatkeqësi nuk u ndodhin vetëm të këqinjve, por edhe të mirëve.” është një lloj kundërpërgjigjeje që jepet dhe që aspak nuk është e vërtetë. Pasi ata njerëz që gjenden në mesin e njerëzve të ligj, që nuk këshillojnë për mirë dhe nuk pengojnë të keqen, për arsye se nuk e kanë kryer pikërisht këtë detyrë që kanë, meritojnë atë dënim. Mirëpo, ky dënim do të jetë si një shlyerje e gjynaheve të tyre dhe në botën tjetër nuk do të dënohen, inshallah!

Në këtë botë mund të jenë të dhunuar edhe ata që e kryejnë detyrën e tyre. Kjo gjë është një ligj shoqëror, “atëherë kur do të vijë dënimi i frikshëm, nuk dënohen vetëm të padrejtët”, “me të njomin shkon edhe i thati”. Mirëpo, ata të paktën në botën tjetër nuk do të digjen. Do të mjaftohet me dënimin që u jepet me fatkeqësinë që i kaplon edhe ata.

Kur njeriu kryen detyrën e tij si rob i Zotit të Madhëruar, nuk duhet t’i frikësohet hakmarrjes së

gjithësisë e as fatkeqësisë së mjedisit. Hera-herës njeriu “mund të gjendet në sprovën e frikës së pakësimit të të ardhurave, me përballjen me skamjen” etj. Padyshim që njerëzit do të sprovohen lidhur me atë se “sa besnikë, sa të qëndrueshëm dhe sa të pjekur janë në besim.” Mirëpo, të gjitha këto janë të përkohshme.

Besimtari i vërtetë i mbështetet Allahut të Madhëruar dhe punët ia dedikon vetëm Atij. Për arsye se është mbështetur te Krijuesi, ai nuk ka frikë lidhur me furnizimin e tij në këtë jetë dhe as që shqetësohet për këtë gjë. Ajo çfarë ai ka frikë dhe që e shqetëson, është nëse ka apo nuk ka ndonjë të metë në përkushtimin e tij ndaj Zotit. Dhe është më se i vetëdijshëm se dënimet vijnë nga çrregullimet e veta.

Pasi të mendohen të gjitha këto, zbardhet një e vërtetë: paqja dhe lumturia e kësaj bote arrihet vetëm atëherë kur njihet dhe përjetohet feja e shenjtë e Allahut, Islami. Ata që nuk e bëjnë këtë, ata që kanë kaluar kufijtë duke bërë veprat e ndaluara, në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme janë duke prishur dhe shkatërruar mjedisin ku jetojnë. Toka e qiejt, me lejen e Allahut të Madhëruar në një farë mënyre hakmerren ndaj tyre.

Le ta shikojmë në këtë perspektivë ngrohjen globale apo çrregullimet sociale, qoftë edhe të tjera fatkeqësi dhe le të kuptojmë se ajo çfarë duhet të kemi frikë është femohimi dhe kryengritja ndaj ligjeve fetare, ndaj duhet të marrim mësim.

Mesazhi i Fjalës së bukur

Prof. dr. Jashar Kandemir

Në suren el-Isra, thuhet:

“Thuaju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndër-mjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.”
(Isra, 53.)

Allahu (xh.sh.), i cili i ka dhënë njeriut aftësinë e të folurit, thotë: ***“Thuaju, robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira.”***

Kur lexoni këtë ajet, zemrën ua ngroh dëshira për të hyrë në grupin e fatlumëve, që Allahu i Lartësuar i përmend me shprehjen “ibadi / robërit e Mi”.

Mendoni: Allahu i Madhëruar, me mëshirën e Tij të pafundme, i drejton bisedat tuaja. Me këdo që të flisni, ju urdhëron të zgjidhni fjalët më të mira. Urdhëron të flisni pa e lënduar bashkëbiseduesin tuaj dhe të gjeni e të shprehni atë fjalë që hedh në zemrën e tij dashurinë ndaj së vërtetës.

Ju duhet ta respektoni këtë, kur të flisni edhe me mëkatarët dhe qafirët. Kundrejt tyre nuk duhet të përdorni fjalë të prera dhe lënduese. Çështjen e atij që keni përballë, nuk duhet ta nënçmoni. Bashkëbiseduesin

nuk duhet ta detyroni të përdorë shprehje nxitëse. Duhet të jeni të kujdesshëm kundrejt cytjeve të djallit të mallkuar.

Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët të zgjedhin më të mirën dhe të sillen me ndjeshmëri pothuajse në çdo çështje. Për shembull, urdhëron që të kenë kujdes se çfarë hanë dhe çfarë pinë. Ndërmjet mirësive të pafundme që i ka nënshtruar ndaj njerëzve, urdhëron që të zgjedhin hallallin dhe të pastren. (Shik. el-Bakara, 2/168.) Kjo mund të themi se ka lidhje me strukturën fizike dhe me jetën individuale. Ndërsa në ajetin që përbën temën tonë, flitet për dinamikën bazë që formon paqen dhe qetësinë në jetën sociale. Kjo përkon me misionin e vërtetë të besimtarit, që vërtetohet me këtë ajet:

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin. (Sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” (Al’Imran, 110.)

Atëherë, gjithmonë jeni të detyruar të flisni duke zgjedhur fjalët më të bukura, më të drejta dhe më të dobishme. Nisur nga kjo, ajeti fisnik që përbën temën tonë, shpreh një domosdoshmëri përtej garës së virtytshmërisë, sepse këtu shprehet një urdhër që s’ka lidhje me kohën dhe vendin.

Tani po mendoj:

Çfarë është fjala e mirë? Sepse jam i detyruar ta di këtë, që të zbatoj urdhrin e dhënë në ajet. Në këtë çështje, përgjigjen e pyetjes e gjej në një ajet tjetër. Në suren Fussilet, Allahu Teala pyet:

“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman.’?” (Shih 41/33.)

Transmetohet se personi, për cilësitë e të cilit bëhet fjalë në këtë ajet, është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Kjo e bën edhe më të domosdoshme zgjedhjen e fjalës së bukur në çdo aspekt.

Në Ruhul-Bejan thuhet: Fjala më e bukur është përkujtimi i Allahut, duke thënë ‘la ilahe illallah’ me plot sinqeritet. Vepra më e bukur është çdo lloj pune që bëhet në përputhje me të vërtetën dhe me fenë. Ndërsa, karakteri më i bukur është që njeriu t’i dorëzohet me gjithë vullnetin e tij Allahut Teala, t’u bëjë mirë njerëzve pa prituri ndonjë shpërblim prej tyre, t’i falë të këqijat që mund t’i vijnë prej tyre, të gjendet ndërmjet njerëzve duke shfaqur dashuri për ta dhe t’i inkurajojë njerëzit për të bërë vepra të mira, pa i imponuar e t’i ndalojë nga e keqja pa i nënçmuar.

“Thuaju, robërve të Mi, të flasim atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapur i njeriut.”

Ndërsa rezultatet e rrezikshme, që lindin nga moszbatimi i këtij urdhri të ajetit fisnik, shpjegohen kështu:

Përndryshe, shejtani do të hyjë ndërmjet njerëzve dhe do t’i inkurajojë për t’u grindur me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre do të mbjellë farërat e prishjes me sjellje të ashpra dhe të vrazhda. Sepse, përderisa njerëzit të mos e këshillojnë njëri-tjetrin dhe të mos sugjerojnë për të mira, djalli hyn lehtësisht ndërmjet tyre dhe ua shkatërron ndjenjat e vëllazërisë.

Tani mund të themi: Fjalët e bukura nxjerrin në pah sjellje të mira dhe me to arrihet uniteti dhe vëllazëria në shoqëri. Ndërsa sjelljet e vrazhda, që lindin prej fjalëve të shëmtuara, e shkatërrojnë mjedisin e qetë, i cili është formuar me përkujdesje. Sepse djalli gjen mundësinë për t’i ngatërruar njerëzit me anë të fjalëve të shëmtuara, të vrazhda dhe të pahijshme.

Në fjalët e pamatura, që dalin nga goja në momentin e zemërimit, gjenden rrugë që ndikojnë për të prishur.

Atëherë, fjala e bukur është një valvul sigurie, që nuk i jep mundësi kalimi armikut të përbetuar të njerëzve, shejtanit, për të hyrë në fushat, ku mund të ndikojë. Embëlsinë e Islamit mund t’ia shfaqim botës vetëm me anë të tyre (fjalëve të bukura). Kapitali ynë më i rëndësishëm është fytyra jonë e buzëqeshur, është fjala jonë e bukur dhe gjuha jonë e ëmbël. Në të njëjtën kohë, ajeti fisnik tregon edhe zgjidhjen e këtij problemi, në mënyrë që të mos i jepet shejtanit ajo mundësi.

Në suren el-Bekare thuhet se një fjalë e bukur, që i inkurajon njerëzit për mirësi dhe falja e gabimeve, është më e lartë se lëmosha që përcillet me fyerje. (Shih 2/263.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë se fjala e bukur është më e vlefshme se lëmosha me të cilën ushqehen të uritit dhe plotësohen nevojat e tyre. (Shih Buhari, Edeb, 34.) Po ashtu, na ka paralajmëruar se fjala e shëmtuar është haram për t’u thënë.

Sa paralajmërimi i madh është ky për njeriun, i cili komunikon me anë të të folurit, që është cilësia më e dallueshme ndërmjet të gjitha krijesave.

Sigurisht se fjala më e bukur është Kurani Fisnik dhe njeriu që flet më bukur është i Dërguari i Allahut, (a.s.), nëpërmjet të cilit Kurani iu shpall njerëzimit. Të tjerat janë të vlefshme dhe të bukura, aq sa kanë afërsi

dhe përputhshmëri ndaj këtyre të djave.

Meqë myslimanëve u takon autoriteti dhe përgjegjësia për t’ia shpallur njerëzimit fjalët e bukura që burojnë prej këtyre, sot është shumë me rëndësi që ta mbartin, ndjejnë dhe jetojnë këtë hijeshi me të gjithë seriozitetin e madh të saj.

Gjëja e mirë dhe e bukur, sigurisht gjithmonë është e vlefshme. Por vlefshmëria për të cilën po flasim, ndryshon sipas mungesës dhe shumicës së asaj gjëje. Atëherë, të gjithë duhet të themi fjalët më të bukura, në mënyrë që të zbukurojmë veprat, moralin dhe mendimet tona. Zemrave që nuk e njohin këtë shije, duhet t’u thuhet fjalët të bukura si lëmoshë. Ne duhet ta përhapim këtë amanet në çdo vend ku mund të arrijmë, duke filluar nga të afërmit.





Grudaja Le parë MYSLIMANE

Adem Saraç

E gjithë e jeta e nënës sonë, Hadixhes, radijallahu anha, është e mbushur me shembuj të bukur në çdo aspekt. Mirëpo, këtu do të përpiqemi të përmbledhim, vetëm sjelljen e saj të pashoqe në kohën kur zbriti shpallja e parë.

Kur Pejgamberit tonë (a.s.), i erdhi shpallja për herë të parë, shkoi në shtëpi i frikësuar dhe tha: *"Më mbuloni! Më mbuloni!"*. Nëna jonë Hadixhja (r.a.), ia plotësoi kërkesën me dashuri dhe butësi. Më pas, me një zë që të ngrohte shpirtin, shprehet me këto fjalë madhështore:

*"Ti gjithmonë ke qenë i ndritur. Mirëpo tani, në fytyrën tënde shoh një nur që nuk e kam parë deri më sot dhe ndjej një aromë që nuk e kam ndjerë më parë!"*¹

Më vonë, Pejgamberi (a.s.), u qetësua dhe pasi u ngrit, u ul në vendin ku ishte shtrirë. Kur e pa që erdhi në vete, Hadixhja (r.a.), menjëherë shkoi dhe u ul pranë tij. Kaloi nga ura e syrit dhe u ul në vendin e shpirtit të tij, duke u munduar të kuptonte atë që kishte ndodhur!

1. Ibn Ishak, Siretu Ibn Ishak el-Musemmâ bi Kitabi'l Mubtede' ve'l-Meb'as ve'l-Megazi, fq. 60; Ibn Haxher el-Askalani, el-Isabe fi Temjizi's-Sahabe, vol. 4, fq. 2428; Bejhaki, Delailu'n-Nubuue ve Ma'rifetu Ahvâli Sahibi'sh-Sheria, Vol. 2, fq. 148.

Pejgamberi ynë (a.s.), duke e parë me dashuri, i tregoi një për një çdo gjë që kishte ndodhur në malin Hira. Pastaj shprehu shqetësimin e tij, duke thënë:

*"Kam frikë se do të më ndodhë ndonjë e keqe!"*²

Ndërsa nëna jonë Hadixhja (r.a.), u përpoq ta qetësonte me fjalët më të bukura dhe më të ngrohta, duke i thënë:

"Mos ki frikë, mos u shqetëso! Ty nuk do të të ndodhë gjë! Beto hem në Allahun e Madhërishëm, se Ai nuk do të të turpërojë dhe nuk do të të hidhërojë asnjëherë, sepse ti kujdesesh për të afërmit, u qan hallin të dobtëve dhe i ndihmon ata. Ti nuk i nënçmon të varfrit, të mjerët e të vetmuarit, por ulesh dhe bisedon me ta, duke i ndihmuar me aq sa ke mundësi. Ti je mikpritës dhe të pëlqen t'i gostisësh miqtë. Ti përpiqesh t'i ndihmosh të gjithë pa dallim, të mëdhenj apo të vegjël qofshin. Ti nuk e njeh hilen dhe mashtrimin. Ti flet gjithmonë të drejtën. Ti je një njeri, të cilin e duan, e respektojnë dhe e besojnë të gjithë. Tek ti janë mbledhur të gjitha virtytet e mira. Prandaj, mos ki frikë, mos u shqetëso! Allahu kujdeset për ty. Me lejen e Allahut, nuk do të të ndodhë asgjë e

2. Taberi, Tarihu'l-Umem ve'l-Muluk, vol. 2, fq. 2207; Ibn Sejjidunnas, Ujunu'l-Eser ff Fununi'l-Megazi ve'sh-Shemail ve's-Sijer, vol. 1, fq. 86.

keqe!³

Pas një kohe të gjatë, kjo ndodhi u përsërit sërish. Mirëpo, këtë herë, sapo u shtri, u çua dhe u ul në vend. Ndërsa nëna jonë Hadixhja (r.a.), filloi t'i fliste me gjithë shpirt me një zë të mbushur plot mëshirë:

“Përse u ngritët menjëherë? Ju nuk pushuat aspak!”

Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj me këto fjalë:

“Tashmë iku koha e pushimit dhe rehatisë, o Hadixhe!”⁴

Pasi tha këto fjalë, filloi të këndonte një nga një, ajetet e para të sures el-Muddethir...

“O ti, i mbështjellë (o Muhammed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)! Mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë dhe për hir të Zotit tënd, duro!” (Mudde-thir, 1-7.)


Drita hyjnore që do të shndrishte gjithë universin, po lindte nga shtëpia e Pejgamberit tonë (a.s.), i cili u ngrit nga vendi ku ishte shtrirë, duke u zhytur nga drita në dritë me ndriçimin e atyre ajeteve fisnike.

Ndërkohë që sulltani i pejgamberëve po këndonte këto ajete, nëna jonë Hadixhja (r.a.), kishte humbur në sytë e tij të bekuar që shkëlqenin nga drita. Ajo i dëgjoi fjalët që dilnin nga gjuha e tij e bekuar, sikur po mblidhte perla, xhevahire dhe diamante. Dëgjoi dhe kuptoi. U trondit dhe u valëvit si dallgët e oqeanit.

Pejgamberi ynë (a.s.), i tregoi shkurtimisht për detyrën që i kishte ngarkuar Allahu Teala. Ai tha se tashmë Allahu e kishte ngarkuar me detyrën e thirrjes së njerëzve në Islam dhe shtoi:

3. Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vol. 1, fq. 81, pika 90; vol. 5, fq. 260-265, pika 2875; Ibn Abdilber, el-Isti'ab fi Ma'rifeti'l-Ashab, vol. 4, fq. 353; Ibn Habib, el-Muhabber, fq. 79; Ibn Hazm, Xhevamiu's-Sire, fq. 295.

4. Dhehebi, Tarihu'l-Islam ve Vefejatu'l-Meshahir ve'l-A'lâm, fq. 128; Ebu'l-Fida Ibn Kethir, el-Bidaje ve'n-Nihaje, vol. 3, fq. 13, 24.



“Ti gjithmonë ke qenë i ndritur. Mirëpo tani, në fytyrën tënde shoh një nur që nuk e kam parë deri më sot dhe ndjej një aromë që nuk e kam ndjerë më parë!”

“E kujt mund t'ia tregoj këtë të vërtetë? Kush do të më mbështesë mua?”⁵

Kjo zonjë e lartë, e cila po i dëgjonte me vëmendje të madhe fjalët e Pejgamberit të Allahut, duke qenë e vetëdijshme se me çfarë kishte të bënte, shfaqti një qëndrim mjaft të hijshëm. Për shkak se gjithmonë i gjendej pranë, pa nguruar aspak dhe me një entuziazëm të madh u hodh e tha:

“O i Dërguar i Allahut! Unë të pranoj ty dhe të mbështesë e para! Më thirr mua të parën në rrugën e Allahut!”⁶

Fjalët e Hadixhes (r.a.), e gëzuan pa masë shpirtin e Pejgamberit tonë (a.s.). Hadixhja (r.a.), ishte e para që e pranoi ftesën hyjnore dhe e para që u nderua me Islam. Në këtë mënyrë, trangu i umetit të Muhamedit (a.s.), filloi me nënën tonë Hadixhe (r.a.). Ajo zuri vendin si myslimania e parë në historinë islame.

E kishte kuptuar. Ajo e kishte kuptuar shumë mirë se për çfarë bëhej fjalë! Ndryshimi kishte filluar. Procesi i ndriçimit kishte filluar, sepse drita kishte lindur!

Tashmë po fillonte një periudhë e re! Jeta kishte fituar kuptimin e saj dhe besimi ishte bërë kriteri i vlerave të patjetërsueshme. Tashmë çdo fjalë dhe vepër do të matej e peshohej me besim. Në bazë të kësaj, do të flitej dhe jetohej.

Hadixhja (r.a.), hyri në historinë islame, si gruaja e parë myslimane. Po ashtu, ajo gjatë gjithë jetës, jetoi si e para e myslimanëve dhe, megjithëse kanë kaluar shumë shekuj që nga vdekja e saj, ajo gjithmonë mban vendin si myslimania e parë. Nëna jonë, Hadixhja (r.a.), e cila në burimet historike konsiderohet si myslimania e parë, do të qëndrojë e tillë edhe në zemrat e të gjithë myslimanëve deri në Ditën e Kiametit...

5. Ibn Sejjidunnas, Ujuni'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve'sh-Shemail ve's-Sijer, vol. 1, fq. 91-92.

6. Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe, vol. 5, fq. 82-84.



Pyete Zemrën tënde dhe kësbillobu me të

Mustafa Erlsh

Vaisa ibn Ma'bed, radijallahu anhu, ishte një sahab, që u takua me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në Medinetu'l-Munevvere në vitin e nëntë hixhri, u njoh me të dhe u nderua me Islam...

Ai ishte një fatlum, i cili njihet me transmetimin e hadithit fisnik që përkufizon mirësinë dhe të keqen!..

Ishte një njeri i kujdesshëm, punëtor, trim dhe shumë i dhënë pas dijes, i cili përpiquej të mësonte shumë gjëra duke e pyetur të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në çështje të ndryshme!..

Vabisa ibn Ma'bedi, (r.a.), i përkiste fisit Beni Esed.

Ai ishte prej atyre që u nderua me Islam pasi shkoi

në Medine me një grup prej njëmbëdhjetë vetësh nga fisi i tij në vitin e nëntë të hixhretit, kur fiset dyndeshin për në Medine. (Usdu'l-Gabe, IV, 651; Isabe, VI, 461.)

Pasi Vabisa ibn Ma'bed, (r.a.), u bë mysliman, qëndroi në Medinetu'l-Menevvere.

Shokët e tij u bënë myslimanë dhe u kthyen në vendin e tyre.

Ndërsa ai u nda prej shokëve dhe nuk u kthye te fisi i tij. Parapëlqeu të qëndronte pranë Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në mënyrë që të merrte më shumë dije dhe të mësonte më shumë për Islamin. Ai nuk dëshiroi të ndahej prej Resulullahut, alejhi's-selam. Qëndroi në Medine dhe u bë njëri

prej as'habu's-suffe. (Hiljetu'l-Evlja, 2/23.)

Vabisa ibn Ma'bed, (r.a.), kishte një zemër të tejmbushur me dashuri ndaj dijes. Vazhdimisht përpiqej të merrte dije dhe të ndriçohej, duke i bërë pyetje të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Përpkjekjen e tij e shohim qartë në këtë hadith fisnik, të cilin e ka transmetuar.

Transmeton Vabisa ibn Ma'bed, (r.a.):

Shkova te i Dërguari i Allahut, (s.a.) Ai më tha:

-A ke ardhur të më pyesësh se çfarë është mirësia?

-Po, o i Dërguari i Allahut!

I Dërguari i Allahut, (s.a.), më tha:

-Konsultohu me zemrën tënde. Mirësi është ajo gjë që vetja e shikon të përshtatshme dhe zemra pranon të bëhet. Ndërsa mëkat është ajo gjë që të copëton zemrën dhe që heziton ta bësh, edhe nëse të tjerët të japin shumë fetva për ta bërë." (Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 227-228; Darimi, Buju 2.)

Ky hadith fisnik, që ndodhet në përkthimin dhe shpjegimin e Rijadu's-Salihin, është shpjeguar kështu:

"Vabisa ibn Ma'bedi, (r.a.), ishte një sahab shumë i ndjeshëm dhe qante shumë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), duhet të jetë shprehur kështu, për ta bërë Vabisan (r.a.), edhe më të ndjeshëm, duke e pyetur se përse kishte shkuar te ai (s.a.s.), ngaqë e dinte se Vabisa ibn Ma'bedi (r.a.), kishte një zemër shumë të ndjeshme.

Sapo shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), menjëherë e shprehu qëllimin e tij.

Resulullahi, (a.s.), e këshilloi ta mësonte se ç'ishte mirësia, duke u këshilluar me zemrën e tij.

Hz. Pejgamberi, (a.s.), ia kujtoi se një zemër e paprishur prej mëkateve dhe dëshirave vetjake, mund ta ndajë të mirën nga e keqja, sepse kështu thuhej në ajetet fisnike. Allahu Teala thotë:

"O ju që keni besuar! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t'ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t'ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t'ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe." (Enfal, 29.)

"A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraha-

Mirësi është ajo gjë që vetja e shikon të përshtatshme dhe zemra pranon të bëhet. Ndërsa mëkat është ajo gjë që të copëton zemrën dhe që heziton ta bësh, edhe nëse të tjerët të japin shumë fetva për ta bërë."

rorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!" (Zumer, 22.)

Po!.. Secili që kishte në zemrën e tij dashuri për Islamin, vepronte sipas dritës hyjnore që ua jepte Allahu Teala.

Edhe në një hadith tjetër fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shpjegon se një zemër e ndyrë me mëkate, e humbet veçorinë për të ndarë të mirën nga e keqja:

"Kur besimtari bën një mëkat, në zemrën e tij i bëhet një pikë e zezë.

Nëse menjëherë e lë atë mëkat, pendohet dhe kërkon falje, zemra i bëhet e pastër si më parë. Nëse vazhdon të bëjë mëkate, i shtohen pikat e zeza dhe i nxihet zemra. Këto pika të zeza, janë ndryshku për të cilin Allahu Teala bën fjalë në ajet: **"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë ndryshkur zemrat."** (Mutaffifin, 14.) (Ibn Maxhe, Zuhd 29.)

Domethënë, mëkatet e prishin pamjen si pluhuri, ndryshku dhe papastërtitë mbi pasqyrë. Ata të cilët nuk e verbojnë zemrën e tyre me ndotësi shpirtërore, e njohin dhe e kuptojnë lehtë të mirën, të drejtën dhe të bukurën.

Ja, për këtë arsye, Dielli i dy Botëve, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha sahabit me zemër të pastër dhe ndërgjegje të dëlirë: **"Edhe nëse të tjerët të japin me mijëra fetva për të bërë diçka, mos u jep rëndësi atyre! Fetvanë merre nga zemra jote! Zbato fetvanë që do të të japë ajo!"**

Një çështje që dikujt i intereson nga afër, të tjerët nuk mund ta kuptojnë me të gjitha aspektet e saj më mirë se ai të cilit i intereson. Prandaj mund të gabojnë në fetvanë që japin. Por, ngaqë zëri i zemrës gjithmonë frymëzon të drejtën, mundësia për të gabuar ulet ndjeshëm.

Fakti që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ra me gishtat e tij të bekuar në kraharor Vabisa ibn Ma'bedit, radijallahu anhu, duke i thënë me këmbëngulje: **"Pyet zemrën tënde! Konsultohu me zemrën tënde!"** (Darimi, Buju, 2.), tregon se secili i di më mirë problemet e veta. Njëherazi shprehet qartë se, kur në zemër ka ndonjë dyshim apo hezitim, menjëherë duhet të

largohemi nga ajo vepër.

Vaisa ibn Ma'bedi, radijallahu anhu, ishte një hero, i cili i kishte bashkuar në jetën e tij dijen, veprën, sinqeritetin dhe dashurinë si të gjithë sahabët e tjerë.

Ebu Rashid el-Ezdi thotë për të:

"Kurdo që shkoja te Vabisa ibn Ma'bedi (r.a.), e gjeja Kuranin të hapur para tij. Kur ai lexonte Kuran, nuk e mbante dot veten dhe qante derisa i lagte fletët e tij (Kuranit).

Kur një herë shkova pranë tij, i thashë: "A e ke pyetur të Dërguarin e Allahut, (a.s.), për ndonjë gjë?" Ai m'u përgjigj:

"O Ebu Rashid! Çdo gjë që më ka ardhur në mendje ia kam pyetur. Madje, e kam pyetur edhe për dispozi-tën e papastërtisë në thonj." Ai (s.a.s.), më tha:

"Nëse ka papastërti aq sa mund të të shqetësojë, pastroje. Përndryshe mund ta lësh ashtu siç është." (Musned, 4/228.)

Vabisa ibn Ma'bedi, (r.a.), edhe për hadithin që tregon për përçarjet e mëdha të mëvonshme thotë se e ka dëgjuar nga Abdulla ibn Mes'udi, radijallahu anhu.

Ebu Davudi e transmeton kështu këtë hadith fisnik, që tregon se si duhet të sillen besimtarët atë ditë:

"Ibn Mes'udi, radijallahu anhu, transmeton se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), duke thënë:

"Me të vërtetë, në të ardhmen do të ndodhë një përçarje.

Atë kohë, ai që do të jetë i shtrirë, do të jetë më i mirë se ai që është i ulur. I uluri do të jetë më i mirë se ai që është në këmbë. Ai që do të jetë në këmbë, do të jetë më i mirë se ai që ecën. Ai që do të ecë, do të jetë më i mirë se ai që vrapon.

Të gjithë ata që vdesin në përçarje, do të jenë në zjarr."

Vaisa, radijallahu anhu, e pyeti ibn Mes'udin, (r.a.):

"Kur do të ndodhë kjo?"

Ai u përgjigj:

"Do të ndodhë në ditët e vrasësve, kur njeriu nuk do të jetë i sigurt prej shokut të tij."

Vaisa, radijallahu anhu, i tha:

"Nëse e arrij atë kohë dhe ato ditë, çfarë më urdhëron dhe çfarë më këshillon të bëj?"

Ibn Mes'udi, (r.a.), iu përgjigj:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Ndaloje gjuhën dhe dorën tënde nga përçarja. Bëhu si një shtrojë prej shtrojave të shtëpisë. Vazhdimisht qëndro në shtëpi."

Vaisa ibn Ma'bedi, (r.a.), përgjatë gjithë jetës së tij nuk e harroi dhe nuk e nxori nga mendja këtë hadith fisnik.

Kur ndodhte ndonjë gjë ndërmjet sahabëve të nderuar, menjëherë i kujtohej ky hadith i Diellit të dy Botëve (a.s.).

Ai pothuajse e priste atë ditë, ngaqë e dinte se do të ndodhnin fitne të mëdha.

Kur Osmani, radijallahu anhu, u martirizua, vendosi të largohet.

I hipi kafshës së tij dhe shkoi në Sham.

Atje u takua me Hurejm bin Fatikin, radijallahu anhu.

Atij i tregoi për ato që i kishte thënë ibn Mes'udi (r.a.).

Kur Vabisa ibn Ma'bedi, (r.a.), i tregoi për këtë çështje, Hurejmi, (r.a.), u mahnit shumë dhe e pyeti: "Pash Allahun që nuk ka zot tjetër përveç Tij, a e ke dëgjuar diçka të tillë?"

Vaisa ibn Ma'bedi, (r.a.), iu përgjigj:

"Pasha Allahun që nuk ka zot tjetër përveç Tij, ibn Mes'udi, radijallahu anhu, më ka thënë se këtë e ka dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, (a.s.)"

Hurejm bin Fatiki, (r.a.), i tha: "Pasha Allahun që nuk ka zot tjetër përveç Tij, edhe unë e kam dëgjuar atë hadith."

Vabisa ibn Ma'bedi, (r.a.), jetoi në Kufe dhe në Rakka. Vitet e fundit të jetës së tij i kaloi në Rakka dhe po aty ndërroi jetë në vitin 60 hixhrij. (Dhehebi, Tarihu'l-Islam, II, 500.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

Allahu Teala na mundësoftë të marrim shembull nga sjelljet e atyre njerëzve model për ne dhe nga dashuria e pasioni i tyre për të mësuar dije. Zoti na bashkoftë me ta në xhenet!

Amin!



THIRRJE PËR NAMAZ

Hajredin Karaman

Era e liberalizmit, e cila fryn si era e shkretëtirës dhe që i ka tharë vlerat tona, patjetër që ka ndikuar edhe te disa myslimanë, të cilët kanë dalë kundër marrjes së masave me metoda të përshtatshme për dhënien e mësimi të fesë brenda në familje, për gjelbërimin e virtyteve dhe për të ndaluar veprimet e gabuara, gjërat e turpshme dhe ato që janë mëkat. Ata thonë: "Lëreni që secili ta zgjedhë vetë fenë dhe moralin e tij. Lëreni që secili ta jetojë jetën sipas parimeve të tij..."

Besimtar është ai që nuk e shikon veten të mjaftueshëm, që beson se ka nevojë për udhëzimin hyjnor, që të arrijë suksesin e lumturinë në dynja dhe ahiret, që pason Pejgamberin, të cilin Allahu e ka dërguar si shembull dhe që përpiqet të ecë në gjurmët e tij.

Sipas Kuranit Fisnik, **"Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."** (Alak, 6.)

Udhëzimi hyjnor u thotë besimtarëve:

"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..." (Tahrim, 6.)

Kryetari i familjes dhe individët e tjerë të saj duhet t'i ruajnë pjesëtarët nga sjelljet, zakonet dhe neglizhimet, që bëhen shkak për ndëshkim në ahiret.

Si do t'i mbrojnë?

Ata duhet t'i mbrojnë me mënyrat më të përshtatshme, duke i ndaluar nga veprimet që janë mëkat, të gabuara dhe të turpshme, duke i urdhëruar të bëjnë gjërat e duhura dhe duke i ndaluar të mos i bëjnë ato që nuk duhen bërë.

Si do ta heqë nga supet përgjegjësinë një pjesëtar i familjes, nëse nuk e qorton pjesëtarin tjetër që nuk fal namaz dhe, nëse nuk e inkurajon atë për këtë? Allahu i madhëruar në Kuranin Fisnik, thotë:

"Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë!..." (Ta Ha, 132.)

Ky ajet fisnik i urdhëron të mëdhenjtë e familjes të falin namazin rregullisht, t'i thërrasin pjesëtarët e tjerë të falin namazin dhe të mos i

lënë të lirë ata në çështjen e faljes së tij. Përsëri, Allahu Teala thotë:

"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahë dhe armiqësi!" (Maide, 2.)

A nuk janë në kundërshtim të plotë me ajetin e mësipërm sjelljet e pjesëtarëve të familjes me në krye prindërit, nëse pjesëtarët e familjes nuk e falin namazin, nuk agjërojnë, nuk i kryejnë farzet e tjera, shkelin ndalesat dhe nuk e qortojnë njëri-tjetrin kundrejt këtyre mëkateve?

Pejgamberi, (a.s.), thotë se ne duhet t'i ushtrojmë fëmijët tanë ndaj namazit që nga mosha shtatëvjeçare.

Pejgamberi shprehet se pjesëtarët e familjes dhe veçanërisht kryetari i saj, janë përgjegjës për familjen.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e mbaronte namazin e natës, e zgjonte edhe bashkëshorten e tij Hz. Aishen dhe i thoshte: **"Ngrihu dhe fale vitrin!"**

Edhe ky hadith i përket të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

"Allahu e mëshiroftë atë njeri që ngrihet natën, e fal namazin e natës, e zgjon bashkëshorten për namaz nate dhe, nëse nuk ngrihet, i hedh ujë në fytyrë!"


Kanë thënë:

"Namazi është një adhurim. Adhurimi nuk bëhet me imponim. Njeriu duhet ta falë namazin me vullnetin e tij dhe pa u imponuar, në mënyrë që të pranohet si adhurim!"

Kjo fjalë është e vërtetë, por a nuk i edukojmë së pari fëmijët tanë dhe të gjithë njerëzit për të bërë atë që është e mirë dhe e dobishme dhe për ta lënë atë që është e keqe dhe e dëmshme për dynjanë e ahiretin? Apo themi: "Ta lëmë, të bëjë çfarë të dëshirojë. Në dashtë, le të bëhet i mirë, në dashtë le të bëhet i keq dhe i pamoralshëm?"

Dëshirat dhe ndjenjat tona njerëzore mund të na shtypjnë në mëkat, në gabim, në padrejtësi dhe në lënien e ibadeteve. Nëse i orientojmë njerëzit te e mira e mirësia dhe përpiqemi t'i ndalojmë nga e keqja e mëkati, duke i arsimuar në kohën e duhur dhe duke ndërhyrë në mënyrën më të përshtatshme kur të jetë e nevojshme, për liberalët nuk e di, por ne si besimtarë kemi kryer detyrën tonë.

Nëse i ndihmojmë njerëzit për t'i mposhtur dëshirat vetjake që të shpien në mëkat dhe për të bërë vepra të mira, të cilat nuk kanë mundësi t'i kryejnë pa ndonjë mbështetje, në fund këta njerëz arrijnë lumturinë dhe pas periudhës së edukimit, i kryejnë adhurimet me vullnet e me dëshirë.



VARFËRIA, FANATIZMI DHE FETARIA E THATË

M. Muhtar esh-Shankiti

Ne myslimanët jemi një umet që nuk e pranojmë imitimim dhe të paaftë për ixtihad. Ky është misteri i vuajtjes sonë aktuale. Tashmë ka ardhur koha për të shpëtuar nga ky qorrsoak.

Ibn Rexhebi, në librin me titull “Zejl Tabakati el-Hanabile” transmeton nga Ibn Akili lavdërimin që u bëhet Hanbelive të Bagdadit. Në këtë lavdërim zënë vend këto shprehje: “Ishin një popull me temperament të fortë. Morali dhe karakteri i tyre nuk i lejonte të përziheshin me njerëzit. Ndërmjet tyre sundonte serioziteti. Ndërsa shaka bënin pak.”

Allame edh-Dhehebiu, në librin me titull “el-Iber fi haberi men Gaber”, transmeton këtë, në lidhje me Shejh Abdussettar el-Mukaddesin dhe thotë: “Ai u preokupua me sunetin. Debatoi me kundërshtarët dhe u bëri tekfir. Sulmoi shkollën Esh’arite dhe e akuzoi me texhsim (antropomorfi). Pastaj kundërshtoi Hanbelitë dhe i la. Ai kishte një moral të vështirë e të ngurtë që e shoqëronte mirësia dhe feja e thatë.”

Përsëri edh-Dhehebiu, në librin me titull “Sijeru Al’ami’n-Nubela”, duke komentuar fjalët e Shejh Ebi Hatim bin Hamusit: “Asnjë njeri që nuk është Hanbeli, nuk është mysliman”, thotë: “Ebu Hatim bin Hamusi merrej me hadithin. Ai kishte një kuptim të thatë dhe një moral të vështirë.”

Fjalët e Ibn Akilit, në lidhje me temperamentin e Hanbelive dhe të Dhehebiut në lidhje me el-Mukaddesin e

me Ibn Hamusin, janë bërë përmbledhje e cilësive më të rëndësishme ideore dhe psikologjike të disa thirrësve selefi dhe burrave të kësaj lëvizjeje:

-Ata merreshin me mbledhjen e sunetit profetik dhe me shqyrtimin e zinxhirëve të transmetimit të tij. Me ta, Allahu në këtë fushë i bëri dobi umetit në përgjithësi. Ata, siç ka ndodhur edhe në shekujt e mëvonshëm, nuk e merrnin lehtë çështjen e transmetimit, por selefitë nuk i bashkuan dot frytet e transmetimit me konceptimin e mendjes. Për këtë arsye, dokumentimi i transmetimeve te ata ngeli i privuar nga analiza dhe fikhu ngeli i privuar nga transmetimet.

Madje, në traditën e disa selefivë mendja e logjika u pranuan si ofendim dhe me vetë vullnetin e tyre u zhveshën prej saj sikur të mos e kishin dëgjuar fjalën e poetit Umer bin el-Verdi: “Si mund të vrapojë në çmenduri një njeri që mendon?”

-Ata u zhytën në debate lakmitare në çështjet e itikadit. Kjo gjendje argumenton se selefizmi bashkëkohor është kthyer në një situatë të ngjashme me ekolin e kelamit, që është i apasionuar për t’u zhytur në çështjet delikate të akaidit, pa pasur ndonjë nevojë sheriatike. Kjo nuk përputhet me metodën e selefizmit, e cila është formuar mbi modestinë larg vështirësimit, lojërave teo-

rike dhe zhytjeve në çështje delikate, përveç kur është e nevojshme.

-Kundërshtarët e tyre myslimanë i sulmojnë ashpër dhe u bëjnë tekfir në shumë çështje që kundërshtimi është i lejuar. Mund të themi edhe këtë: Ndërkohë që ithtarët e feve të tjera përipiqen ta shtojnë numrin e tyre, disa selefi mundohen ta pakësojnë numrin e myslimanëve. Natyrisht, disa xhemate selefije kanë tërhequr shumë probleme dhe vështirësi ndaj vetes. Përsëri ata kanë hapur plagë të thella në strukturën e umetit, për shkak të sjelljeve të ashpra ndaj kundërshtarëve dhe tekfirit që u bëjnë.

Ky konceptim largues nuk njihet asnjë kufi. Çdo ditë e ngushtojnë hallkën dhe i nxjerrin jashtë konceptit "es-sunnetu ve'l-xhema" disa prej grupeve të reja, që me të vërtetë zotërojnë këndvështrime selefiste. Këtë koncept e kanë kthyer në një mur të lartë ndërmjet tyre dhe umetit në përgjithësi.

-Së fundi, vjen vetia e një fetarie të vrazhdë, të ngurtë dhe të thatë larg simpatisë, butësisë, ndjenjës, delikatesës shpirtërore dhe kënaqësisë së bukurisë. Kjo logjikë e imponimit dhe e epërsisë është një fetari e përzgjedhur ndaj logjikës së bindjes dhe fitimit. Sipas disa xhemateve selefije, kjo prirje ka një plan të pasëm historik dhe shoqëror. Ndërsa sipas disa selefivë të tjerë, kjo prirje buron nga metoda e arsimit dhe edukimit. Kjo metodë mbështetet në mburrjen intelektuale dhe në frikën kulturore.

Këto cilësi nuk janë të përgjithshme për të gjithë selefitë apo hanbelitë. Përgjithësimi i kësaj nuk është larg padrejtësisë. Po në të njëjtën mënyrë, ky vlerësim (që bëhet për hanbelitë), nuk do të thotë se është i pavlefshëm edhe për klasat fetare të tjera, sepse edhe ato nuk janë larg këtij. Në këtë material kemi shtjelluar shkollën selefite, për shkak se këto cilësi janë më evidente te ata dhe që sot në fushën e fesë kanë mjaft ndikim.

NËSE IDENTITETI VRET REFORMËN DHE ZHVILLIMIN

Profesori i Akademisë Britanike dhe i Universitetit të Oxfordit, Abdulhakim Murad, thotë se disa selefi e kanë konkretizuar mburrjen intelektuale dhe nënvlerësimin dhe këtë e ka quajtur "varfëria e fanaticizmit" (poverty of fanaticism). Ndërsa ne do ta quajmë "medresetu'l-iktifa ve'l-inkifa" (shkolla e mjaftueshmërisë dhe e mbylljes në vetvete).

Fanatizmi është pjellë e ndjenjës së një mjaftueshmërie të gabuar, që nuk ndjen nevojë për kulturën, dijen dhe mënyrën e jetesës së të tjerëve. Në historinë e kulturës ka një të vërtetë, e cila është: Hapja dhe toleranca sjellin pasuri intelektuale e shpirtërore, ndërsa fanatizmi shkakton varfëri intelektuale dhe joproduktivitet shpirtëror.

Filozofi Claude-Levi Straus thotë se nxjerrja në pah e diçkaje të re mund të realizohet vetëm në kufirin ndërmjet dy kulturave. Ndërsa filozofi Muhamed Ikbali, këtë

vlerësim e shpreh në formën e një kornize islame: "Bota islame mund të zhvillohet vetëm me një zemër lindore dhe një mendje perëndimore." Të gjithë ata që e burgosin veten në kulturën historike, e dënojnë atë në joproduktivitet dhe zbehtësi. Ky debat i hapje-mbylljes ka një lidhje të fuqishme me ekuilibrin e fuqisë dhe dobësisë.

Popujt në periudhat e fuqishme priren ndaj besimit të vetes, ndaj kureshtjes për dije, ndaj dashurisë për të zbuluar dhe ndaj etjes për informacion, në periudhat e dobësisë i kaplon dobësia e besimit në vetvete, e fanatizmit fetar dhe i refuzojnë shumëllojshmëritë intelektuale, etnike e kulturore.

Arabët dhe myslimanët zgjeroheshin dhe evoluonin në periudhat kur ishin të fuqishëm e të zhvilluar. E ekzaminonin botën dhe përipiqeshin për të mësuar ndonjë gjë nga çdo popull dhe kulturë. Madje, ata gjetën dikë si el-Biruni që të shkruajë librin "Fjalët e pranueshme apo të papranueshme nga mendja e indianëve". Ndërsa sot shikojmë se selefitë shfaqin metoda që nxjerrin në pah një personalitet të lëkundur e që frikësohet nga vetvetja si "lufta intelektuale e kulturore".

Për shkak të këtij personaliteti, që e ka humbur besimin ndaj vetvetes, u humb mendimi i përmirësimit dhe i zhvillimit për të cilin ftonë Afganin, Muhamed Abduhu e të tjerë si këta para njëqind vitesh. Mentaliteti i identitetit dhe frika që ndihej për këtë, e vrau mendimin e reformës që kërkonte me këmbëngulje Reshit Rizai, ndërsa selefitë e kundërshtojnë.

Ridvan es-Sejjid, në librin e tij me titull "Sijasetu'l-Islami'l-Muasir" vrojton shkëputjen ndërmjet shkollës së reformës në kohën e Abduhut e të Afganit, që çështje më kryesore kishte zhvillimin dhe mentalitetin islam në gjysmën e dytë të shekullit XX, që më shumë ishte i prirur ndaj identitetit.

Për këtë arsye, Ridvan es-Sejjid mendon se Muhamed Abduhu vjen para Reshit Rizasë, Reshit Rizaja para Hasan el-Bennas, Hasan el-Benna para Sejjid Kutubit dhe Sejjid Kutubi para Umer Abdurrahmanit. Reshit Rizai në fillim ishte reformator, pastaj kaloi në selefizëm dhe mbyllje në vetvete. Ai është hallka e kalimit ndërmjet dy shkollave. Për këtë arsye, Dr. Muhamed Ammara refuzon që Reshit Rizaja të vendoset në kategorinë e reformatorëve. Ammara ia ka qëlluar në këtë çështje, sepse reforma dhe përmirësimi nuk përputhen me metodën e mjaftueshmërisë dhe mbylljes në vetvete.

SELEFIZMI MBRETËROR DHE SELEFIZMI KAOTIK

Kur para disa vitesh po bisedoja me profesorin tim me origjinë Libaneze në Universitetin e Teksasit për selefizmin, ai bëri një vlerësim që meriton të mendohet shumë dhe tha: "Selefizmi është dy lloj: Selefizmi mbretëror (monarkist) dhe selefizmi kaotik (anarkist)." Ky vlerësim e përmbledh shumë bukur thellësinë e krizës metodike të selefivë.

Selefitë nuk kanë bërë ndonjë program deri tani për ndryshim pozitiv. Ata janë në prirjen e bindjes ose të përballimit të rreptë. Falënderimi i qoftë Allahut që selefitë nuk janë burgosur vetëm brenda këtyre dy rrymave. Në periudhën e fundit ka dalë një rrymë e tretë që është më afër shpirtit të reformës dhe përmirësimit. Kjo rrymë mban një rrugë ndërmjet këtyre dy rrymave ekstremiste mbi të cilat po flasim në këtë material.

Selefizmi mbretëror legalizon ato që bëjnë drejtuesit e padrejtë dhe e këshillon popullin t'u bindet e t'u nënshtrohet atyre. Popullin e sugjerojnë të qëndrojnë larg fitnes dhe përçarjes... Madje, disa fakihë të tyre kanë dhënë fetva se protestat paqësore janë haram dhe se një studenti të dijes nuk i ka hije të ndjekë kanalën el-Xhezira, sepse velijju'l-emr nuk e pëlqeka këtë kanal!!!

Ndërsa selefizmi kaotik, në të njëjtën kohë u ka dalë kundër drejtuesve e shoqërisë dhe përpiqet ta hedhë në ajër të gjithë universin, duke shpresuar se do të lindë një botë e re, për cilësitë e së cilës nuk kanë ndonjë imagjinatë të qartë.

Të gjitha këto nuk do të thonë se këto dy rryma kanë kontradikta në çdo gjë. Përkundrazi, rryma mbretërore bie në konsensus me rrymën kaotike në ashpërsinë intelektuale, jurisprudenciale dhe në pronuncimin e zjarrtë që pothuajse rrethon të gjithë kundërshtarët. Faktikisht, mund të themi këtë: Selefizmi kaotik, krahas rrezikut të qëndrimit praktik, përshtatet më shumë me tezat teorike dhe bie më pak në kundërshtim me logjikën e tyre. Ndërsa selefizmi mbretëror shfaq një kontradiktë të qartë qesharake ndërmjet ashpërsisë intelektuale dhe nënshtimit praktik.

Ndërsa lidhja logjike ndërmjet dy shkollave selefite është shumë e fortë. Secila prej tyre merr nga tjetra shkaqet e qëndrimit në jetë, të zhvillimit e të lartësimin. Selefizmi mbretëror e vlerëson si largim nga bindja dhe copëtim të xhematit çdo qëndrim kundër ligjeve të shëmtuara, të cilat shikohen sot nëpër shtetet myslimane. Në këtë mënyrë, ai është i paaftë të ndajë nga njëra-tjetra opozitën paqësore me kryengritjen e armatosur në aspektin e fikhut.

Për këtë arsye, përpara të rinjve të zjarrtë nuk lë rrugë tjetër përveç ashpërsisë që nuk ka logjikë. Ndërsa selefizmi kaotik, me ashpërsinë e verbër që shfaq pa pasur ndonjë plan frenimi moral dhe ndryshimi programor, e forcon ndikimin e selefizmit mbretëror dhe i jep të drejtë metodës së tij. Në këtë mënyrë të dyja shkollat ushqehen nga njëra-tjetra.

LARGIMI NGA IMITIMI DHE PAAFTËSIA PËR IXHTIHAD

Proceset kalimtare në jetën e shoqërive nuk ndodhin pa dhunë dhe dhimbje. Këtë e shikojmë në historinë e Europës në ditët e revolucionit francez dhe në historinë e Amerikës në ditët e revolucionit amerikan. Normalisht edhe popujt myslimanë që po përjetojnë proceset ka-

limtare sot, për fat të keq, nuk po ndodhin pa dhunë. Ky bllokim politik që gjendet te popujt, është i thellë dhe kronik.

Përsëri, prapambetja në fushat e strukturës administrative, ligjore dhe zbatimit të ligjit te këta popuj, është në përmasa skandaloze. Të gjitha këto janë nga një shkak që u hap derën shumë lloj dhunash intelektuale dhe politike. Kjo dhunë mund të veshë pektun e fesë, siç ndodh te selefizmi kaotik i sotshëm, por mund të veshë edhe pektun sekularist, siç ndodh te grupet e majta të shekullit të njëzetë.

Por kur të shikohet në thellësi, vihet re se kjo dhunë, siç mund të jetë shprehje e një transformimi dhe krize kalimtare shoqërore, po ashtu është edhe njëra prej shenjave të mosekzistencës së ligjit politik në popujt myslimanë e veçanërisht ata arabë. Sot vendet tona kanë nevojë që njerëzit e mençur të marrin në dorë drejtimin e punëve, t'i nxjerrin popujt nga procesi kalimtar ku realisht ndodhen dhe t'i lartësojnë në aspektin intelektual, shoqëror e politik duke paguar sa më pak kundërvlerë dhe duke hequr sa më pak dhimbje.

Dhuna intelektuale e politike, siç nuk është një alternativë ligjore, nuk është edhe një alternativë diktature, përkundrazi dhuna e fuqizon diktaturën, e legalizon atë dhe ia zgjat jetën.

Kjo çështje lidhet me shkallën e praktikimit të demokracisë së vërtetë dhe lirisë së zgjedhur te popujt tanë. Popujt e lirë kanë potenciale për ta rregulluar veten e tyre me metoda të qytetëruara. Ndërsa në popujt e shtypur, njerëzit strehohen në logjikën e fuqisë me pretekstet më qesharake. Në këtë mënyrë, populli mbetet i izoluar ndërmjet shpatës së prijësit tiran dhe tesbihëve të dervishit servil. Që të dy këta, siç thotë Muhamed Ikbali, janë fatkeqësi për të ardhmen e umetit dhe të popullit.

Deri kur do të zgjasë heshtja ime?

Sulltani dhe dervishi kënaqet shumë nga kjo.

Me këtë tesbih e me këtë shpatë,

Që të dy jetojnë me gjërat që u japin ato.

Ne myslimanët jemi një umet që nuk e pranojmë imitimin dhe të paaftë për ixhtihad. Ky është misteri i vuajtjes sonë aktuale. Tashmë ka ardhur koha për të shpëtuar nga ky qorrsokak. Refuzimi i imitimit është krenari dhe nder. Në këtë çështje toleranca nuk është e lejuar. Ndërsa paaftësia në ixhtihad është poshtërsi dhe shkatërrim. Te ne reforma duhet të fillojë me shpëtimin e fesë nga pushteti i shtetit. Liria e ndërgjegjes është baza e besnikërisë së etikës së vërtetë. Ndërsa liria e mendimit është baza e nxjerrjes në pah së një gjëje të re.

Kur të respektohet liria dhe parimet islame që e bëjnë të lirë njeriun, atëherë do të dalë në pah fallsiteti i fetarisë së rreme që i prangos këto parime dhe e kthen në instikt shkatërrues shpirtin e mirë dhe krijues që sjell Islami. Tashmë, ka ardhur koha që, pa na ikur ky shans, të përballemi me varfërinë e fanatizmit dhe fetarinë e thatë.

RUAJTJA

nga përgojimi

Sadik Dana

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Kur më nxorën në qiej natën e miraxhit, pashë një grup njerëzish. Nga kraharorët e tyre këputej mish dhe u jepej kafshata-kafshata në gojë. Atyre u thuhej:

"Hani mishin e vëllezërve që i përgojuat!...! Kur e pashë këtë pamje, e pyeta Xhebrailin:

"O Xhebrail! Kush janë këta?" Ai m'u përgjigj: "Këta janë përgojuesit prej umetit tënd."

Xhabiri dhe Ebu Saidi, radijallahu anhuma, transmetojnë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Largohuni prej përgojimit. Sigurisht, përgojimi është më i keq se imoraliteti, sepse, nëse dikush bën imoralitet dhe pendohet, Allahu mund t'ia pranojë pendimin. Por atë që përgojon, Allahu nuk e fal, derisa ta falë i përgojuari."

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kur të flasësh për vëllain mysliman diçka që atij nuk i pëlqen, e ke përgojuar atë."

Miqtë e Allahut, arifët dhe të sinqertët janë ata që e sundojnë zemrën, gjuhën dhe i kryejnë adhurimet. Të flasësh për të tjerët dhe të përgojosh është shumë e lehtë, sepse kjo realizohet edhe me ndihmën e nefsit. Si nuk mund ta heqë nga goja çamçakëzin ai që është mësuar me të, nuk mund ta lërë përgojimin edhe ai që është i dhënë pas tij.

Përgojimi është njëra prej sëmundjeve më të këqija shpirtërore në kohën tonë, që po përhapet shumë, ngaqë është pakësuar dija rreth fesë, dija për Allahun dhe frika ndaj Tij. Për të shpëtuar prej saj, duhet t'i dalim për zot vullnetit tonë, të qëndrojmë shumë me të devotshmit e të mirët dhe të marrim pjesë në kuvendet e tyre fetare. Njeriu që e di kuptimin e ajetit **"ue huve meakum ejnema kuntum - Ai është me ju kudo që ju të gjendeni"**, gjithmonë është i kujdesshëm.

Çdo lëvizje dhe sjellje e atij që e kupton se është nën vëzhgimin e Allahut Teala, është në përputhshmëri me kënaqësinë e Zotit, (xh.sh.) dhe me edukatën islame. Ai nuk shfaq sjellje të ulëta. Nuk mund të ulet këmbë mbi këmbë apo duke u shtrirë pa ndonjë arsye të fortë dhe largohet nga ata që e duan shumë dynjanë si dhe nga përgojuesit, ashtu sikur i largohet luanit. Sepse njeriu, do apo nuk do, merr prej gjendjes së atij me të cilin qëndron, domethënë, merr prej veseve të tij. Zgjidhja e kësaj mund të arrihet duke u ngritur në kohën e agimit, duke falur namaz nate dhe pastaj, duke u lutur me insistim:

"O Zot! Më bëj prej atyre që bëjnë punë me të cilat je i kënaqur. Më mbro prej mëkateve dhe veçanërisht prej përgojimit, koprracisë, urrejtjes, smirës dhe prej dashurisë ndaj kësaj bote!" Sepse ka shumë prej adhuruesve që kanë

bërë padrejtësi për shkak të dashurisë dhe interesit të kësaj bote.

Ekspozimi i së keqes së të keqit në vendin e duhur dhe kur është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos dëmtojë të tjerët, nuk është përgojim. Ai që ka informacion për këtë dhe e fshih kur duhet ta ekspozojë, është përgjegjës për të.

Për shembull, nëse dikush dëshiron të bëhet ortak me dikë tjetër, por ai me të cilin dëshiron të bëhet ortak u ka ngrënë paratë disa njerëzve të tjerë, kjo nuk duhet të fshihet, por duhet të thuhet e vërteta kur të pyetet. Nëse personi për të cilin pyetet është i drejtë, duhet të thuhet: "Është shumë i drejtë dhe punon me pastërti në tregti. Është shumë i mirë"

Apo, nëse dikush kërkon dorën e një vajze dhe kërkon informacion prej nesh, së pari duhet t'i tregojmë për cilësitë e larta të asaj vajze. Nëse ajo vjedh apo është e pamoralshme, nuk duhet t'ia fshehim atij, sepse, ai që pyet, na ka besuar. Ajo që na takon ne të bëjmë, është të shprehurit e së vërtetës dhe së drejtës.

Këto të fshehta i thuhet vetëm atij që pyet. Nëse përhapen rreth e rrotull, atëherë kjo kthehet në përgojim.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Ditën e Gjykimit do të hapet libri i sevapeve të dikujt. Ai do të thotë: 'O Zot! Unë pata bërë këto adhurime kur isha në dynja. Por ato nuk janë të shkruara në libër'. Atij do t'i thuhet: 'Ato të janë fshirë nga libri dhe janë shkruar në librin e atyre që i ke përgojuar'."

Ditën e Gjykimit do të hapet libri i sevapeve të dikujt tjetër. Aty shikon ibadetet, të cilat nuk i ka bërë. Atij i thuhet: 'Këto janë sevapet e atyre që të kanë përgojuar'."

Në një hadith fisnik, thuhet:

"Nëse dikush përgojohet, le t'i kërkojë falje Allahut Teala për atë që e ka përgojuar."

Ndërsa në një hadith tjetër fisnik, thuhet:

"Atë që përgojon, Allahu Teala e dënon me dhjetë gjëra:

1. E largon nga mëshira e Tij.
2. E largon nga engjëjt.
3. Ia shkatërron adhurimet dhe të mirat e tij.
4. E largon nga i Dërguari i Tij.
5. I zemërohet.
6. E kthen kokëposhtë kur t'ia marrë shpirtin.
7. I jep ndëshkim të rëndë në varr.
8. Ia lë veprat pa sevape në momentet e vdekjes.
9. E afron drejt xhehenemit.
10. E largon nga xheneti."

Në suren Taha, Pejgamberi ynë i dashur urdhërohet të bëjë dua: **“O Zoti im, ma shto dijen!”** Përderisa Pejgamberit tonë (s.a.s.), nuk i është kërkuar të bëjë dua që t’i shtohet asgjë tjetër nga kjo botë, vallë përse i kërkohet një gjë e tillë? Le të përpiqemi ta kuptojmë gjithëpërfshirjen e duasë që është mësuar nga Vetë Allahu...

Në fenë tonë të bukur, shpallja e së cilës ka nisur me urdhërin “Lexo!”, këshillohet të mësohen të gjitha dijet që i shërbejnë së vërtetës dhe njerëzimit, duke filluar pikësëpari nga dijet fetare. Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.), ka thënë: *“Ai që ka nisur të bëjë udhëtim me qëllim për të marrë dije, gjendet në rrugën e Zotit, derisa të kthehet.”*² Ashtu siç shihet edhe në ajetin kuranor që ka nxitur trajtimin e kësaj teme, po ashtu edhe në hadith, nuk ka ndonjë kushtëzim të llojit të dijes që duhet mësuar. Mirëpo, në hadithe të tjera është vënë theks te dijet që janë të dobishme dhe te fakti që nuk duhet fshehur dituria.

Mund të shprehemi kështu: marrja e dijes së dobishme nis së pari nga marrja e dijes fetare. Minimumi i kësaj është që çdo mysliman të mësojë njohuritë themelore islame. Mirëpo, rrugëtimin drejt dijes nuk i duhet dhënë fund me kaq. Në ditët e sotme specializimet përbëjnë rëndësi të madhe në jetën sociale, ndaj duhet fokusuar në një fushë dhe duhet përpjekur të bëhesh më i dituri i asaj fushe...

Në *Ruhul-Bejan*, ajeti: **“O Zoti im, shtoma dijen!”** shpjgohet kështu:

“Zoti im! Shtoma diturinë, që do të thotë ma shto njohjen ndaj Kuranit, më jep nur nga nuri i tij, më jep edukatë nga edukata e tij, që t’i qasem drejt të vërtetave të Kuranit.”

Le të përmendim këtu qasjen e **Kushejrit** (r.a.), në veprën e tij *Letaif*:

“Kur Musai alejhisselam, kërkoi shumë dije, Zoti i Madhëruar e la në dorë të Hizrit, alejhisselam. Kurse Pejgamberin sal-lallahu aleji ve sel-lem, pa e kërkuar ai vetë, Zoti e ka mësuar të bënte dua që t’i shtohet dituria.”³


I ndjeri **Elmallëllë Hamdi Jazër**, për të shpjguar ajetin: **“Allahu do t’i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija.”**⁴, ndërkohë që po bënte sqarime të detajuara nën dritën e haditheve lidhur me virtytin e të qenit në rrugë të dijes dhe mbi nevojën e të vepruarit me atë çfarë di, përmend një hadith që kalon tek Darimiu: *“Kujtdo që*

1. Taha, 114.

2. Tirmidhî, Ilim, 2.

3. Ruhul-Bejan, Erkam Yayınları, 2008, v. 12, f. 347, 348.

4. Muxhadile, 11.





TA E RISE

i troket vdekja ndërkohë që po fiton dituri me qëllim që të ngjallë Islamin, mes atij dhe peygamberëve ka vetëm një gradë dallimi.” Pastaj shton këto: “Thelbi i të gjitha këtyre është: dijetarët që meritojnë pedestalin e duhur tek Allahu, janë ata që kanë dhënë veten e tyre në dije dhe vepronë me dijen që kanë. Ndaj dhe dijetarët duhet të vepronë me dijen e tyre, që besimtarët t’u bëjnë respektin e merituar...”

Kurse **Ibrahim Hakki Erzurumlu** në *Marifetname*-n e tij, thoshte: “Dija më e dobishme është marifetullahu. Vendi i marifetullahut është zemra e zgjuar.” Kurse për të nënvizuar edukatën e të mësuarit dhe të mësimdhënësit shprehet kështu: “Mësuesi duhet të bëjë kujdes, që nxënësi i tij të mos mësojë gjëra të padobishme dhe t’i mësojë, që diturinë e dobishme të mos e mësojë me qëllim tjetër veçse për hir të Allahut. Kurse nxënësi në prani të mësuesit të tij duhet të qëndrojë me edukatë sikurse në namaz.”⁵

Huxhxtetull-islami, **Imam Gazaliu** shprehet kështu: “Një nga pjesët identifikuese të mësuesisë është të pengojë nxënësin e tij përmes shenjave të caktuara dhe mëshirës të shkojë në rrugë të shtrembëra. Pasi, ta thuash haptazi gabimin e tjetrit, shqyen perden e turpit, i jep mundësinë tjetrit të veprojë keq dhe nxitet të vazhdojë të veprojë ashtu sikurse ka bërë edhe më parë.”⁶

Feja jonë e bukur nxit mësimin e dijës së dobishme me dhembshuri, mësimin me edukatë dhe respekt dhe përhapjen e dijës me qëllim ibadetin; çdo lloj injorance është e refuzuar dhe e përbuzur në Islam pasi në injorancë ka njëfarë përbërjeje nga femohimi dhe kryengritje ndaj fesë. Ndaj dhe dituria është një thesar që nuk shterohet kurrë dhe dobia e diturisë nuk kufizohet vetëm me atë që e zotëron, ajo përfshin të gjithë njerëzit, madje të gjithë krijesat. Ashtu sikurse bëhet e ditur në ajetin e parë, kuptimin e të cilit cekëm më lart, duaja për të shtuar diturinë përbën një rëndësi të veçantë, sepse, sa më shumë t’i shtohet dituria myslimanit, i shtohet edhe thjeshtësia, shpëton nga njëfarë mashtrimi dhe zbrazëtie shpirtërore, që mund ta karakterizojë në rast të kundërt. Kupton të vërtetat dhe përpiqet të bëhet një njeri më i dobishëm.⁷

Sa më shumë ta veshim karakterin tonë me virtyte, do të jemi në gjendje të punojmë, që të jemi prej më të mirëve në fushën tonë dhe gjithnjë e më shumë do të lutemi: **“O Zoti im, shtoma dijen!”**. Nuk ka ndonjë dritë më ndikuese dhe më të ndritshme sesa dituria, për të shpalosur atmosferën plot jetë të Islamit.

5. Marifetname, Erkam Yayınları, 2011, v. 3, f. 519, 520.

6. İhjav Ulumid- Din, Përkth. (turq.) Ahmet Serdaroğlu, Bedir Yayınevi, İstanbul, v. 1, f. 143.

7. Riyazü’s-Sâlihîn, Peygamberimiz’den Hayat Ölçüleri, Erkam Yayınları, 2004, v. 6, f. 156.



PËRSIATJE PËR SHOQËRINË, BASHKËSINË DHE VETMINË

Edlson Çeraj

Shoqëria është një shumë e jashtme individësh mbi baza të pastra interesi, kurse bashkësia është një grupim njerëzish të bashkuar nga një lidhje metafizike, e cila forcon vazhdueshëm ndenjën e përkatësisë.

Shoqëria është e bazuar mbi nevojat materiale, pra mbi interesa. Nga ana tjetër, bashkësia bazohet mbi nevojën shpirtërore, pra mbi qëllime. Në shoqëri njerëzit janë anëtarë anonimë, që lidhen dhe ndahen në varësi të interesit. Ndërsa në bashkësi njerëzit janë vëllezër, të lidhur nga mendimet e përbashkëta, nga besimi te njëri-tjetri ose nga ndenja e natyrshme që janë një. Shoqëria ekziston, meqë, duke jetuar brenda saj, i arrijmë më lehtë të mirat materiale, nëpërmjet të cilave sigurojmë ekzistencën.¹

Pra, përmes shoqërisë sigurojmë ekzistencën, ashtu si çdo gjallesë, ndërsa përmes bashkësisë arrijmë mirëqenien. Domethënë, qenia nuk mund të jetë mirë pa një bashkësi. Trualli më i natyrshëm për t'u përmbushur qenësisht është diku ndërmjet vetmisë dhe shoqërisë, pavarësisht nevojës së përkohshme herë për vetminë e herë për shoqërinë, e cila, siç na mëson përvoja, nuk zgjat shumë, pasi që të dyja janë gjendje *in extremis*.

Fëmija nuk mund të jetojë pa ndihmën e të tjerëve, kurse të mëdhenjtë nuk mund të jetojnë normalisht pa u bashkuar me të tjerët – pikërisht këtu është burimi i shoqërisë në kuptimin e përjashtëm dhe, së këndejmi pastaj edhe burimi i socializimit dhe i idesë shoqërore. Orvatjet e njeriut për të jetuar në shoqëri nuk burojnë nga qenia e tij e njëmendtë, por nga domosdoshmëria si

qenie-në-botë. Nuk kërkohet socializimi si i tillë, por dobia që ai sjell, pat thënë Hobbes-i. Në shoqëri sundojnë ligjet e më të fortit dhe ato të nënshtimit ose, në rastin më të mirë, ligjet e ekuilibrit të interesave. Drejtësia, ndihmesa e ndërsjelltë, solidariteti dhe vëllazëria janë të mundura vetëm në rastin e bashkësisë. Shumë prej mosmarrëveshjeve janë pasojë e kokolepsjes së këtyre dy nocioneve.²

Jezui flet për dashurinë ndërmjet njerëzve – dhe ka të drejtë. Hobbes-i flet për luftën e të gjithëve kundër të gjithëve (ose Marksi për përplasjet e pafundme) – dhe ka të drejtë. Por, Jezui e ka fjalën për bashkësinë e njerëzve, kurse Hobbes-i dhe Marxi për shoqërinë. Adam

2. Po aty (f. 168-169), por e perifrashuar dhe me ndërhyrje komentuese.

Si ilustrim për kundërtinë mes shoqërisë dhe bashkësisë, le të kujtojmë këtu një fenomen me shumë rëndësi në Amerikë, që është shfaqur veçanërisht pas viteve '40. Fjala është për një valë të fortë etnie dhe pluralizmi kulturor, e cila është përhapur gjithandej. Stimuli më i thellë i kësaj vale – siç shpjegon Victor Turner – është gjurmimi i bashkësisë dhe nevoja për bashkimin spontan - *comunitas*. *Comunitas*-i – vazhdon Turner-i – është një bashkësi spontane dhe e vetvetishme. Ai është një "antistrukturë", dhe i kundërvihet që në thelb strukturës shoqërore, "ashtu siç i kundërvihet antimateria hipotetike materies". "Bashkësia është në qendër të religjionit, të letërsisë, dramës dhe të arteve pamore; kurse gjurmët e saj (të ngulitura thellë) mund të hasen te ligjet, tek etika, madje edhe në ekonomi", shprehet Turner-i. Ndërkaq, Dillon Riply, sekretari i Institutit Smithsonian, shpjegon: "Nuk ka kundërmjete të suksesshme për standardizimin e kulturës masive, mirëpo festivalet e jetës popullore ndihmojnë mbajtjen e strukturës së pluralizmit kulturor dhe larminë llamburitëse. Ato zbulojnë dhe përtërijnë bashkësitë që janë mbrojtëse të fuqishme të individit nga bota e mega-shtetit dhe e mega-korporatave." Me sa duket, që e nevojshme të zhvillohej një shoqëri si ajo e Amerikës, në mënyrë që njerëzit të kuptonin disa ndryshime qenësore ndërmjet shoqërisë dhe bashkësisë, si dhe veçanërisht faktin se zhvillimi i shoqërisë nuk të çon te bashkësia – përkundrazi. Kjo lëvizje masive për hulumtimin e rrënjëve (Halley, *Rrënjët*) dhe përtëritjen e traditës, që u shfaq në mënyrë fare spontane në vitet gjashtëdhjetë në Amerikë, mori një shtytje të fortë kur protagonistët e saj ia dolën të organizojnë miratimin e një ligji të veçantë për inkurajimin e etnicitetit (*Ethnic Encouragement Act*).

1. Izetbegović, A. (2009) *Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit*, f. 168. Shkup: Logos-A.

Smith-i zbuloi simpatinë dhe instinktin për hakmarrje, si forca që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Por simpatia dhe instinkti për hakmarrje janë forca që mbretërojnë në bashkësi e jo në shoqëri.³

Në procesin e ndërtimit të shoqërisë, qytetërimi shkatërron dhe këput lidhjet e brendshme, vetjake dhe të drejtpërdrejta ndërmjet njerëzve dhe kësisoj vendosen marrëdhënie të përjashtme, anonime e të tërthorta midis tyre. Të parat janë të mishëruara te lidhjet familjare dhe farefisnore, te ritet e përbashkëta të lindjes, martesës dhe vdekjes, ose te ndihma e drejtpërdrejtë (e ndërsjellë) dhe te brenga e njeriut për njeriun. Në vend të këtyre lidhjeve, që e bëjnë njeriun njeri, qytetërimi krijon ente për përkujdesje dhe bren-gën e lë në dorë të nëpunësve, që gjithashtu edhe ata kanë bren-gat e tyre! Kundruall familjes dhe bashkësisë shpirtërore (xhemati në Islam) qëndrojnë kolektivet prodhuese dhe shteti – pra, institucionet e tij, si shprehje e interesave objektive të anëtarëve të tij. Flitet për shpirtin kolektiv, por ai nuk ekziston. Qytetërimi nuk është në gjendje t'i japë kolektivit atë që nuk e ka vetë. Në fakt, kolektivi është shuma e thjeshtë e anëtarëve të tij, që zakonisht nuk njihen me njëri-tjetrin dhe janë gjithmonë të huaj për njëri-tjetrin. Në një tërësi ata i lidh procesi i prodhimit, godina e fabrikës ose toka bujqësore teksa punojnë; pra, një faktor i jashtëm. Këtu nuk ekzistoj Unë, as Ti, sepse të gjithë jemi Ata. Ky fakt mund të shpjegojë paradoksin e vetmisë nëpër qytetet e zgjeruara me popullsi të madhe.⁴

Afria e njeriut me njeriun është një kategori shpirtërore, jo hapësinore – dhe këtë e dëshmojnë me të gjithë kthjellësinë e tyre lojërat e ndryshme që luhen vetëm. Në të tilla lojëra njerëzit ndihen si në shkretëtirë, edhe pse mund të jenë shumë vetë të grumbulluar në një sallë. Ekziston kolektivi, por nuk ka bashkësi – *comunitas*. Në qoftë se kremtet fetare – ku lutej e luhej – i afronin njerëzit, mbledhjet politike dhe ato për prodhimin e të ardhurat, ose – siç quhen – “mbledhjet e kolektivit” duket sikur i ndajnë edhe më shumë njerëzit. Në thelb kjo është një përçarje, pasi ndarje të tilla sa vijnë e përsëriten në forma të ndryshme.

Sipas të dhënave nga kronikat gjyqësore të një qyteti të madh ballkanik, një e treta e të gjitha proceseve penale për shkak të fyerjeve dhe shpifjeve zë fill në të tilla mbledhje.

Bashkësia e vërtetë mund të themelohet vetëm mbi baza dashurie, simpatie, bashkëpërjetimi dhe altruizmi, pra në bazë të disa ndjenjave që i njeh vetëm religjioni.

3. Po aty, f. 169.

4. Po aty (f. 169-170), gjithashtu e perifrazuar dhe me ndërhyrje k - mentuese

E kundruar hollë-hollë, drejtësia nuk është e domosdoshme për të ekzistuar shoqëria; porse, nga ana tjetër, është një kusht i domosdoshëm për të mbajtur bashkësinë. Rezulton që është e mundur të imagjinohet një shoqëri e fortë dhe e sistemuar, e mbështetur mbi një pabarazi të plotë (le të kujtojmë *Republikën* e Platonit, komunizmin e tij elitari); domethënë, mbi një padrejtësi gjithëpërfshirëse. Pavarësia e shoqërisë nga ideja morale pikaset edhe te fakti se të gjitha shoqëritë janë jomorale në sjelljen e tyre; kjo, sepse shoqëria është një strukturë dhe nuk u nënshtrohet kushteve të qëndrueshme morale, por, para së gjithash, atyre fizike.

Ky ligj ka një vlerë absolute, për aq sa njeriu është kafshë, qoftë edhe më e përkryera. Sa më pak kafshë të jetë njeriu, aq më pak vlen ky ligj. Si përfundim, shoqëria fundoset me të gjitha ligjet e saj në çastin kur njeriu bëhet personalitet, praktikisht në çastin e humanizimit të një turme, grupi apo shoqërie. Në këtë çast nis jeta e bashkësisë.

Mirëpo, ligji për të cilin po flasim shpreh vetëm pamjen teorike të gjërave. Shoqëria e kulluar dhe bashkësia e kulluar ekzistojnë vetëm në parim. Në jetën e jetuar çdo shoqëri merr karakteristikat e bashkësisë, sepse përbëhet nga njerëzit dhe, për më tepër, nga njerëzit e vërtetë. Ajo nuk mbetet vetëm një shoqëri/utopi, por fillon të manifestojë një përmasë njerëzore – deri në një farë mase bëhet bashkësi. Kjo ndodh edhe *vice versa*: ndoshta bashkësitë e para të krishtera janë shembulli më i mirë i bashkësive shpirtërore, mirëpo ndër to nisën të aplikohen drekat e përbashkëta (*agape*), që përfaqësonin edhe disa nota sociale. Këto dhe fakte të tjera për disa u bënë shkas që fillesat e Krishterimit t'i përcaktonin si lëvizje sociale⁵; kurse barazinë e krishterë e morën si një lloj komunizmi. Por duhet thënë se kjo është e gabuar dhe një shenjë e mosnjohjes së thelbit të fenomeneve.

Nëse do kishte vend për një ushtrim matematikor, e gjithë jeta e njeriut, po të mblidhet qëndrimi në vetmi dhe në shoqëri, ka si përfundim bashkësinë.

Siç edhe e prekëm, jeta vetëm në shoqëri, apo vetëm në bashkësi, apo vetëm në vetmi nuk është e mundur, sepse vetë njeriu nuk është i mundur *këtu dhe tani*.

Nëse arrijmë të njohim apo qoftë edhe të nuhasim thelbin e këtyre tri gjendjeve, atëherë jemi duke ecur në rrugën e plotësisimit qenësor.

5. Ja çfarë lexojmë te *Aktet e Apostujve* (kap. 2, vargjet 42-47 dhe kap. 4, vargjet 32-35): “Të gjithë ata që ishin besimtarë u bashkuan dhe e bënë gjithçka bashkë. Ata shinin pronat për t'i ndarë me të tjerët sipas nevojave të secilit...” Këto vargje të kujtojnë formulimin e Etienne Cabet-it, i cili, në shekullin e nëntëmbëdhjetë e përcaktonte kështu bashkësinë e utopistëve: “Secili sipas aftësive, secilit sipas nevojës”, fjalë të përsëritura më vonë edhe nga Stalini.



TË BURGOSËSH

veten

NË BURGUN

me qiell të hapur

Dr. Adem Ergyl

Nga el-Hikemul-Ataijje:

“Vërtet gjithësia mund të të përfshijë fizikisht, por ajo kurrë nuk mund ta përfshijë aspektin tënd shpirtëror. Ata që nuk i kanë të hapura dritaret e botës së gajbit, që janë përtej perceptimit, janë të burgosurit e kësaj bote. Të burgosurit e kafazit të tyre, që quhet trup.”

Pranë madhësisë së kësaj gjithësie të pafund e të pafillim, nuk mund të bëhet fjalë për strukturën fizike të njeriut. Kur hidhet një shikim mbi sipërfaqen e tokës, kur jemi në aeroplan në një lartësi 10 km, njeriun nuk mund ta dallosh qoftë as si një objekt të vockël. Vallë, çfarë e bën njeriun të shenjtë e të nderuar? Cila është enigma e kësaj qenieje, që gjithçka në qiej e në tokë i është vënë në shërbim? Përgjigjja e urtë e Ibn Ataullah el-Iskenderiut është kjo:

“Vërtet gjithësia mund të të përfshijë fizikisht, por ajo kurrë nuk mund ta përfshijë aspektin tënd shpirtëror.”

Ajo çfarë e bën njeriun të papërfshishëm apo mbase gjithëpërfshirës thuhet të gjithçkaje, është aspekti shpirtëror i tij. Me shprehjen e Hz. Aliut, kerremall-llahu vexh'hehu:

“O njeri, ti e pandeh veten si një objekt të vogël, por në fakt e tërë gjithësia është mbështjellë brenda teje.”

Në një hadith, që raportohet si hadith kudsî, i rrefyer veçanërisht nga sufîtë, me qëllim për të shprehur madhështinë shpirtërore të njeriut, thuhet:

“Allahu i Madhëruar ka thënë kështu: Mua nuk më zuri toka e as qiejt, por më zuri zemra e robit tim besimtar.”¹

Kjo shprehje, që transmetohet si hadith, në burimet sufiste është analizuar në forma të ndryshme dhe nga këtu është diskutuar madhështia e zemrës së njeriut, e botës shpirtërore të tij. Fjala vjen, Mevlana Xhelaluddin Rumî, kuddise sir’ruhu, e ka shprehur kështu pafundësinë e zemrës:

“Zemra është një qenie e tillë që, ashtu sikurse këto shtatë herë qiej, po ashtu edhe shtatëqind qiej humbasin në të, thuajse bëhen të padukshëm.”²

Edhe disa sufî, për të shprehur madhështinë e zemrës kanë bërë këto lloj shpjegimesh:

“Arshi dhe gjithçka çfarë ai përfshin, sikur të lireshin në zemrën e *arifit*, *arifi* as që do ta ndjente madje, pasi zemra është aq madhështore, saqë përfshin Arshin, Kursinë, mendjen, nefsin dhe gjithçka që zë hapësirë apo nuk zë.”³

Në Kuranin Famëlartë bëhet fjalë për zgjerimin dhe ngushtimin e zemrës. Në këto ajete tregohet se imani dhe Islami hapin zemrat, kurse mohimi ngushton zemrat:

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu i ndëshkon ata që nuk besojnë.” (En’am, 125.)

“A është njëlloj si ai, të cilit Allahu ia ka hapur kraharonin për të pranuar Islam, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!” (Zumer, 22.)

Bota e meditimit dhe e ndjenjave e kanë të hapur zemrën ndaj Allahut dhe botëve të padukshme (botës së gajbit). Kurse për ata që janë të mbyllur ndaj pranimit të ekzistencës së këtyre botëve, natyrisht kurrë nuk mund të jetë e njëjtë. Horizonti i këtyre dy grupe njerëzish nuk është i njëjtë. Ja sërish Ibn Ataulahu vë në dukje këtë fakt përmes këtyre shprehjeve:

1. Shih. Gazâlî, *Ihjà*, III, 127; Ibn Arabî, *Futûhat*, I, 216; IV, 6; Imam Rabbânî, *Mektûbât*, II, 30. Iraku, që ka bërë studim mbi lhja-në e Gazâlî-t, lidhur me këtë hadith ka përdorur shprehjen: “nuk kam arritur t’i gjej burimin.” (*Ihjà*, III, 127).

2. *Mesnevî*, V, 80, bejta: 872; Shih po ashtu edhe *Mesnevî*, I, 223, bejta: 3488.

3. Për njohur më të gjera, shih: Imâm Rabbânî, *Mektûbât*, I, 100; V - çanërisht shih: Bursevî, *Kitâbu'n-netîxhe*, I, 417

“Ata që nuk i kanë të hapura dritaret e botës së gajbit, që janë përtej perceptimit, janë të burgosurit e kësaj bote. Të burgosurit e kafazit të tyre, që quhet trup.”

Ata që pandehin se gjithësia ekziston vetëm aq sa u japin mundësi sytë e ballit të shohin, janë disa të mjerë që mbulojnë të vërtetën e tyre dhe që burgosin veten e tyre në kafazin e trupit. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar, për të shprehur se janë në një humbje të madhe të gjithë ata që mbulojnë të vërtetën e qenies së tyre, është shprehur kështu:


“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.” (Shems, 9-10.)

Perdja më e errët që e bën njeriun t’i ngushtohet horizonti dhe të burgoset vetëm në ndjesitë e dukshme të tij, padyshim që është perdja e mohimit dhe e shirkut. Është një fakt i patjetërsueshëm që çdo gjynah mjegullon në sasi të caktuar dritaren që na hapet për në botën metafizike, bëhet pengesë për të shikuar përtej. Udhëtimi përtej, thënë ndryshe, begatia e të dëshmuarit të *melekut*-it duke u hapur portat e qiejve, është në varësi të nurit që përmban bota jonë shpirtërore. Secila ftesë dhe çdo mesazh i Zotit është një ofertë e shenjtë që na jep mundësinë të dalim nga vendet e errëta për në vendet e ndritura. Nëse do të mendohet më hollësisht, çdo ftesë e Zotit është një ftesë që na bën për t’u ngritur më shumë drejt horizontit të nurtë. Papërgjegjshmëria ndaj kësaj kërkese, është fatkeqësia e të ndryrit të vetes në dhomat e brendshme të kafazit të trupit dhe si përfundim, është me plot kuptimin e fjalës një vetëburgosje.

Ja pra, edhe liria dhe gjerësia e shpirtit është në varësi të nurit që përmban. Imani është hapi i parë që duhet të hedhë njeriu për të dalë nga kafazi i trupit, për të arritur në zenitin e lartësive, që quhet *alaji il-ljijn*. Dhe kjo gjë arrihet përmes mjeteve shpirtërore, si: ibadeti, dhikri, tefekkuri dhe murakebeja.

Ata që kanë dëshirën e vetme të realizojnë kënaqësitë e trupit, nuk mund të arrijnë në këtë liri të vërtetë. Ajo çfarë arrijnë ata është vetëm vetëburgimi me vullnetin e tyre në burgun e kësaj jete. Ata janë në një farë mënyre, duke u mësuar të jetojnë në një burg me qiell të hapur dhe si rezultat i natyrshëm i kësaj rutine, janë disa të mjerë që arrijnë të shuajnë mundësinë e tyre që të bëjnë një jetë sublime.

Me qëllim që të bëhemi pengesë që shpirti të burgoset, duhet t’i vëmë veshin zërit të peygamberëve dhe evlijave, që flasin për atë që ndodhet përtej. Me shpresën që të lindin brenda nesh dëshira për të shpëtuar nga ky burgim dhe që të jemi të vetëdijshëm gjithnjë për këtë, drejtimi që duhet të bëjmë drejt ofertës së Zotit është mundësia më e rëndësishme e shpëtimit.



Nuredin Nazarko

A MUND TË JETË POPULLI BURIM I PUSHTETIT?

Historikisht njerëzimi ka njohur forma të ndryshme të organizimit institucional dhe shtetëror të qeverisjes. Çdo formë qeverisjeje e ka legjitimuar pushtetin e vet dhe ushtrimin e tij mbi të qeverisurit, mbi bazën e një legjitimiteti të caktuar. Përdorimi i një reference të caktuar si legjitimuese e pushtetit, na vendos përballë pyetjes se nga buron pushteti dhe përse duhet përdorur? Evoluimi i konceptit mbi burimin e pushtetit dhe rrjedhimisht edhe legjitimitetin e tij doli në pah përgjatë ngjizjes dhe konstituimit të formave moderne të qeverisjes.

Sipas formave moderne të qeverisjes, qofshin demokratike apo diktatoriale, si referencë për legjitimimin e pushtetit shërben populli. Kësisoj edhe burimi i pushtetit është populli. Ky është koncepti themelor, ku bazohen si sistemet demokratike të qeverisjes, ashtu edhe të ashtuquajturat demokraci popullore apo demokraci autoritare. Sido që të jenë emërtimet, koncepti bazë mbetet burimi i pushtetit nga populli. Forma, nëpërmjet së cilës realizohet delegimi i pushtetit nga populli tek

ata që do të udhëheqin dhe qeverisin popullin, është të votuarit. Ky është një proces, ku populli shpreh vullnetin e tij për të legjitimuar në ushtrimin e pushtetit një grup të caktuar njerëzish, që janë pjesë e një partie politike të caktuar.

Duke anashkaluar regjimet diktatoriale, në të cilat ekziston vetëm një parti dhe procesi i votimit humbet sensin për të cilin është synuar të aplikohet, kthehemi te regjimet demokratike, ku pluralizmi partiak është një nga shtyllat kryesore të këtij sistemi qeverisës. Nëpërmjet ushtrimit të votimit, populli ua delegon pushtetin të preferuarve të tij, të cilët mund të legjitimohen si pushtetarë të ardhshëm, në qoftë se fitojnë shumicën e numrave të anëtarëve të legjislativit në rastin e demokracisë përfaqësuese. Kushdo që arrin të sigurojë shumicën e numrave, pra të sasisë, do të ulet në karrigen e pushtetit. Qëndrimi në karrigen e pushtetit është kryekëput i përkohshëm, paçka se rotacioni i sasisë së numrave bëhet në afate të përcaktuara kohore.

Është e natyrshme, që kushdo që ulet në karrigen

e pushtetit ka nevojë për kohë, që të përpiqet të realizojë premtimet nëpërmjet të cilave ka fituar sasinë numerike në emër të së cilës do të ushtrojë pushtetin përmbi ata që ia deleguan këtë pushtet. Në rrjedhën e historisë kjo karrige ka njohur shumë fytyra (*pa u ndalur nëse kanë qenë fytyra të pafytyra*), që janë ulur në të dhe janë rrëzuar prej saj, qoftë nga rivalët apo dhe nga vdekja.

E megjithëse fytyrat e atyre që ngjiten drejt kësaj karrigeje dhe bien, ndryshojnë bashkë me rrjedhën e kohës, karrigia mbetet po ajo e njëjtë, duke pritur ulësin e radhës. Përkohësia e qëndrimit në karrigen e pushtetit do të thotë që qenia njerëzore nuk mund të japë pushtet, por vetëm ta ekzekutojë atë brenda limiteve të përcaktuara.

"Ndërkaq, është fare e qartë për këdo se vetë populli nuk mund të japë assesi një pushtet që në të vërtetë nuk e ka. Pushteti i vërtetë nuk mund të burojë, përpos se prej së larti dhe, pikërisht për këtë arsye, nëse mund ta shprehim krejt kalimthi, një pushtet i këtillë nuk mund të shfaqet i ligjshëm, përpos se përmes sanksionimit nga një autoritet më i epërm, sesa vetë rendi shoqëror, shprehimisht këtu, nga një autoritet shpirtëror; në të kundërt, nuk do të kemi tjetër, përpos se një falsifikim të pushtetit të vërtetë, në fund të fundit, një realitet që shpërfaqet krejt i papërligjshëm, për aq sa nuk mbart në vetvete, dhe as nuk mbështetet në një parim themelor apo shkakësi parake, arsye për të cilën shndërrohet vetvetiu në burim rrokopuje dhe mishmashi shoqëror." (Guenon. R. (2009) *Kriza e botës moderne*. Tiranë: Logokron, f.141-142).

Në këtë kontekst, populli nuk mund të jetë kurrësi burim i pushtetit, përderisa pushteti është çështje kompetence dhe *"kompetenca është çështje epërsie, pavarësisht se relative dhe se s'mund të ushtrohet, përpos se nga një pakicë e vogël"*. (Guenon. R. (2009) *Kriza e botës moderne*. Tiranë: Logokron, f. 140).

Ky përcaktim, pra që populli nuk mund të jetë burim i pushtetit, përderisa pushteti i vërtetë buron prej së larti, bazohet në përcaktimin se *"gjithë sa shpërfaqet dhe është në vetvete e epërme nuk mund të burojë assesi nga gjithë sa shpërfaqet dhe është në vetvete e ulët, për aq sa "më shumë" nuk mund të burojë asesi nga "më pak"*. (Guenon. R. (2009) *Kriza e botës moderne*. Tiranë: Logokron, f.141). Ky përcaktim nuk mëton të anashkalojë rolin e popullit në vlerësimin e punës së atyre që qeverisin, por synon të qartësojë faktin që populli

nuk duhet të joshet nga ideja e të qenit i pushtetshëm, pa qenë aspak i tillë. Ndërrimet e ulësve në karrigen e pushtetit, përmes revolucioneve të dhunshme, përmes eliminimit fizik apo qoftë edhe përmes votimit në kohë të përcaktuar, dëshmojnë se çështja e pushtetit është përtej mundësive të popullit, përndryshe, përse populli nuk i ndryshon qeveritë e korrupsuara dhe të padrejta në momentin që zbulohet se këto qeveri kanë devijuar nga qëllimi për të cilin populli u ka deleguar pushtetin, në qoftë se është burim i pushtetit? Në qoftë se populli ia delegon pushtetin e tij një sasi numerike të përcaktuar, do të thotë që edhe në demokraci pushteti do të ushtrohet nga një pakicë njerëzish.

Mirëpo kjo pakicë nuk i korrespondon aspak pakicës së sipërpërmendur, e cila shfaqet sipërane ndaj pakicës demokratike paçka se për këtë pakicë demokratike është rakorduar opinioni i shumicës së pjesëmarrësve në votime (*nuk duhet të harrojmë që opinioni i shumicës mund edhe të manipulohet*). Pakica sipërane është e përnjështuar me pakicën aristokratike, me të cilën pakica demokratike është kryekëput e papajtueshme dhe jo pa arsye.

"Demokracia i kundërvihet egërsisht "aristokracisë", çka nuk lipset vështruar assesi si një qëndrim i rastësishëm dhe pa kurrfarë arsyeje paraprake; e vështruar në domethënien e vet etimologjike, fjala "aristokraci" nuk shënjon tjetër gjë në vetvete përpos se pushtetin e elitës, e cila... nuk mund të jetë tjetër përpos se një pakicë, dhe pushteti i saj apo për tu shprehur disi më saktë këtu, autoriteti i saj nuk buron përpos se nga epërsia që kjo pakicë shpërfaq në rrafshin intelektual, që do të thotë shprehimisht se nuk shpërfaq asgjë të përbashkët me forcën dhe fuqinë numerike mbi të cilën mbështetet "demokracia", prijra thelbësore e të cilës boshtohet kësisoj rreth sakrifkimit të pakicës për hir të shumicës, apo, sikundërse u shprehëm edhe diku më lart, rreth sakrifkimit të cilësisë për hir të sasisë, të elitës për hir të masave." (Guenon. R. (2009) *Kriza e botës moderne*. Tiranë: Logokron, f.151).

Kësisoj edhe aristokracia në kuptimin e sipërpërmendur autoritetin për ushtimin e pushtetit e përfton për shkak të epërsisë së intelektit dhe jo për shkak të ndonjë elementi materialistik. E theksojmë, autoritetin për ushtimin e pushtetit, pasi kjo është edhe natyrshmëria me të cilën ka zbritur në tokë qenia njerëzore, çka do të thotë që njeriut thjesht dhe vetëm i duhet të ushtrojë pushtetin që buron nga statusi mëkëmbës dhe jo të ngashënjehet me idenë e të qenit burim pushteti.





Një Ajet

"O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë ndonjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!"

(Hashr, 10)

Një nga vlerat universale që solli Islami, është vëllazëria njerëzore përtej kombësisë dhe racës. Ky parim shumë i rëndësishëm i fesë islame fiton një rëndësi të veçantë në ditë tona, kur në vende të ndryshme të botës derdhet gjak i pafajshëm dhe vriten mijëra njerëz në emër të nacionalizmit dhe racizmit.

Kurani e shpreh kështu këtë mesazh universal: **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, ndaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."**

Sipas ajetit, vëllazëria në besim nuk qëndron më poshtë se vëllazëria biologjike, madje në disa raste është edhe më e fortë se ajo.

Të gjitha marrëdhëniet midis besimtarëve bazohen mbi këtë vëllazëri. Armiqësia midis tyre nuk mund të mendohet. Nga ana tjetër, ajeti ngarkon me përgjegjësi palën e tretë të besimtarëve, për të sheshuar mosmarrëveshjet e ndryshme që mund të dalin midis myslimanëve të tjerë. Sepse provokimet djallëzore në çdo moment mund të dëmtojnë lidhjen dhe vëllazërinë midis besimtarëve. Për më tepër kur sheshimi i mosmarrëveshjeve midis myslimanëve konsiderohet nga ajeti si shkak për fitimin e mëshirës hyjnore. Një term tjetër që shpreh marrëdhëniet e ngushta midis besimtarëve, është miqësia. **"Besimtarët dhe besimtarët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat."** (Teube, 71.)

Për të promovuar të mirën dhe penguar të keqen, duhet miqësi, konsultim dhe ndihmë reciproke. Prandaj besimtarët janë të bashkuar dhe solidë si një trup i vetëm. Ajeti na

tregon se si besimtarët bashkëpunojnë dhe luftojnë për të njëjtën kauzë. **"Besimtarët, kur i godet ndonjë padrejtësi i kundërvihen së bashku."** (Shura, 39.)

Miqësia midis besimtarëve siguron paqe, siguri dhe qetësi në shoqëri. Në mungesë të miqësisë dhe vëllazërisë shfaqen trazirat në shoqëri dhe mospërfillja e fjalës së besimtarëve. Të mos harrojmë se të gjitha fatkeqësitë e shoqërisë islame kanë ndodhur kur është prishur bashkimi dhe vëllazëria midis myslimanëve. Ajeti kuranor: **"Jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit. Nëse edhe ju nuk veproni ashtu (nuk bëheni miq dhe ndihmues të njëri-tjetrit), do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë."** (Enfal, 73.), a nuk është pikërisht kjo e vërtetë, e cila u tërheq vëmendjen besimtarëve? Pra, besimtarët karakterizohen nga një vetëdijë dhe ndjenjë kolektive.

Fatkeqësisht, myslimanët sot kanë rënë në kurthin e nacionalizmit dhe kanë harruar që dallimet gjuhësore dhe etnike janë një pasuri dhe mëshirë nga ana e Allahut. Në këtë mënyrë, ata harruan çështjet madhore dhe filluan të harxhojnë energji në çështje të parëndësishme.

Ndërsa flet për Ehli Kitab, Kurani prek një pikë shumë të rëndësishme të unitetit shoqëror. **"Ata kanë harruar një pjesë të mirë nga ato që janë këshilluar, prandaj ua shtiem armiqtë dhe urrejtjen midis tyre deri në Ditën e Kiametit."** (Maide, 14.)

Në momentin që besimtarët nuk zbatojnë siç duhet urdhëresat hyjnore, bashkësia përfshihet nga procesi i pakthyesëm i ndarjes dhe përçarjes.

Pejgamberi -sal-lallahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

"Në Ditën e Gjykimit, njeriu më i dashur tek Allahu do të jetë udhëheqësi i drejtë, kurse njeriu më i urryer do të jetë udhëheqësi tiran."

(Buhari)

Një nga çështjet, me të cilën feja islame u tërheq vëmendjen besimtarëve për të qenë të ndjeshëm, është padrejtësia dhe tirania. Allahu, në shumë ajete kuranore e ka shprehur dhe përcaktuar qartë papranueshmërinë e padrejtësisë dhe diktaturës. Kurse në hadithet e Pejgamberit (a.s.), udhëheqësit e padrejtë dhe tiranë, janë mallkuar. Ashtu si mëshira dhe drejtësia e një udhëheqësi të drejtë përfshin gjithë shoqërinë edhe padrejtësia dhe despotizmi i tij ndikon negativisht mbi gjithë shoqërinë. Ndërsa drejtuesi i mirë fiton të gjitha bekimet e popullit, drejtuesi i keq fiton të gjitha mallkimet e popullit. Kjo bëhet më e rrezikshme, kur dimë që lutja e atij që i është bërë padrejtësi nuk refuzohet. Udhëheqësit janë më të prirur për të bërë padrejtësi, për shkak të pushtetit që zotërojnë. Prandaj, gjatë gjithë historisë udhëheqësit kanë pasur rolin kryesor në padrejtësitë, krimet, shfarosjet dhe gjenocidet e ndodhura. Janë plot shembujt e udhëheqësve tiranë nga historia e hershme dhe e tanishme në të gjitha pjesët e globit.

Feja Islame ka marrë të gjitha masat për të parandaluar padrejtësitë e udhëheqësve. Pejgamberi (a.s.), e ka konsideruar si xhihadin më të vlefshëm, të vërtetën e thënë ndaj udhëheqësit tiran. Nga ana tjetër i ka paralajmëruar

besimtarët se, nëse nuk çohen të gjithë për të penguar padrejtësitë e udhëheqësit, Allahu do t'i përfshijë të gjithë, në dënimin e Tij.

Udhëheqësit myslimanë në periudhën e hershme të Islamit, duke iu bindur porosive kuranore dhe profetike kanë treguar drejtësi dhe ndjeshmëri të lartë, jo vetëm ndaj myslimanëve, por edhe ndaj jomyslimanëve. Ishte kjo drejtësi e udhëheqësve myslimanë, por edhe e ndjeshmërisë kolektive ndaj respektimit të drejtësisë, që bëri të mundur të jetonin në paqe për shekuj me radhë grupe të etnive dhe feve të ndryshme. Fatkeqësisht, këto vende, që dikur ishin shembujt të drejtësisë, sot rënkojnë nga padrejtësitë e udhëheqësve të tyre.

Allahu, i cili e ka krijuar njeriun në formën më të bukur dhe pastaj për shkak të veprave të tij do ta poshtërojë me poshtërimin më të ulët, nuk ka për t'i bërë padrejtësi askujt, por despotëve do t'u japë dënimin më të ashpër dhe të dhimbshëm.

Prandaj, përpara njeriut dalin dy alternativa: ose do t'u bindet urdhëresave hyjnore dhe për këtë të fitojë shkallë më të lartë se engjëjt ose në të kundërt, do të bjerë në një shkallë më poshtë se kafshët.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Për udhëheqësin e drejtë ka shpërblime të mëdha, kurse për të padrejtin dënim të ashpër në Ditën e Gjykimit.
2. Fitimi i dashurisë apo urrejtjes së Allahut, për udhëheqësin është i lidhur me drejtësinë e tij ndaj popullit.
3. Islami e kundërshton fort dhunën, despotizmin dhe padrejtësinë e pushtetit.

Mjë Hadith



EDUKATA E DHURIMIT

Nëse shohim thelbin e qëllimit të tasavvufit, vërejmë se ai përbëhet prej *dashurisë*, e cila është mjete kryesor i zhvillimit shpirtëror dhe *edukatës*. Në bazë të kësaj, besimtari qëndron në rrugën që të çon në takimin hyjnor, aq sa ia përkushton thelbin e shpirtit të vet Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s). Dhe treguesi më i rëndësishëm i kësaj, është ngritja e nivelit moral personal, në nivelin e moralit pejgamberik.

Thelbin e moralit pejgamberik e përbën “ndjenja e lartë e edukatës”. Ashtu siç shprehen edhe sahabët fisnikë, i dashuri ynë, Pejgamberi (a.s.), ishte i turpshëm po aq sa një vajzë e virgjër, e mbështjellë me rrobën e saj. Në lidhje me edukatën që zotëronte, vetë Pejgamberi ynë (a.s.), shprehet: *“Mua më ka edukuar Zoti im dhe edukatën time e bëri të bukur.”* (Sujuti, el-Xhami’u-Sagir, I, 12.)

Mevlana, Xhelaledin Rumi, në lidhje me *edukatën*, e cila shpreh virtytin e nivelit më të lartë njerëzor, thotë:

“Nëse do që t’i shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shiko; ajo që e shkatërron shejtanin, është edukata. Nëse biri i njeriut nuk ka edukatë, në të vërtetë ai nuk është njeri...”

Mendja, e pyeti zemrën time: “Çfarë është besimi?”. Ndërsa zemra ime duke u përkulur në veshin e mendjes, tha: “Besimi është edukatë”.

Kjo shpjegon edhe faktin se në të shkuarën, një nga pllakatet që të tërhiqte më shumë vëmendjen në muret e teqeve, ishte: **“Edeb ja Hul”**. Kjo shprehje, përveçse të ftonte në edukatë, në të njëjtën kohë ishte edhe një

lutje/dua, që do të thotë: “O Zot! Na fal edukatë!”.

Ndjenja e edukatës, e cila përbën thelbin e besimit, është një cilësi që përfshin çdo fushë të jetës së besimtarit. Në veçanti, fushën e adhurimit dhe të veprave... Allahu i Madhëruar ka deklaruar duke na e bërë të qartë, se na ka krijuar vetëm e vetëm që ta adhurojmë Atë. Për këtë arsye, adhurimet dhe veprat tona, konsiderohen arteria kryesore e devotshmërisë sonë ndaj Allahut Teala. Pra, devotshmëria pa adhurime dhe pa vepra (të mira), as që mund të mendohet.

Megjithatë, aq sa është i rëndësishëm plotësimi i detyrave të devotshmërisë ndaj Allahut, po aq e rëndësishme është edhe mënyra e plotësimit të këtyre detyrave. Kjo, sepse respektimi i rregullave të edukatës gjatë adhurimeve dhe veprave është kushti i vetëm i arritjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut Teala. Për këtë arsye, adhurimet që bëhen pa respektuar rregullat themelore dhe edukatën, në mënyrë të pakujdesshme dhe vetëm për të kaluar radhën, nuk kanë shpërblime. Madje, ato janë vetëm një lodhje e padobishme për të zotin e tyre. Në lidhje me këtë, në një hadith fisnik, thuhet:

“Ka shumë njerëz që agjërojnë, por ajo që përfitojnë, nuk është gjë tjetër veçse një uri e thatë! Ka shumë njerëz që falin namaz nate, por prej atyre namazeve nuk përfitojnë gjë tjetër, përveçse pagjumësinë.” (Ibën Maxhe, Sijam, 21.)

Namazi, i cili është edhe një nga shtyllat e fesë sonë, ka disa kushte dhe rregulla. Po ashtu, edhe në dhënien e zekatit dhe sadakasë duhen respektuar me përpikmëri

disa rregulla të rëndësishme të edukatës. Përndryshe, ashtu siç janë përmendur me një paralajmërim të ashpër ata që janë të pakujdesshëm në namaz; **“Mjerë për ata, të cilët falen dhe janë të pakujdesshëm”** (Maun, 4-5), ashtu edhe shfaqja e sjelljeve të gabuara gjatë adhurimit të zekatit dhe sadakasë, mund ta çojnë robin në të njëjtin përfundim të keq.

MOS I ÇONI DËM DHURIMET DHE LËMOSHAT TUAJA!..

Allahu Teala, në lidhje me edukatën që duhet të tregojmë gjatë dhurimit, urdhëron:

“Ata, që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.

Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë (nuk nxiton në dënime).

O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun



Ndjenja e edukatës,
e cila përbën thelbin e besimit,
është një cilësi që përfshin
çdo fushë të jetës së besimtarit.
Në veçanti, fushën e adhurimit
dhe të veprave...

dhe Ditën e Fundit...” (Bekare, 262-264.)

Në këto ajete fisnike, Zoti ynë flet qartë për edukatën që duhet të tregojmë edhe gjatë bërjes së mirësive. Pra, një mirësi, e cila bëhet duke thyer zemrat, duke poshtëruar nevojtarin, duke shkakuar hidhërim dhe duke thumbuar, nuk ka asnjë vlerë tek Allahu Teala. Ata që dhurojnë me ndjenja të tilla arrogance dhe ashpërsie, i shkatërrojnë me duart e tyre shpërblimet e asaj që japin!..

T'i kujtosh të mirën që i ke bërë, duke e fyer nevojtarin, jo vetëm që e çon dëm mirësinë që ke bërë, por shkakton edhe zemërimin e Allahut Teala.

Njëherë, Pejgamberi ynë (a.s.), tha tri herë me radhë:

“Janë tre persona, të cilëve në Ditën e Kiametit, Allahu Teala nuk do t’u flasë, nuk do t’i shohë dhe nuk do t’i pastrojë. Ata do të kenë një dënim shumë të dhembshëm”. Ebu Dherri (r.a.), pyeti:

“O Rasulallah! Kush janë këta persona, që iu shoftë emri, mos iu plotësofshin dëshirat

dhe qofshin të humbur?” Pejgamberi ynë (a.s.), u përgjigj:

“Ai që e tërheq zvarrë rrobën e tij (me mburrje dhe mendjemadhësi), ai që e shet mallin e tij duke u betuar

rrejshëm dhe ai që kujton të mirën që ka bërë duke fyer.” (Muslim, Iman, 171.)

Siç shihet, dhurimet dhe lëmoshat për sy e faqe, që shoqërohen me fyerje dhe hidhërim, janë gjynahe të mëdha, të cilat në vend të shpërblimit, e shpiten njeriun në një dënim të dhembshëm. Kjo, sepse zemrat janë epiqendra e vëzhgimit hyjnor. Prandaj dhe nuk duhen lënduar...

Mbi të gjitha, zekati dhe sadakaja, janë e drejta më e natyrshme e nevojtarit, e cila merret prej pasurisë së të pasurve e përcaktuar me urdhër hyjnor. T’i japësh këtë të drejtë të varfrit, nuk është mirësi, por vetëm dorëzim i së drejtës së tij. Pasuria e kësaj bote, është një amanet hyjnor. Prandaj, ta harrosh këtë e të sillësh me dyfytirësi duke e fyer dhe hidhëruar nevojtarin, është shkujdesje, papjekuri dhe injorancë.

Gjatë dhurimit nuk duhet të sillemi me mendjemadhësi dhe nuk duhet ta përçmojmë të varfrin, por përkundrazi, duhet ta vëmë veten në vend të tij dhe të mendojmë se një ditë edhe vetë mund të biem në gjendjen e tij. Edhe pse pasuria dhe varfëria janë çështje disi të lidhura me punën dhe përpjekjen, ato më tepër janë çështje të lidhura me caktimin e Zotit. Allahu Teala mund ta bëjë të pasurin të varfër dhe të varfrin të pasur, sepse këto nuk janë kritere superioriteti apo inferioriteti tek Ai. Të dyja këto, janë një mënyrë sprove vetëm për këtë botë. Superioriteti është vetëm në devotshmëri. Pra, të sillësh me arrogancë dhe mburrje para të varfrit për shkak të dhurimit që bën, do të thotë se nuk e ke kuptuar dhe je i shkujdesur ndaj urtësisë së sprovës në jetën e kësaj bote. Shejh Sadiu, në veprën e tij “Bostani”, shprehet:

“Kur i bën mirësi dikujt, mos u mburr duke thënë: ‘Unë jam zotëri, ai ma ka nevojën! Mos thuaj: Koha e ka goditur atë nevojtar! Sepse shpata që godet, ende nuk ka hyrë në këllëf dhe është e mundur që një ditë, ajo shpatë të të godasë edhe ty.”

Njerëzit e pasur, duhet të dinë se si ta vënë veten në vend të të varfërve dhe duhet të mendojnë: “Zoti mund të na kishte krijuar ne në gjendjen e tyre dhe ata në gjendjen tonë. Por, meqenëse na ka falur mundësi dhe ata i ka bërë nevojtarë, do të thotë se ata na i ka lënë amanet, të dobët i ka lënë në përgjegjësi të të fortëve. Ne na ka bërë përgjegjës për ta dhe ka urdhëruar t’u japim atyre si falënderim ndaj mirësive, që na ka falur Ai...”

Po në të njëjtën vepër, Shejh Sadiu na jep këto këshilla shumë të vryera e kuptimplote:

“Nëse ndonjë i mjerë vjen në derën tënde, mos e nis duarbosh! Allahu të ruajtë, por ndonjë ditë mbase edhe ti mjerohesh dhe troket në dyert e botës.

Interesohu për gjendjen e zemërthyerve dhe kujde-



“A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!”

su për ta. Mbase ndonjë ditë edhe ti bie në gjendjen e tyre.

Ti që nuk troket në dyert e të tjerëve për të kërkuar diçka! Si falënderim për këtë, mos e dëbo të varfrin që troket në derën tënde dhe mos e var fytyrën, por prite buzagaz...”

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!” (Duha, 8-11.)

Pjesa më e rëndësishme sjelljes me edukatë ndaj nevojtarit, është mospërmendja e mirësisë së bërë. Për të mos e hidhëruar nevojtarin dhe për të mos u mburrur para tij, duhet që pasi t’i kesh bërë një mirësi, ta harrosh atë. Sa bukur shprehet Llukmani:

“Dy gjëra mos i harro kurrë: Allahun Teala dhe vdekjen. Ndërsa dy gjëra harroji përgjithmonë: Të mirën që i bën dikujt dhe të keqen që të bën dikush.”

Të bëhesh me kuptimin e plotë të fjalës prej atyre që dhurojnë, është një mirësi shumë e vyer, e cila të fal paqe dhe qetësi në të dyja botët. Ata që arrijnë ta kryejnë në mënyrën e duhur këtë lloj adhurimi, në



"...Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë juaj, nëse këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t'ju rikthehet e plotë dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi."

bazë të përgëzimit të Allahut Teala, do të shpëtojnë prej frikës dhe hidhërimit gjatë krismës së tmerrshme të Kiametit. Për këtë arsye, mëshiruesi i pakufishëm, Allahu Teala, me anë të qindra ajeteve fisnike, ndërsa Pejgamberi ynë (a.s.), që dridhej me mëshirë ndaj umeetit të vet, me anë të shumë haditheve, na motivojnë të arrijmë paqen dhe lumturinë që sjell dhurimi.

Me qëllim që mirësia e dhurimit, vlera e të cilit do të kuptohet më mirë në botën tjetër, të mos shkatërron për shkak të disa sjelljeve të pahijshme, Allahu Teala na paralajmëron ne robërit e Tij, me këtë ajet: **"Mos i çoni dëm dhurimet dhe sadakatë tuaja!"**

Besimtari, është njeri bujar. Ndërsa bujaria e vërtetë është dhurimi me gjithë shpirt, pa u dridhur qerpiku e dora dhe me një qetësi të natyrshme, po aq sa rënia e shiut. Pra, me qëllim që mirësitë të kenë vlerë tek Allahu Teala, ato duhet të bëhen me të njëjtën natyrshmëri me të cilën lulet përhapin përreth aromën e tyre të këndshme!.. Vetëm një dhurim i tillë arrin tek Allahu i Madhëruar. Në një ajet fisnik, urdhërohet: **"... Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet..."** (Teube, 104.)

Sa bukur e shpreh Mevlana i nderuar begatinë e një dhurimi, i cili bëhet me ndjenja kaq të bukura:

"Pasurinë dhe gjithçka që ke, dhuroje në mënyrën më të bukur, që të fitosh një zemër, duaja e së cilës do të të bëhet dritë në varr, në atë natë të errët!.."

Pra, ashtu siç nuk e kursejmë pasurinë tonë ndaj nevojtarit, duhet të mos e kursejmë as buzëqeshjen dhe as mirësjelljen ndaj tij.

I nderuari Shejh Mahmud Sami Ramazanoglu, kur shihte një nevojtar ndërkohë që ndodhej në makinë, e ndalonte atë, hapte derën ecte disa hapa deri tek nevojtari dhe ia dorëzonte sadakanë duke e zbukuruar atë me buzëqeshje dhe mirësjellje.

TË DHUROJMË DUKE FALËNDERUAR

Edukata dhe mirësjellja islame kërkon që dhurimi të konceptohet si një mirësi. Përveç kësaj, ai që jep duhet ta bëjë këtë duke qenë falënderues, sepse ky veprim e shpëton atë prej përgjegjësisë dhe bëhet shkak që ai të fitojë shpërblime prej Allahut Teala. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"...Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë juaj, nëse këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t'ju rikthehet e plotë dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi." (Bekare, 272.)

Nga kjo, kuptojmë se begatinë e vërtetë të mirësisë që bëhet, do ta gëzojë vetë ai që e bën atë, pa asnjë mangësi dhe, në bazë të sinqeritetit të tij, ai do të shpërblehet edhe shumëfish më tepër... Pra, edhe pse në pamje të parë duket sikur prej dhurimit fiton ai që merr, në të vërtetë ai është më i dobishëm për atë që jep. Për këtë arsye, ai që jep, në vend që t'ia kujtojë marrësit mirësinë që i bën, duhet t'i jetë mirënjohës atij. Imam Sha'bi thotë:

"I pasuri, i cili nuk e kupton se ka nevojë për shpërblimin e sadakasë më tepër se i varfri për sadakanë, e ka shkatërruar sadakanë e vet dhe e ka humbur shpërblimin."

Lum për ne, nëse kur të dhurojmë diçka, më parë kontrollojmë zemrën tonë dhe arrijmë bujarinë e vërtetë!..

Ka shumë prej atyre, që bëjnë mirësi duke e kujtuar atë, duke hidhëruar dhe duke pritur ndonjë përfitim prej saj. Mirëpo, ata që e konsiderojnë si mirësi dhurimin dhe nevojtarin, janë shumë të paktë. Robi duhet ta falënderojë Zotin e tij për mundësinë që i ka dhënë për të dhuruar dhe në të njëjtën kohë, duhet t'i jetë mirënjohës nevojtarit, i cili u bë shkak për këtë mirësi.

Kjo këshillë e Shejh Sadiut në lidhje me konsiderimin si mirësi të mundësisë për të dhuruar, përmban shumë urtësi:

"Falënderoje Allahun, që të dha mundësinë të bësh mirë, sepse Ai nuk e kurseu butësinë dhe mirësinë"



ndaj teje. Ai që i shërben sulltanit, nuk mund të presë që sulltani t'ia dijë për nder. Por ai vetë duhet t'ia dijë për nder, që e mori në punë."

Fort i nderuari Musa Efendiu, rahmetullahi alejh, zotëronte kriteret e dhura të edukatës së dhurimit, të cilat ishin për t'u marrë shembull. Ai dhuronte me një mënyrë islame aq të bukur, aq të mirësjellshme dhe aq të edukuar, sa që kujt dhe sa dëshironte t'i jepte, e vendoste në një zarf dhe pasi i drejtohej me respekt, mbi të shkruante:

"Ju falënderojmë që e pranuat dhuratën tonë." Pra, për arsye se u bë shkak që ai të fitonte kënaqësinë e Allahut, e falënderonte prej zemrës nevojtarin dhe tregonte kujdes të madh që të mos e bënte nevojtarin të ndihej i detyruar për mirënjohje ndaj tij.

Në vjershat e tij plot urtësi, Mevlana i nderuar shprehet:

"I skamuri është pasqyra e bujarëve. Kujdes, mos ia zbeh shkëlqimin pasqyrës, duke i thyer zemrën me fjalë fyese!"

"Ashtu siç ka nevojë skamnori për bujarinë dhe mirësinë, ashtu ka nevojë edhe bujaria dhe mirësia për skamnorin. Siç kërkojnë të bukurat, pasqyra pa pluhur, pa ndryshk dhe të shndritshme, të shikojnë bukurinë e tyre, ashtu e kërkon edhe bujaria skamnorin dhe të dobëtin."

"Manifestimi i bujarisë së Allahut del në pah tek të varfrit, të cilët kërkojnë prej bujarëve dhe ua qajnë hallet e veta. Dhe në këtë mënyrë, ata përgatitin

rrugët e lumturisë për të pasurit fisnikë."

Për këtë arsye, faktin që një nevojtar kërkon ndihmë prej nesh duhet ta konsiderojmë si një mirësi prej Allahut dhe një nder që i bëhet besimit tonë. Sa bukur e shprehin këtë të vërtetë këto fjalë të Aliut (r.a.):

"Janë dy mirësi, që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë. E para: Kur dikush vjen tek unë me shpresën se do t'ia plotësoj nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë. E dyta: Kur Allahu ia plotëson dëshirën ose e lehtëson nëpërmjet meje. Unë ndihem më mirë të plotësoj nevojën e një myslimani, sesa të kem një botë të tërë me flori dhe argjend." (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, VI, 598/17049.)

Mburra e atyre që dhurojnë diçka, pritja për falënderim dhe mirënjohje, i fshin të gjitha shpërblimet dhe begatinë e të mirave që kanë bërë. Ai që dhuron diçka, përveç kënaqësisë hyjnore, nuk duhet të bartë qëllime të tjera dhe shpërblimin duhet ta presë vetëm prej Allahut Teala. Të mos harrojmë se të presësh dua dhe falënderim prej nevojtarit, është diçka që hedh hije mbi sinqeritetin e veprës.

Dhurimi që bënin Aliu dhe Fatimja (radijallahu anhuma), në lidhje me të cilin zbriti edhe një ajet përgëzues, duhet të jetë shembull për të gjithë besimtarët që janë bujarë dhe dhurojnë shumë:

"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: 'Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.' Por Allahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim." (Insan, 8-11.)

Ja edhe një shembull tjetër nga nënat e umetit islam, në lidhje me dhënien e sadakasë "hasbeten lillah", pra "vetëm për kënaqësinë e Allahut" dhe mospritjes së ndonjë falënderimi, me qëllim që të mos u pakësohet shpërblimi prej Allahut:

"Nënat tona, Aisheja dhe Ummu Seleme (radijallahu anhuma), kur dëshironin t'u dërgonin diçka të varfërve, e porositnin dërguesin të mësonin përmendsh duanë/lutjen që bënin të varfrit për to dhe në këtë mënyrë, edhe ato bënin të njëjtën dua për ta (të varfrit). Duaja jonë le të jetë e barazvlershme me duanë e tyre, thoshin ato. Kjo, për arsye se ato nuk prisnin dua prej të varfërve, me qëllim që duaja e të varfërve të mos ishte shpërblimi i tyre. Sepse duaja është si shpërblim për sadakanë." (Ihjaw Ulumi'd-Din, I, 601.)

RRUGA E ARRITJES SË MIRËSISË...

Zoti ynë, në një ajet fisnik, urdhëron:

"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë,

derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni.." (Al 'Imran, 92.) Me anë të këtij ajeti, Allahu na tregon rrugën për të arritur afërsinë me Të.

"Të dhurosh prej asaj që do", është një nga çështjet ndaj së cilës duhet pasur më shumë kujdes gjatë dhurimit, sepse kjo tregon nivelin e dashurisë së besimit të robit ndaj Allahut.

Atëherë edhe ne duhet të mundohemi ta ngremë nivelin e dhurimit tonë, duke dhuruar në mënyrën më të bukur atë që e duam dhe na pëlqen më shumë dhe që do të kënaqeshim po të na e dhuronin të tjerët. Në këtë mënyrë, duhet të përparojmë në rrugën e cila na shpie tek përsosmëria e mirësisë. Duke e vënë veten në vend të të varfrit, të mendojmë se si do të dëshironim të na dhuronin të tjerët dhe sipas asaj të dhurojmë edhe ne. Në një ajet fisnik urdhërohet:

"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t'i pranoni ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëndatë." (Bekare, 267.)

Askush nuk duhet të mendojë se ka dhuruar gjë, nëse u jep të varfërve gjëra të prishura dhe pa cilësi, të cilat nuk do t'i merret as vetë, nëse do t'ia jepnin të tjerët. T'i japësh nevojtarit një rrobë të vjetër, ushqim të prishur apo ta gëzosh atë për momentin me një dhuratë simbolike dhe më vonë ta lësh vetëm për vetëm me nevojën, skamjen dhe problemet e tij, nuk konsiderohet dhurim në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Besimtari, është njeri bujar. Ndërsa bujaria e vërtetë, nuk është të dhurosh gjëra të thjeshta dhe të pakta, por përkundrazi, të dhurosh atë që do më shumë, që do të zgjidhë problemin, që do të shërojë zemrat, që është e dobishme dhe me vlerë.

NDIHMUHUNI NË MIRËSI DHE DEVOTSHMËRI!

Qëllimi i dhurimit është ta shpëtosh plotësisht nevojtarin prej vështirësisë. Sigurisht që jo të gjithëve u mjafton buxheti dhe mundësitë për këtë. Atëherë, është e domosdoshme të bashkohemi dhe të ndihmohemi në mirësi. Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik ka urdhëruar:

"...Ndhimoheni njëri-tjetrit në punë të mira..." (Maide, 2.)

Të ndihmohemi në punë të mira, është urdhri i Zotit tonë. Kjo do të thotë që veçanërisht në punët ku përpjekjet individuale për mirësi janë të pamjaftueshme, të bashkëveprojmë dhe të përparojmë në mirësi, duke punuar sistematikisht, madje duke e kthyer këtë punë

në një institucion.

Nga kjo pikëpamje, në kushtet kur nuk kemi forcë dhe mundësi në nivelin e mjaftueshëm për të zgjidhur problemet, duhet të përpiqemi të nxisim në mirësi shoqërinë përreth nesh dhe të zbatojmë në jetën tonë të përditshme urdhrin e Zotit tonë **"...Ndhimoheni njëri-tjetrit në punë të mira..."**

Besimtari duhet të jetë gjithmonë në kërkim të punëve të mira. Edhe nëse nuk gjejmë diçka për të dhuruar, duhet të dhurojmë kohën dhe punën tonë, me qëllim që të bëhemi shkak ose mjet për një mirësi.

Ne s'duhet të na zërë sëmundja e ngushëllimit të ndërgjegjes, sëmundje e cila sot është shumë e përhapur në shoqërinë tonë, ku njerëzit mjaftohen me dhënien e diçkaje të pakët, sa për të larguar të varfrin dhe nuk zgjidhin asnjë problem.

Duhet të mendojmë dhe të llogarisim mirë se sa prej mirësive që na ka falur Allahu mund t'i dhurojmë në rrugë të Tij?.. Në ç'përpjestim janë ato që dhurojmë në krahasim me ato që shpenzojmë për veten tonë?.. Apo mos ndoshta në çështjen e dhurimit e krahasojmë veten me nivelin e shoqërisë dhe e ngushëllojmë ndërgjegjen me disa ndihma të pakta?.. Ndërkohë, si besimtarë që jemi, në çdo çështje duhet ta krahasojmë veten me Pejgamberin tonë (a.s.) dhe sahabët e tij të zgjedhur. Edhe Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar të marrim shembull robërit e Tij të devotshëm:

"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët, që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë..." (Teube, 100.)

Brezi i sahabëve, të cilët Zoti ynë na i ka treguar si shembull, **për herë të parë**, në periudhën e Mekës paguan **çmimin e besimit** të tyre me vuajtjet që hoqën dhe sakrificimin e pasurisë dhe jetës. **Për herë të dytë**, në Medinë paguan **çmimin e të jetuarit si myslimanë** duke mbajtur mbi supë sulmet e shumta të idhujtarëve. Ndërsa **për herë të tretë**, paguan **çmimin e përgjegjësisë së besimit**, duke punuar për të përhapur dhe bartur ndër shekuj dritën e fesë dhe të udhëzimit. Ata i shpenzuan në rrugë të Allahut të gjitha mirësitë që kishin, sepse jetuan gjithmonë duke menduar rreth ajetit:

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!" (Tekathur, 8.)

Për t'u bërë edhe ne prej atyre që dhurojnë me sinqeritet në rrugën e Allahut, duhet të marrim shembull brezin e sahabëve të nderuar dhe të mundohemi të jetojmë të tria cilësitë e tyre, për të cilat folëm më sipër.



AI QË BËHET SHKAK I MIRËSISË, ËSHTË NJËSOJ SI AI QË E BËN ATË

Nga ana tjetër, ne duhet të sigurohemi që dhurimet që kemi bërë, të shërojnë një plagë të shoqërisë ose të zgjidhin një problem. Në lidhje me këtë çështje, në rast se nuk jemi të mjaftueshëm si një individ i vetëm, në vend që të tërhiqemi mënjanë e të themi: “Ç’të bëjmë, kaq kemi mundësi...”, duke e lënë nevojtarin vetëm për vetëm me dertin e tij, duhet t’i përvishemi punës me mendimin: “Vallë, a mund të gjej dikë tjetër, i cili mund ta shpëtojë këtë njeri prej vështirësive?..”, duke luajtur rolin e urës ndërmjet nevojtarit dhe atyre që kanë mundësi t’i ndihmojnë. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Ai që bëhet shkak i mirësisë, është njësoj si ai që e bën atë.” (Tirmidhi, Ilim, 14.)

Për këtë arsye, sa herë që kanë pasur mundësi, të dashurit e Allahut i kanë motivuar njerëzit për mirësi, duke përjetuar shpirtërisht kënaqësinë e të qenit ortak në mirësitë e tyre.

Edhe të parët tanë, që ishin brumosur me këtë edukatë dhe vetëdije, arritën majat në mirësi dhe dhurime duke e pajisur shoqërinë me institucione bamirësie, të cilat u bënë rrjet mirësie. Në lidhje me këtë çështje, gjendja e të nderuarit Akshemsedinit, i cili luajti një rol shumë të madh në formimin e personalitetit dhe arritjet luftarake të sulltanit të famshëm Mehmet Fatihut, është shumë kuptimplote:

Pas namazit të parë të xhumasë, pasi u çlirua Stambolli, në një shesh të madh u mbajtën festimet për fitoren e madhe. Padishahu u ishte shumë mirënjor-

hës njerëzve të tij për ndihmën e tyre në këtë fitore të jashtëzakonshme. Prandaj, pasi mbajti një fjalim, ku ndër të tjera tha: “Mëshira e Rrahmanit qoftë mbi dëshmorët, lavdia dhe nderi mbi veteranët dhe falënderimet mbi pasuesit e mi...”, si dhuratë për fitoren, u ndau pasuri, mall dhe tokë njëqind e shtatëdhjetë mijë ushtarakëve dhe civilëve. Ndërkohë, udhëzuesi shpirtëror i Mehmet Fatihut, Akshemsedini, iu drejtua veteranëve të luftës, të cilët ndodheshin aty duke i këshilluar me këto fjalë:

“O ju veteranë! Dijeni se Pejgamberi i fundit, për të gjithë ju ka thënë: “*Sa ushtarë të mirë që janë ata...*”. InshAllah të gjithë jenë të falur prej Allahut. Pasurinë dhe mallin që fituat prej luftës, mos e shpërdoroni, por shpenzoheni në bamirësi dhe bindjuni padishahut tuaj!”

Në këtë mënyrë, për ta kurorëzuar me një lavdi të re, lavdinë e ushtrisë që çliroi Stambollin, ai i motivoi ata të ndërtonin institucione bamirësie për ndërtimin e qytetit dhe rimëkëmbjen e shoqërisë. (shih. Samiha Ayverdi, *Türk Târihinde OSMANLI ASIRLARI*, Istanbul 1999, s. 227-228.)

Ne jemi pasardhësit e gjyshërve tanë, të cilët ndër-tuan një civilizim të madh virtytesh. Frytet e begata të civilizimit, të cilin ata e ndër-tuan me ndjenja dhe parime të larta, mund t’i shohim edhe sot në formën e vakëfeve, ndërtesave të ndryshme, çezmave etj. Prandaj, ne duhet ta ruajmë trashëgiminë e gjyshërve tanë dhe të përpiqemi edhe ne të ndërtojmë institucione të reja bamirësie dhe të gjallërojmë ato që ende ekzistojnë. Më parë duhet të bëhemi shembull duke pajisur botën tonë të brendshme me virtyte të larta; pastaj, për të ruajtur vlerat e shenjta që na kanë lënë të parët, duhet të edukojmë brezat e rinj me besim të fortë dhe dashuri për atdheun. Përndryshe, feja dobësohet, brezat humbasin dhe atdheu bie në dorë të huaj. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm për këto përgjegjësi, duhet të bëhemi prej atyre që dhurojnë dhe bëjnë shumë bamirësi.

Si përfundim, një besimtar bamirës, është njeri altruist. Është një njeri, i cili e di shumë mirë se arritja e shpëtimit të tij varet prej përpjekjeve që bëhen për shpëtimin e të tjerëve. Kjo, sepse Allahu Teala e refuzon tipin e njeriut egoist, që mendon vetëm për veten dhe është koprrac. Në bazë të kësaj, nuk duhet të harrojmë se llogarinë për përgjegjësinë që kemi, do të mund ta japim lehtë, aq sa edhe e ndjejmë në supet tona përgjegjësinë për të tjerët.

Zoti ynë na bëftë prej atyre që përpiqen dhe punojnë për fenë. Ndërsa dhurimin e bamirësinë që bëhet brenda kritereve të edukatës, duke shpresuar vetëm kënaqësinë hyjnore, e bëftë thesar të qetësisë dhe lumturisë së zemrave tona!

Amin!..

Dhikri

Fatih Okumush

Kurani Fisnik e përkufizon veten e tij si "dhikër". Kup-timi leksikor i fjalës dhikër është përkujtim, përsëritje dhe këshillë. Allahu Teala thotë:

"Kështu pra, Ne po të tregojmë ty (o Muhamed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kuran) që të kemi dhënë, është një dhikër nga ana Jonë." (Taha, 99.)

"Kur dëgjojnë dhikrin (Kuranin), mohuesit sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: 'Ai është vërtet i marrë! Por Kurani është vetëm një dhikër (këshillë) për botët.'" (Kalem, 51-52.)

Kjo këshillë nuk është shpikur prej Muhamedit (s.a.s.). Mesazhi që iu shpall Muhamedit (s.a.s.) dhe që iu urdhërua t'ua predikojë botëve, nuk është një mesazh i ri. Përkundrazi, është një mesazh i vjetër. A nuk është njëri prej emrave të Kuranit Fisnik edhe "kelamu'l-kadim"?

Nga njëra anë, Kurani përbëhet nga këshilla, përsëritje dhe përkujtime. Të gjithë pejgamberët na kanë përkujtuar të njëjtin mesazh. Edhe thirrja e Pejgamberit të fundit (s.a.s.), është thirrja e fundit që përfshin të gjitha thirrjet e mëparshme. Thirrja e fundit, që do ta shpëtojë njerëzimin nga buza e greminës së zjarrit dhe do t'i bëjë xhenet të dyja botët... Thirrja e fundit, që do t'i nxjerrë në bregun e paqes ata që janë duke u mbytur në dallgët e neglizhencës, hutimit dhe humbjes...

Kurani Fisnik, jo vetëm për veten e tij, por edhe për librat hyjnorë të mëparshëm përdor përkufizimin "dhikër". Allahu Teala thotë në Kuran:

"Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve u kemi dhënë shpallje, andaj pyetini dijetarët e dhikrit, nëse nuk e dini (këtë)." (Nahl, 43.)

Shprehja "dijetarët e dhikrit" ka kuptimin "dijetarët e Librit". Domethënë, çifutët dhe të krishterët. Edhe atyre u qenë dërguar profetë dhe libra. Edhe librat që u zbritën atyre ishin një dhikër, përkujtim, përsëritje dhe këshillë.

Nuhu (a.s.), i tha kështu parisë së popullit të tij, që ia kundërshtonin me insistim thirrjen dhe që ia përgëneshtronin me këmbëngulje profetësinë e tij:

"Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di nga Allahu atë që ju nuk e dini."

A po çuditëni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë në përmjet një njeriu nga mesi juaj, i cili ju tërheq vërejtjen që të kini frikë (Allahun), në mënyrë që të mëshiroheni?" (Araf, 62-63.)

Pozita e Nuhut (a.s.) dhe mesazhi që solli, nuk ishte diçka e çuditshme dhe e habitshme. Nuhu (a.s.), nuk po sillte një mesazh të ri. Ai thjesht po përsëriste thirrjen e vjetër që i përkujtohej njeriut që nga ekzistenca e tij dhe po i paralajmëronte njerëzit edhe një herë. Vetëm kaq. Faktikisht, Nuhu (a.s.), po u kujtonte veten e tyre dhe po i thërriste të ktheheshin në identitetin e tyre.

Po, në brendësinë tënde gjendet mirësi! Po ashtu edhe ligësi!.. Ai i cili e shton, e mbron dhe e ndriçon mirësinë që gjendet brenda tij, do të shpëtojë. Ndërsa, ai që e nxin, e ndryshk dhe e ndyen brendësinë e tij, do të humbë... Do të pësojë një disfatë të madhe. Çfarë mbulon qafiri? Dritën që ka në brendësinë e tij.

Islami nuk ka filluar me Muhamedin, salallahu alejhi ve selem. Me Pejgamberin e fundit (s.a.s.), ka arritur përsosmërinë. Me predikimin e tij (s.a.s.), feja arriti përsosmërinë dhe është plotësuar mirësia, që Allahu Teala i ka dhënë njeriut.

Një kuptim tjetër i fjalës Kuran, është "i lexueshëm" dhe "i mbledhur – mbledhës". Në përngjasim nuk bëhet gabim. Nëse predikimit të pejgamberëve mund t'i bëjmë një përngjasim me sistemet dhe programet funksionuese të kompjuterave, thirrjet dhe librat e mëparshëm gjithmonë kanë qenë përgëzues të versioneve të mëvonshme. Po ashtu, kanë qenë programe të regjistruara për një kohë dhe në shumicën e rasteve, për një vend të caktuar. Ndërsa thirrja e fundit, është versioni i përsosur që i ka nxjerrë jashtë funksioni, që i tejkalon dhe i përfshin të gjitha programet e tjera.

Ata që kanë përfytyrime të mangëta dhe të gabuara për Allahun Teala, insistojnë për të mos njohur të drejtën e ndërhyrjes së Allahut në gjithësi, sikur të kishin të drejtë, autoritet dhe fuqi për këtë. Por të jesh "Rabbu'l-alemin", përfshin edhe kuptimet, si: të administrosh, të kontrollosh dhe të drejtosh gjithësinë. Allahu Teala thotë:

"Ata nuk e vlerësojnë siç duhet Allahun, kur thonë: Allahu nuk i ka zbritur asgjë njeriut." (En'am, 91.)



Mbrojtja e. Sunetit është mbrojtje e Kurranit

Sald Mermer

Kurani Fisnik ka zbritur pjesë-pjesë që nga koha kur i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, mori shpalljen e deri sa ndërroi jetë. Përse pra nuk është zbritur i gjithi përnjëherë, por është zbritur pjesë-pjesë?

Është e sigurt se, sikur të donte Allahu Teala, mund ta zbriste të gjithin përnjëherësh. Atëherë, përse u zbrit pjesë-pjesë?

Sipas bindjes së përgjithshme, thuhet se dhënia e të gjitha ajeteve të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), në shpellën Hira, do t'i vinte njerëzit përballë një peshe të papërballueshme, kështu, do të vështirësohej procesi i thirrjes së tyre në fenë islame. Ndërsa unë mendoj se urtësia e shpërndarjes në kohë e zbritjes së shpalljes, mbart edhe kuptime të tjera.

Mendoni: A është zbritur me plot kuptimin e tij një

ajet kuranor kur shpallet me anë të Xhebrailit (a.s.)? Si fjalë ka zbritur. Nëse i ka plotësuar kushtet e zbritjes vetëm duke u zbritur si fjalë, atëherë, a nuk do të ishte e mjaftueshme që ajeti të ngelte i fshehur te i Dërguari i Allahut (s.a.s.)? Përse të qenët shpallje e ka të nevojshme më përpara kalimin te një fazë tjetër?

Atëherë fjalën e Allahut Teala, që i ishte shpallur atij, nuk do të ishte e nevojshme që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), t'ua tregonte njerëzve. Atëherë, fjala hyjnore do të rrinte e fshehur te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe njerëzit nuk do të kishin njohuri për të.

Por i Dërguari i Allahut (s.a.s.), nuk e mbajti të fshehtë shpalljen dhe ua tregoi atë njerëzve. Ai urdhëronte shkruarit e shpalljes ta shkruanin atë. Ndërsa hafizët e gdhendnin në mendje. Më në fund, praktikohej nga i

Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe sahabët.

Domethënë se zbritja nuk plotësohet me marrjen e shpalljes. Shkrimi i shpalljes dhe gdhendja e saj në kujtesë dhe në jetë, përbëjnë gjendjen aktive të etapës së shndërrimit në mus'haf, duke e kaluar Kuranin në dimensionin konkret të kësaj bote. Përgjatë këtij procesi aktiv, ajetet arrijnë gradën e përsosmërisë së shfaqjes në tokë duke u praktikuar.

A nuk ka qenë "një", fillimi i zbritjes së shpalljes së Kuranit Fisnik në shpellën Hira me praktikimin e saj nga ana e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.)?

Kjo do të thotë...

Cili ishte ajeti i parë që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), lexoi, kur Xhebraili (a.s.), i zbriti ajetin: **"Lexo me emrin e Zotit tënd!"**? Përsëri ishte ajeti: **"Lexo me emrin e Zotit tënd!"** Apo jo? **"Lexo!"** Çfarë të lexosh? Lexo "Lexo"-në... Interesante... Së pari, mësohet për të lexuar leximin e esencës së gjithësisë.

Urdhri dhe zbatimi i urdhrit në të njëjtën vijë... Dome-thënë, zbatimi dhe fjala që do të zbatohet janë bashkë... Sepse Hira ishte vendi i vetmisë. Aty nuk kishte njerëz të tjerë. Shpella pothuajse ishte si një varr ndërmjet dy-njasë dhe ahiretit, apo si një botë në mitrën e nënës.

I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, shkoi në shtëpi dhe u mbulua, prejse u ndikua nga shpallja dhe praktikimi i menjëhershëm i saj. Mbulesa, në një farë mënyre, u bë shpella e Tij.

Pastaj mori urdhrin: **"O ti i mbuluar! Çohu dhe paralajmëro!"** (Muddethhir, 1-2.) Menjëherë pas këtij urdhri, realizohet dalja në mejdanin e Mekës për ta zbatuar këtë paralajmërim.

Pastaj çdo gjë vijoi sipas radhës. Besimi dhe praktikimi i besimit... Pastaj Medina... Ky ishte qyteti, në të cilin u bë konkret praktikimi i fesë dhe në të cilin i Dërguari i Allahut (s.a.s.), do të jetonte deri sa të ndër-ronte jetë...

A arrijmë ta kuptojmë se vija ndërmjet pozitës së fjalëve të Kuranit nga Hira në Medinë dhe gjendjes së praktikimit konkret vjen duke u ngjeshur?

Mekalimin e kohës, përparoi edhe zbritja pjesë-pjesë e shpalljes që plotësonin njëra-tjetrën dhe gradualisht formohej një tërësi. Pastaj zbritja vazhdoi deri sa u tha: **"Tashmë feja juaj është plotësuar."**

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), e praktikoi fjalën e Allahut, që mori brenda kufijve të vetes së tij, pastaj përpara sahabëve.

Në këtë mënyrë, fjala hyjnore nuk mbeti te i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në shkallën e të shprehurit, por zbriti me të gjithë qartësinë e saj ashtu siç duhej të njihej edhe në formën e praktikimit.

Për të ditur se çfarë synon Kurani nga "drejtësia",

duhej që urdhrat hyjnorë të bëheshin konkretë mbi tokë. Sikur çështja e drejtësisë të mos ishte treguar dhe vënë në jetë nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe nga sahabët me në krye Umerin (r.a.), ne dhe e gjithë njerëzia nuk do ta kuptonim se çfarë është drejtësia dhe nuk mund të bënim drejtësi.

Të gjitha konceptet e Kuranit në lidhje me "drejtësi-në", duhet të zbriten nga plani konceptual në fushë të konkretizuar nga ana e sunetit të të Dërguarit, të cilit i është shpallur, dhe e miqve të tij, në mënyrë që të mos mbetet ndonjë mangësi në plotësimin e fesë.

Allahu Teala, duke folur për Kuranin në Kuran, thotë: **"...Ne e kemi zbritur Atë dhe ne do ta mbrojmë."** (Hixhr, 9.) Kush e ka zbritur? "Ne." Kush do ta mbrojë? "Ne." "Ne", a nuk është shumës? Allahu (xh.xh.), nuk thotë "Unë", por "Ne."

A nuk kishte detyrë Xhebraili (a.s.), në zbritjen e Kuranit? Atëherë, përse i Dërguari i Allahut (s.a.s.), të ngelë jashtë kësaj zbritjeje? A nuk arriti Xhebraili (a.s.), në miraxh deri në sidretu'l-munteha, si pika e fundit ku mund të shkonte dhe nuk kaloi më tutje?

Nëse i Dërguari i Allahut (s.a.s.), është një Kuran i gjallë, atëherë, a nuk e ka arritur Kurani pozitën "i gjallë" me anë të Hz. Pejgamberit (s.a.s.)? Ç'do të thotë i gjallë? A nuk do të thotë se ai është vetë jeta?

Kurani ka ndjekur një rrugë zbritjeje vertikale, nga Allahu Teala te Xhebraili (a.s.), nga Xhebraili te i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe nga i Dërguari i Allahut në tokë, duke u praktikuar, fillimisht, prej tij (s.a.s.).

A nuk rezulton nga këtu se praktika e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) dhe e sahabëve të tij formojnë fazën më të fundit të zbritjes së Kuranit Fisnik?

A nuk i themi ne myslimanët sunet, tërësisë së praktikave të Hz. Pejgamberit?

Atëherë, suneti i lartë përbën fazën më të fundit të zbritjes së Kuranit.

Tani mund të bëjmë këtë pyetje:

A nuk do të thotë mbrojtje e Kuranit mbrojtja e sunetit? Atëherë, manipulimi i Kuranit fillon me heqjen e sunetit. Pastaj, manipulimi shkon deri te fjalët e vetë Kuranit.

A nuk kanë vepruar kështu të krishterët dhe hebrejtë? Ata nuk vepruan sipas urdhëresave dhe filluan të manipulonin fjalën e Allahut Teala. Në të vërtetë, kush mund ta manipulojë fjalën e Allahut?

Si përfundim, nëse nuk dëshironi ta manipuloni Librin e vetëm autentik, jeni të obliguar të mbronin sunetin e Pejgamberit (s.a.s.). Mbrojtja e tij arrihet të realizohet duke e jetuar atë. Ta jetosh, do të thotë ta mbash në jetë. Besimtarët që përpiqen për të mbrojtur fenë, Allahu Teala i ndihmon për të ruajtur edhe Librin.

Shpëtimi i madh

Mesut Kaja

Shprehjet, si: "shpëtimi i madh", "të shpëtosh" dhe "të jesh prej atyre që arrijnë shpëtimin", përdoren shpesh në Kuranin Fisnik. Këto përsëritje vendosin para njeriut një ideal sublim. Ky është ideali i shpëtimit të përherëshëm. Ky ideal, për një mysliman është shfaqja e një rruge, që hap horizonte të gjera përtej pasioneve dhe dëshirave provizore. Ky ideal, më shumë se sa shqetësim ditor, është një thirrje për t'u përgatitur për Ditën e Gjykimit.

Sipas Kuranit Fisnik, shpëtimi i madh është mbrojtja që Allahu Teala i bën robit të Tij në këtë botë nga kryerja e veprave të këqija. Ndërsa në ahiret, është mbulimi e fshirja e mëkateve dhe mëshirimi i tij. (el-Gafir, 40/9; el-Xhathije 45/30; el-Fet'h, 48/5.)

Mëshirimi i robit nga ana e Allahut Teala, është dhënia e xhenetit, të cilin ia ka premtuar. Është vendosja në xhenetin Adn, nën të cilin rrjedhin lumenj, në të cilin gjenden vendbanime të mrekullueshme dhe ku besimtari do të qëndrojë përgjithmonë.

Por përtej këtyre ka diçka edhe më të rëndësishme: "Allahu është i kënaqur me robin e tij". Kënaqësia e Zotit nga jeta që ka jetuar rob, i cili del në audiencën e Tij. Nëse Allahu e bën robin prej banorëve të xhenetit dhe i jep mirësi të pafundme, nga një këndvështrim është shenjë e kësaj kënaqësie të Tij. Tashmë, ajo që i takon robit është të jetë i kënaqur dhe i gëzuar nga Allahu Teala. Një rob prej të cilit Zoti (xh.xh.), është i kënaqur, edhe ai është i kënaqur nga Zoti. Ja, ky është shpëtimi më i madh. (el-Maide, 6/119; et-Teube, 9/72; el-Hadid, 57/12; et-Tegabun, 64/19; el-Buruxh, 85/11.)

Ka një kornizë jete, që e ka caktuar Allahu Teala për robin, të cilit i ka premtuar shpëtimin e madh. Librat e shenjtë për këtë janë zbritur. Për këtë janë vendosur parimet hyjnore. Mënyra për t'u bërë prej të shpëtuar-

ve, tregohet kështu në një ajet të librit të shpëtimit, Kuranit:

"Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë." (Nur, 52.)

Sipas ajetit fisnik, gjëja e parë që Allahu i Lartësuar pret nga rob është "bindja". Me në krye adhurimin dhe nënshtrimin, zbatimi i urdhrave dhe largimi nga ndalesat, bindja ndaj Hz. Pejgamberit (s.a.s.), të cilin e dërgoi duke e zgjedhur ndërmjet njerëzve, janë prej gjërave që i bën të domosdoshme bindja ndaj Allahut Teala. Të përvetësosh urdhrat dhe këshillat e tij dhe të ecësh në rrugën që ka hapur ai. Të marrësh shembull moralin e tij të lartë dhe të përiqesh të jetosh siç ka jetuar ai (s.a.s.)...

Bindja ndaj Allahut Teala kuptohet edhe si bindje ndaj Librit të Tij, si bindje ndaj Pejgamberit dhe si bindje ndaj traditës së tij (s.a.s.), në çdo çështje.

Të bëhesh mysliman është shprehje e nënshtrimit ndaj Allahut Teala dhe ndaj të Dërguarit të Tij (s.a.s.). Në këtë nënshtrim nuk bëhet fjalë për imponim, por për zemër të pastër, jo për interes, por për sinqeritet. Ajeti, para atij të cilin e përmendëm më lart, tregon se besimtarët i zbatojnë këto urdhra me zemër dhe me plot sinqeritet:

"Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: 'Dëgjojmë dhe bindemi'. Pikërisht këta janë të shpëtuarit." (Nur, 51.)

Pas këtij sinqeriteti dhe dëlirësie, është edhe gjendja e hushusë (frikërespektit ndaj Zotit). Në ajetin pasardhës të së njëjtës sure theksohet hushuja. Hushuja është prej gjërave të nevojshme për të arritur shpëtimin. Mbartja e ndjenjës së hushusë ndaj Allahut Teala, nuk është vetëm frikë ndaj Tij. Krahas frikës, hushuja është shenjë e

ndjenjës dhe perceptimit të thellë në adhurim.

Nëse nënshtrimi ndaj Zotit zbret në zemër, do të thotë se dashuria e Allahut të Madhëruar ka zënë vend aty. Nëse zemra frikësohet prej madhësisë së Allahut, kjo ndodh ngaqë është shtuar besimi në zemër. Për të arritur shpëtimin, si cilësi tjetër përmendet edhe devotshmëria. Domethënë, përpikmëria për të zbatuar urdhrat dhe ndalesat që ka dhënë Allahu dhe i Dërguari i Tij. Takvaja (devotshmëria) është kujdesi i madh për të mos shkelur gjembat kur ecën në një tokë plot me to – shprehet Umeri (r.a.).

Domethënë, të largohesh nga haramet dhe të veprosht vetëm në hallall. Të qëndrosh larg gjërave të dyshimta ndërmjet këtyre të dyjave. Nëse hushuja është një ndjeshmëri që ndihet në thellësi të botës shpirtërore, devotshmëria duhet të jetë dimension i saj, që reflektohet në jetë. Të ndjesh frikërespekt ndaj Allahut dhe të jesh i devotshëm, janë shfaqjet e lidhjes së fortë dhe të nënshtrimit ndaj Tij.

Profetët janë dërguar për t'u treguar robërve të Allahut Teala rrugën e shpëtimit dhe për t'i njoftuar për Ditën e Madhe. Të gjithë të dërguarit kanë dhënë përpjekjet maksimale për këtë. Edhe i Dërguari i fundit i Allahut, Muhamedi (s.a.s.), pasi Islami arriti një gradë dhe fuqi të caktuar, u dërgoi sunduesve të shteteve fqinje, letra ftese për në Islam. Çdo sunduesi i dërgoi një letër me mesazhin:

"Bëhu mysliman dhe shpëto!" Atyre u tha:

"Bëhuni myslimanë dhe shpëtoni vetet tuaja dhe popullin tuaj. Nëse nuk pranoni, do të keni mbi supe edhe mëkatin e tyre!" (Buhari, Xhihad ve Sijer, 111.)

Këto letra ishin "thirrje për shpëtimin e përhershëm". Këta urdhra ishin "mesazhe të shpëtimit universal". Sepse, pas dërgimit të Hz. Pejgamberit (s.a.s.), arritja e lumturisë së përhershme është e mundshme vetëm duke e pranuar thirrjen e Tij. Mospranimi i kësaj thirrjeje, është humbje.

Humbja e drejtuesve është humbja e popujve, e shekujve dhe e brezave. Për shembull, parimi më i rëndësishëm i thirrjes së Tij është namazi. Namazi është përgëzuesi në këtë botë i qetësisë dhe lumturisë, që do të japë shpëtimin i vërtetë.

Ezanet thirren për këtë. Që nga lindja e deri në perëndim, vazhdimisht ata thërrasin për këtë atmosferë prehjeje dhe qetësie. Ezanet janë thirrjet e shpëtimit të vërtetë e të përhershëm që përsëriten pesë herë në ditë. "Ejani në namaz, ejani në namaz... Ejani në shpëtim, ejani në shpëtim..."

Kjo thirrje e mban të freskët vetëdijen e shpëtimit të besimtarët dhe i njofton për shpëtimin e madh, për të cilin nuk kanë dijeni. Njeri besimtar është ai që e dëgjon këtë thirrje dhe që i përgjigjet asaj. Ai jeton me dëshirën

për ta arritur shpëtimin e përhershëm. Shqetësimin për të arritur shpëtimin e madh, gjithmonë e mban të gjallë në zemrën e tij. Domethënë, gjithmonë synon për të shpëtuar ahiretin e tij dhe për të arritur shpëtimin në botën tjetër.

Nëse mund të shprehemi kështu, ai gjithmonë është në një luftë që nuk ka paqe. Ai e di se fitorja e vërtetë është fitorja në botën tjetër dhe arritja e lumturisë së përhershme. Jeton me këtë synim dhe jetën e tij e flijon për këtë. Këtë shpresë e mbart deri në frymën e fundit.

Të mos harrojmë këtë se besimtari dëshiron jo vetëm shpëtimin e tij, por të të gjithë të afërmve dhe të atyre që jeton e punon me ta, madje e të gjithë njerëzve. Me këtë synim, përpiket sipas kapacitetit dhe mundësisë së tij. Në ajetin fisnik, thuhet:

"Allahu është Ai, që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët. O ju që keni besuar! A doni t'ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm? Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t'ju falë gabimet tuaja dhe do t'ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe." (Saf, 9-12.)

Brezi i sahabëve është brezi pararendës që do të arrijë shpëtimin. Ata janë besimtarët e parë që kanë vuajtur për çështjen e shpëtimit universal. Allahu Teala gjithmonë flet për ta duke i lavdëruar:

"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim. Edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!" (Teube, 100.)

Fraza në ajet: "...dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim..." – nuk duhet të na dalë nga mendja kurrë. Në këtë frazë shprehet qartë sihariqi se ata që do të ndjekin rrugën e tyre deri në Kiamet, do të shpëtojnë. Me një thënie tjetër, ata që do t'i përgjigjen thirrjes së Allahut Teala dhe të Pejgamberit (s.a.s.), në çdo periudhë, siç iu përgjigjen sahabët me gjithë zemër, duke thënë: "Dëgjuam dhe u bindëm" – do të arrijnë të njëjtën gradë. Ata që i binden Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), duke e pasur zemrën e mbushur me ndjenja madhërimi ndaj Allahut dhe duke i respektuar urdhrat e ndalesat e Tij, do të arrijnë të njëjtin shpërblim. Ai shpërblim është xheneti. Ai shpërblim është kënaqësia e Allahut të Lartësuar.

Drita e Ibadetit

Rabia Christine Brodbeck

Që nga muaji Rexhep e deri në muajin Muharrem, robërve të Zotit u është dhënë një kohë për mirësi dhe begati. Në këtë periudhë, besimtarët bëjnë një jetë adhurimi të vazhdueshëm dhe të ngjeshur. Atyre që e kuptojnë atë kohë të begatë dhe shumë të pasur, jeta e kësaj bote u bëhet një pjesë e jetës së ahiretit.

Ata duhet ta dinë se ibadetet e tyre nuk janë qëllim, por një mjet për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala. Ibadetet duhet t'ua shtojnë atyre vetëdijen, dashurinë, nevojat dhe etjen ndaj Allahut të Lartësuar. Nëse adhuresi nuk ka rënë në dashuri dhe admirim kundrejt bukurisë dhe madhështisë së Allahut të Madhëruar, nuk mund t'i kryejë ibadetet siç duhet dhe me sinqeritet të plotë.

Në pesë kushtet e Islamit, shfaqet drita e urtësisë hyjnore. Kur Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun, i dha atij nevojën për ta njohur Atë. Biri i Ademit ka nevojë për vetëdijen ndaj Krijuesit të Lartësuar, ka nevojë të shohë me syrin e zemrës, ka nevojë të thithë erën e këndshme të botës tjetër, ka nevojë të dëgjojë përsëri zërin "A nuk jam Unë Zoti juaj?" dhe ka nevojë të kthehet në vatrën e tij të vërtetë. Ky është mallëngjimi më i madh i shpirtit.

Kjo është esenca jonë.

Sheriati është dhënë për ta bërë ekzistencën e njeriut më shpirtërore. Për fat të keq, shumë njerëz fetarë mendojnë se çështja e metodave të edukimit dhe e synimeve shpirtërore ka lidhje vetëm me tarikatin. Por pa pasur formë, nuk ka përmbajtje. Pa shfaqur përpjekje në ibadet, nuk ka lartësim shpirtëror. Pa pasur enë, uji nuk mund të vendoset diku. Nëse mendojmë anasjelltas, atëherë themi:

Nëse nuk ka ujë, s'ka nevojë për enë. Një fjalë, e cila nuk ka kuptim, nuk ka as dobi. Toka nuk ka asnjë shkak për të ekzistuar, sikur të mos ishte xheneti. Çfarë dobie do të kishte trupi, sikur të mos ishte shpirti? Kjo e vërtetë sublime shprehet kështu në një hadith kudsij:

"Isha një thesar i fshehur. Dëshirova të njihesha. Prandaj, krijova gjithësinë."

Sikur të mos ishte mëshira e Allahut Teala, mbi tokë nuk do të kishte nevojë për jetën e njeriut. Kjo është urtësia në Islam. Siç kërkon e dukshmja të padukshmen, edhe e padukshmja kërkon të dukshmen. Ajo që duhet të bëjnë ata që i përkasin besimit të teuhidit, është bashkimi i të vërtetave të dukshme e të padukshme

dhe arritja e kësaj pozite të lartë perceptimi përgjatë gjithë jetës së tyre.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, është dërguar nga Zoti si mëshirë për botët, edhe ligji hyjnor është një shfaqje e mëshirës së Allahut Teala, që ka rrethuar çdo gjë. Hz. Muhamedi, alejhi's-salam, është dërguar për të përsosur moralin. Sheriati është një reflektim i moralit të Muhamedit (s.a.s.). Allahu Teala na ka dhënë disa detyra dhe secilës prej tyre i ka dhënë kuptime simbolike hyjnore e sublimë.

Pesë shtyllat e fesë janë dhënë nga Krijuesi i Lartësuar, në mënyrë që njerëzimi të shohë bukurinë dhe përsosmërinë e Tij. Dispozitat hyjnore janë një miraxh dhe ndriçim për umetin e Muhamedit, alejhi's-salatu ve's-salam, sepse këto dispozita janë stolitur me dritën e Allahut të Madhëruar.

Shohim se urdhrat hyjnorë burojnë nga e njëjta bazë e përhershme, sepse janë kërkesa të Allahut Teala, që i janë shfaqur njerëzimit nëpërmjet Sejjidu'l-Murselin, Sejjidu'l-Umem, Sejjidu'l-Kevnejn, Kabe Kavsejn dhe Habibullahut.

Asnjë njeri nuk e ka shprehur në mënyrë kaq të përsosur bukurinë e adhurimit dhe dashurinë ndaj shariatit si Hz. Muhamedi, salallahu alejhi ve selem. Sikur të mos ishte gjendja e tij e përkryer dhe morali i tij i lartë, rregullat fetare nuk do të ishin gjë tjetër përveçse një rutinë mekanike. Ai (s.a.s.), i zbatoi urdhrat hyjnorë me dashurinë e pastër që kishte ndaj umetit të Tij të dashur.

Mirësia dhe bukuria e Tij u përhapën nëpër zemrat e umetit që e pasonte me sinqeritet. Drita e qartë e namazeve, zekateve, mësimëve dhe lutjeve të Tij, i ushqente shpirtat e besimtarëve të vërtetë, të cilët prisnin të gatshëm për të marrë begatinë dhe frymëzimin e pashterueshëm të Pejgamberi (s.a.s.).

Duhet ta dimë se të gjithë profetët dhe miqtë e Zotit nuk kanë bërë asgjë tjetër përveçse kanë mbështetur dhe praktikuar dispozitat e shariatit me shpirtat e tyre të dëlirë. Gjatë adhurimeve ata ndejnin vazhdimisht kënaqësinë hyjnore, dashurinë më të madhe, gëzimin, frikërespektin, admirimin dhe madhërimin ndaj Allahut Teala. Kjo i lartësoi ata në botën e përhershme të bukurisë dhe përsosmërisë.

Dashuria është zgjidhja me anë të së cilës mund t'i shmangim pengesat që na dalin përpara në rrugën që na shpie te Allahu i Lartësuar. Ata që nuk ndihen të mërziur pas ibadetit të namazit apo haxhit dhe që e presin ibadetin tjetër me plot dashuri e mall, janë të

siguruar nga Allahu Teala prej rrezikut të ndjekjes së dynjasë. Edhe pasi japin selam djathtas dhe majtas, në botën e tyre shpirtërore akoma gjenden në audiencën e Allahut Teala. Domethënë, pa ndaluar qoftë edhe një moment, shkojnë nga audienca hyjnore për në audiencën tjetër hyjnore.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për haxhin. Një rob i sinqertë dhe i dëlirë, asnjëherë nuk kthehet nga haxhi, sepse, zemra e tij gjithmonë është në Arafat duke bërë dua. Kështu që kur fal namaz, në thellësi të zemrës së tij e ndjen veten në Kabetu'l-Mukerreme.

Njeriu duhet t'i kryejë ibadetet pa imituar, me ndjeshmëri dhe dashuri. Ibadetet duhet ta bëjnë atë të perceptojë dobësinë, paaftësinë dhe pamjaftueshmërinë e tij, të pranojë madhësinë dhe epërsinë e Allahut të Lartësuar. Në këtë mënyrë, robi arrin nga mërziutja e dëshpërimi të kënaqësia dhe ëndja, nga ibadeti i vdekur te një adhurim plot jetë.

Nëse robi nuk i kujton fjalët, emrat dhe argumentet e Allahut Teala me entuziazëm, dashuri, admirim dhe dëshirë, gjendjen e tij nuk mund ta mbajë të gjallë, nuk mund ta freskojë, nuk mund ta rinovojë dhe nuk mund ta rindërtojë asnjë gjë tjetër. Ibadeti e mban nefsën nën kontroll dhe i shtyp pasionet e kësaj bote.

Nëse ibadeti ynë nuk e lë pas mendimin racional dhe përllogaritjen tonë, nuk mund të dehemi me të vërtetat që i përkasin botës tjetër dhe nuk mund ta përfetojmë kënaqësinë hyjnore. Nëse nuk i japim rëndësinë e duhur pasurisë shpirtërore që ndodhet në namaz, nëse nuk zhytemi në detet e pafundme shpirtërore të tij, nëse nuk lartësohemi në Nurin e Bukurisë Hyjnore dhe nëse nuk e njohim thesarin e fshehur që kemi brenda, nuk mund ta kënaqim Allahun (xh.sh.), dhe nuk mund të arrijmë tek Ai. Ibadeti që mund të bëjmë, do të ngelet i thatë, bosh dhe i pashpirt.

Egoja materiale drejtohet nga kibleja materiale e kësaj bote. Vetja i gjen interesat dhe dëshirat që i përkasin asaj. Ndërsa egoja shpirtërore i drejtohet anës së Allahut, i cili është i përhershëm. Aty gjen lumturinë e përhershme dhe hyn te **"Ai është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij."**

Ka dy lloj besimtarësh: Njëri prej tyre i shikon ibadetet si barrë, ndërsa tjetri merr kënaqësi prej tyre dhe i shijon ato. Në jetën e grupit të parë nuk ka kënaqësi hyjnore, ndërsa tjetri është i mbushur me dashuri, interesim dhe përmallim ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (s.a.s.). Grupi i parë ka një jetë të mbushur me devijime,



për shkak se jeton për interesat dhe synimet e tij. Hz. Mevlana thotë:

“Dervishi që kërkon bukë nga njerëzit, është si peshku në tokë. Ai ka formën e peshkut, por ka ikur nga deti. Zotin e do për sevape. Shpirti i tij nuk është i dashuruar me përsosmërinë dhe bukurinë e Zotit.”

Ndjekësit e vërtetë të kësaj rruge janë besimtarët. Ata gjithmonë janë në kërkim të së vërtetës. Kanë dalë plotësisht nga vullneti i tyre i pjesshëm dhe kanë arritur në gradën për t'ia lënë çdo gjë vullnetit të Allahut Teala. Gjëja që pritet nga çdo besimtar i vërtetë, është braktisja e burgut të kësaj bote dhe kapërcimi i kufijve të saj. Nëse e thyejmë njëherë këtë, nuk ka më kthim prapa.

Të mos harrojmë se ibadetet duhet të integrohen me rregullat e moralit të lartë. Në të kundërt, ibadetet që nuk janë të tilla, nuk kanë vlerë dhe nuk pranohen te Allahu i Lartësuar. Ibadetet dhe rregullat e moralit duhet ta ushqejnë njëri-tjetrin. Hz. Aliu, radijallahu anih, ka bërë një lutje të mrekullueshme, në mënyrë që t'i rregullojmë dhe t'i zbukurojmë sjelljet tona në jetën e përditshme:

“E mëshiroftë Allahu atë njeri që e di vlerën e tij, që nuk e tepron, që e mban gjuhën dhe që nuk e shkatërron jetën me gjëra boshe!” Edhe sulltani i evlijave, Hazreti Abdulkadir Gejlani thotë:

“Tasavufi është rrugë shpirtërore, që nuk arrihet me debate të gjata, por me uri dhe duke hequr dorë nga gjërat që i pëlqejnë vetes.”

Siç bëhet shkak morali i lartë dhe sjelljet e mira për ta kryer adhurimin në mënyrën e duhur, edhe ibadetet që kryhen me sinqeritet nxjerrin në pah moral të lartë dhe sjellje të bukura. Besimtari duhet t'i ushqejë sjelljet me ibadete dhe ibadetet me sjelljet e tij.

Mënyra e jetesës sonë është mënyra e ibadetit tonë, mënyra e ibadetit tonë është mënyra e jetesës sonë. Mënyrën e jetesës në këtë botë duhet ta kemi përgatitje për në ahiret dhe jetesën e ahiretit duhet ta përgatisim qysh në jetën e kësaj bote. Trupin duhet ta kthejmë në shpirt dhe shpirtin në trup. Kur t'i ekuilibrojmë çështjet e kësaj bote me çështjet e botës tjetër, do të arrijmë qetësinë, lumturinë dhe gjithçka. Atëherë, jeta jonë e kësaj bote do të bëhet pjesë e jetës sonë të ahiretit.

Kur t'i kryejmë detyrat fetare, në të njëjtën kohë duhet të mendojmë edhe për kuptimet e tyre. Kur të kujdesemi për formën dhe aspektin e jashtëm të adhu-

rimeve, duhet të kemi kujdes edhe për kuptimet e tyre shpirtërore. Kur të kryejmë adhurimet, përpiqjen tonë në këtë botë dhe ekzistencën tonë fizike duhet t'i bashkojmë me prejardhjen tonë hyjnore dhe ekzistencën tonë shpirtërore.

Ka një të vërtetë të rëndësishme:

Morali i lartë në Islam nuk fitohet duke u dehur shpirtërisht dhe duke dalë nga vetja. Por këtë gradë mund ta arrijnë ata që marrin kënaqësinë më të madhe nga adhurimi ndaj Allahut, nga shërbimi ndaj fesë dhe nga bindja ndaj urdhrave të Tij. Ky qëndrim është ajo gjë që e ndan evlijanë nga një njeri i thjeshtë.

Kur ata luten, e harrojnë veten e tyre dhe përgjatë duasë, egot e tyre pothuajse vdesin. Kur japin sadaka, japin çdo gjë që kanë. Kur bëjnë sexhde, përjetojnë kënaqësi të madhe dhe dalin nga vetja e tyre. Kur shkojnë në haxh, vdesin para se të vdesin. Ata agjërojnë me zemrën dhe mendjen e tyre. Ndërsa iftarin e hapin kur të vdesin. Në namaz i kalojnë kufijtë e botës së krijesave, sidretu'l-munteha.

Tek Allahu Teala nuk ka gjë më të dashur se sa adhurimi i një robi që e bën atë me bindje, dëshirë dhe kënaqësi. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharrin për të pranuar Islam, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!” (Zumer, 22.)

Vahidu'l-Ehadi gjendet në kiblen e secilit prej nesh. Ibadetet duhet të bëhen për Zotin e botëve (xh.xh.), për bukurinë dhe përsosmërinë e Tij. Në çdo çast, drejtimi ynë duhet të jetë nga Allahu i Madhëruar.

Le ta dimë se kudo që ka njerëz që agjërojnë, ka edhe njerëz që bëjnë itikaf. Kudo që ka njerëz që bëjnë itikaf, ka edhe njerëz që falin namaz nate. Kudo që të ketë namaz nate, aty ka edhe miraxh. Kudo që ka miraxh, ka edhe sexhde. Kudo që ka sexhde, ka edhe kijam. Kudo që ka kijam, aty ka edhe xhihad. Kudo që ka xhihad, aty ka edhe haxh. Kudo që ka haxh, ka edhe kurban. Kudo që ka kurban, aty ka edhe sakrificë. Kudo që ka sakrificë, ka edhe vdekje para se të vdesësh. Kudo që ka vdekje para se të vdesësh, aty ka edhe ihram. Kudo që ka ihram, ka edhe tavaf. Kudo që ka tavaf, ka edhe siratu'l-mustekim. Kudo që ka siratu'l-mustekim, aty ndodhet edhe morali i Muhamedit (s.a.s.).



*“Me u dashtë
asht bukur,
ama me kenë mik
asht tjetër, tjetër gja...”*

(Duke lexuar librin e ri
të vëllait të dashur Imam Didmar Faja
“Shprehi dhuntitë e Zotit tënd!”)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Para pak ditësh, një mik i heshtur më dhuroi një libër, në dedikimin e të cilit shënohej: “Me u dashtë asht bukur, ama me kenë mik asht tjetër, tjetër gja...” Bukuria e kësaj dhurate ishte se ajo bashkonte në një atmosferë dashurie besimi dhe miqësie të vjetër, dhuruesin, mua dhe autorin e librit. Nëpërmjet saj, u bëmë, si të thuash, si një bashkësi tredimensionale, që bashkoi sinqeritetin, miqësinë dhe respektin e ndërsjellët mes nesh.


“**Shprehi dhuntitë e Zotit tënd!**”, është libri më i ri nga duart, mendja dhe shpirti i vëllait të dashur dhe mikut të vjetër, Imam Didmar Faja, prijës i Qendrës Shqiptare-Amerikane në Phoenix, AZ - ShBA, botim i Shtëpisë botuese “Progresi”, Shkodër.

Librin në fjalë e lexova me shumë dëshirë dhe kënaqësi, si të ishte një ndenjje e këndshme besimi dhe miqësie me autorin dhe botuesin... Aty, të tre së bashku u bashkuam në rreshtat e librit, ku gjetëm veten dhe dëshmuam mirësinë e madhe të shprehjes së dhuntive të Zotit...

Ky libër, në të vërtetë, është një përmbledhje shu-

më e dobishme, kryesisht e ligjëratave të mbajtura nga imami i nderuar (autori i librit) në xhaminë dhe komunitetin e tij në Arizona. Me fjalë të tjera, është një botim që u shërben më së miri të gjithë imamëve dhe prijësve të ndryshëm fetarë myslimanë, që duhet me doemos të arkivojnë gjurmët e tyre, duke kontribuar njëkohësisht në ngritjen intelektuale dhe besimore të komunitetit dhe bashkësisë fetare nëpërmjet shkrimit dhe leximit.

Libri përshkohet nga boshti i mirënjohjes ndaj Zotit dhe falënderimit për mirësinë e Tij ndaj autorit, i cili shprehet se: “që në fëmijëri, Zoti (xh.sh.), më ka dhënë mundësinë të qëndroj afër dijetarëve dhe njerëzve të ditur...” - (fq. 85). Këtë mirënjohje e konkretizon që në hyrje të librit, të cilin ua dedikon pikërisht këtyre njerëzve të ditur, që i cilëson si mësuesit e tij të dashur: “të cilët më edukuan me diturinë dhe ndjenjat shpirtërore islame dhe kombëtare” - (fq. 5) dhe përmend në mes tyre, të nderuarit rahmetlinj: H. Sabri Koçi, H. Ahmed El-Haxh El-Ali, Shejkh Vehbi S. Gavoçi etj.



Autori e shpreh qartë, se qëllimi i botimit të këtij libri të ri është: *"Fitimi i kënaqësisë së Zotit dhe kontributi modest në përhapjen e dritës islame, detyrë kjo për çdo besimtar dhe besimtare."* – (fq. 9).

Është me shumë rëndësi për lexuesin të kuptojë se autori ka përzier në këtë libër interpretimet tradicionale me shpirtin mistik të botimeve të vjetra të korifejve të fesë islame në dije, si: Imam Gazali, Imam Razi, Imam Kushejri, Mevlana Rumi etj., duke u dhënë një shije të mrekullueshme intelektuale dhe shpirtërore temave të trajtuara me finesë në 190 faqet e tij.

Në këtë vështrim analitik të librit, kam dëshirë të ndalem në disa momente, që gjykoj se janë të një rëndësie të veçantë në këtë libër dhe njëkohësisht për-kthejnë më së miri metodologjinë e kërkimit shkencor, teologjik dhe intelektual të autorit.

1. BOTA E BESIMIT

Në këtë pikë, autori tërheq vëmendjen e dëgjuesve të ligjëratave të tij dhe lexuesit në libër drejt faktit se: *"Të dërguarit, evlijatë dhe dijetarët e Allahut janë ata që i kujtojnë njeriut origjinën e shpirtit të tij, kthjelltësinë. Ka dhe nga ata shpirtira, uji i të cilëve është përzier aq shumë me dhé, saqë nuk arrijnë të kujtojnë kthjelltësinë e tyre"* (fq. 13).

Ky është një konstatim sa i thjeshtë, aq i thellë, që e bën lexuesin të hyjë në një botë reflektimi, për të analizuar veten, besimin dhe sjelljen e tij në raport me vetë besimin dhe fenë në jetën e përditshme. Këtë autori e konkretizon edhe me fjalët e tij: *"Besimi i patundur dhe i shoqëruar me punë të mira është diell në errësirë për myslimanin dhe argument, që shpirti i tij ka jetuar gjithmonë me Realitetin..."* (fq. 14).

2. BALANCA NË FÉ.

"Balanca në fe, – vazhdon autori, – vjen nga besimi dhe besimtari gjithmonë i balancon punët e tij. Ai nuk është ekstremist dhe e di se ekstremi të dërgon në humbje. Ai nuk bëhet aq i lëshuar, sa të braktisë normat e Islamit, as nuk i kryen këto norma i sforcuar, duke dëmtuar shëndetin e tij dhe duke mos përmbushur në fillim të drejtat ndaj vetes dhe pastaj ndaj të tjerëve." (fq. 18).

Është me vend të flitet sot nëpërmjet medimeve të ndryshme islame rreth mesatarizmit a balancës në fenë tonë, për faktin se ditë pas dite shtimi i dritareve të marrjes së informacionit, shoqëruar me gjendjen e varfërisë dhe padijes, ka arritur të krijojë në mendjen

e shumë myslimanëve (dhe jo vetëm) perceptime të gabuara rreth fesë së tyre. Ky fakt në vetvete, është një ndër shkaktarët e shfaqjeve të gabuara në realitetet besimtare, që krijojnë prishje të balancës dhe devijim nga rruga e mesatarizmit, me të cilën u dërgua Zotëria i bijve të Ademit.

3. NDJEKJA E TRADITËS SË PROFETIT (A.S.)

Kur flet për këtë pikë, duke e renditur nën një kryetitull të madh: *"Shenjat e dashurisë ndaj Profetit Muhamed (a.s.)"*, autori ndalet te një fenomen, që lidhet në logjikë me mungesën e balancës në fé, atë të keqperceptimit të vetë Traditës Profetike dhe si pasojë edhe keqpraktikimin e saj.

Thotë: *"Ka shumë nga ata që pretendojnë se e duan Muhamedin (a.s.), por nuk praktikojnë traditën e tij. Si mund ta duash atë, pa ndjekur udhëzimet e tij? Ka edhe nga ata që ndjekin sekondaret dhe lëjnë mënjanë primaret e traditës së tij ose marrin vetëm atë çfarë u intereson atyre. Për shembull: Ka nga ata që i kush-tojnë vëmendje masës së pantallonave dhe e kanë hedhur pas krahëve vëllazërimin midis besimtarëve."* (fq. 26).

Në një farë mënyre, ai nxit thellimin në dije dhe nevojën e interpretimit të saktë të traditave profetike, duke mos neglizhuar shkallën e rëndësisë së veprimeve mbi këtë bazë.

4. NEVOJA E BASHKËPUNIMIT NDËRFETAR

Autori sjell në vëmendjen tonë një eksperiencë shumë pozitive të dëshmuar prej tij në ShBA: bashkëpunimin e liderëve fetarë për të arritur sa më shumë në eliminimin e paragjykimit, urrejtjes dhe diskriminimit në emër të fesë në shoqëri.

Në realitet, kjo është një thirrje kuranore, ku Zoti i gjithësisë porositi të debatohet e të dialogohet në më të mirën e mënyrave me pasuesit e Librave të Shenjtë. Në një pjesë të librit, autori sjell në vëmendjen tonë konkluzionet e takimit të ndodhur në datën 10 mars 2011 në mesin e drejtuesve fetarë myslimanë, të krishterë dhe hebrenj në shtetin e Arizonës.

Përmend pohimin e tyre të përbashkët të shtatë-pikave, për të cilat dëshmon: *"Ne i pohojmë këto shtatë deklarata dhe mund t'ia shpërndani çdokujt, kudo"*. Është me rëndësi të citoj nga mesi i tyre pikën e parë, ku përmendet se: *"Angazhimi ynë në bashkëpunim për*

paqe nuk do të thotë se ne zgjidhim diferencat në besimet tona të lashta, duke krijuar 'Një fë' imagjinare të botës. Përkundrazi, do të thotë që çdo bashkësi fetare kërkon t'u qëndrojë besnike besimeve të veta të lashta dhe të gjejë brenda këtyre besimeve burimet për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin me dashuri dhe respekt..." (fq. 42).

Në fakt, kjo temë në vete, meriton një përkushtim më të madh nga të gjithë ne, duke u përqendruar te nevoja e zhvillimit të takimeve të ndryshme ndërfitare në drejtim të ruajtjes dhe forcimit të mëtejshëm të frymës së bashkëpunimit ndërfitar në vendin tonë. Personalisht mendoj se ka shumë për të bërë në këtë drejtim, sidomos nga njerëzit e specializuar në shkencat teologjike, që duhet të jenë prijës në këtë drejtim, me urtësi, ndjenjë besimi dhe vlerësim të situatave të ndryshme në shoqëri.

Është shumë me vend të përmendet pika e katërt e deklaratës së nënshkruar nga drejtuesit e lartpërmendur fetarë në Arizona, ku vihet theksi te qëndrimi unanim kundër: "të gjitha formave të persekutimit fetar ndaj hebrenjve, të krishterëve, myslimanëve apo dikujt tjetër" (fq. 43). Kjo është një temë që duhet zhvilluar maksimalisht në vendin tonë dhe në trojet e tjera shqiptare, ku prej dekadash nuk është pastruar akoma njolla e persekutimit fetar.

5. DIMENSIONET E BRENDSHME TË NAMAZIT

Me shumë elokuencë dhe stil gazalian, Imam Didmar Faja trajton dimensionet e namazit, shtyllës kryesore të fesë islame. Duke iu referuar "Ihjasë" së famshme të Imam Gazaliut, ai thekson se: "Drejtimi nga Qabja simbolizon jo vetëm drejtimin e trupit tënd ndaj saj, por edhe largimin e zemrës nga çdo gjë tjetër dhe drejtimin e saj nga Allahu (xh.sh.)... Ulja e kokës dhe shikimi poshtë, është kujtesë për zemrën që të qëndrojë me modesti dhe larg nga mendjemadhësia..." - (fq. 55).

Pa dyshim, kjo temë meriton një lexim të qetë, shoqëruar me meditim dhe reflektim rreth marrëdhënies që ne kemi pesë herë në ditë me faljen e namazit.

6. KUJDESI PËR MJEDISIN

Një temë shumë e rëndësishme, nëpërmjet së cilës dalin në pah shumë elementë të madhështisë së Islamit dhe gjurmëve qytetëruese të Hz. Muhamedit (a.s.), në edukimin e shoqërisë për respektimin e të drejtave legjitime të çdo krijese, përfshi kafshët.

Teksa ndalem te kjo temë, mendoj: "Nëse në fenë islame, që para 14 shekujsh është folur në shumë raste, si në Kuran, ashtu edhe në Traditën Profetike, për të drejtat e kafshëve, po të drejtat e njeriut, për të cilat feja islame akuzohet shpesh për shkelje e dhunim?"

Normalisht, padija dhe tendenca për çudnuese e fakteve konkrete nuk mund të mos akuzojë dritën për errësi-rë? Në këtë kontekst, autori shkruan dhe vërteton se: "Profeti (a.s.), e ndaloi vrasjen e kafshëve së koti dhe tha se atij që vret një zog për dëfrim, zogu do t'i kërkojë të drejtën e tij në Ditën e Gjykimit..." (fq. 58), duke folur gjerësisht edhe për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit të gjerë.

7. DROGA DHE DËMET E SAJ

Kjo është një temë, rreth së cilës autori ka shkruar me shumë maturi, duke e dëshmuar veten edhe si një njohës i mirë i realiteteve të shoqërisë së tij, si pjesë e misionit të shenjtë që mban mbi supe.

Kur flet për fatkeqësinë e përdorimit të drogës, sidomos nga të rinjtë dhe nxënësit e shkollave, ai tërheq vëmendjen e lexuesit për dëmet që sjell ajo, ndalimin e afrimit të myslimanit pranë çdo gjëje të dëmshme në jetë, si dhe qëndrimin islam ndaj këtij fenomeni vrastar. Autori flet edhe për simptomat, dëmet dhe mënyrat e parandalimit të drogës në shoqëri. (Të shihet në fq. 166-168).

Në faqet e këtij libri lexuesi mund të gjejë edhe shumë tema të dobishme, nëpërmjet të cilave do të ketë mundësi të zgjerojë horizontet e tij në lidhje me namazin, agjërimin, vlerat e xhumasë, ruajtjen e gjuhës, veshjen në Islam, rëndësinë e dijes, vlerat e kohës, vetëpërmbytjen nga zemërimi, Hixhretin, Natën e Beraetit, tregtinë e ndershme etj.

Me mbarësi të Zotit, ky libër përmban vlera dhe dije, urtësi dhe analiza të dobishme, sidomos për imamët tanë, teologët, intelektualët dhe besimtarët në përgjithësi.

Autorit i uroj suksese dhe e përgëzoj për këtë hap të rëndësishëm në rrugën e gjatë të afirmimit të tij si një prijës i urtë dhe i ditur, në gjurmët e prijësve të shquar të myslimanëve shqiptarë të Amerikës, si: Salih ef. Myftija, Imam Vehbi Ismaili etj., të cilët bashkuan dijen dhe atdhedashurinë në faltoren e shpirtit, të përlulur para Njësimit të Zotit dhe Vullnetit të Tij, për t'u dëshmuar si thirrës drejt dhuntive të Zotit...

Shkodër, më 20 tetor 2013

Një jetë për të cilën mund të jepet llogari

Xhafer Durmush

Disa ajete në suren el-Kehf na inkurajojnë ta mendojmë e vlerësojmë edhe një herë perceptimin e këndvështrimit të jetës, që Kurani fisnik ka hapur para nesh. Bashkë me ato, që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë në emër të ruajtjes së ekuilibrit dynja-ahiret, përpara na del një rrugë e drejtë...

Allahu i madhëruar thotë:

“Jepu atyre shembullin e jetës së kësaj bote: ajo është si uji që ne e lëshojmë nga qielli; bimësia në tokë përzihet me të, por pastaj bëhet si bar i thatë, të cilin e shpërndan era. Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë!”

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira, që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt, përsa i përket shpërblimit dhe janë më të mira, përsa i përket shpresës (për shpëtim).”¹

Vetëm këto dy ajete, na shfaqin një horizont ndriçues, që të mos humbim në luftën e jetës. Ato na japin mundësinë për të matur se kujt, sa dhe përse duhet t'i japim vlerë...

Shembulli që jepet në ajetin e parë, nxjerr në pah përkohshmërinë e jetës së kësaj bote me një përngjasim që mund ta kuptojnë dhe shikojnë të gjithë. Ai vë në dukje se një njeri, që merr mësim, e shikon shumë qartë etapën e fillimit, zhvillimit dhe mbarimit të jetës së tij edhe në një bimë. Nisur nga kjo, ajeti njofton se njeriu, në vend që të mashtrohet nga stolitë provizore të kësaj dynjaje, duhet të arrijë lumturinë e përhershme duke bërë punë të mira në këtë jetë të shkurtër.

Po ashtu, mund të themi: Cilësia më evidente e Islamit është fakti se ai ndërtohet mbi të vërtetën. Ai

inkurajon që çdo gjëje t'i jepet vlera që meriton. Si shembull për këtë, mund të japim vlerësimet në lidhje me jetën e kësaj bote e të ahiretit, që gjenden në ajete dhe hadithe:

Në Kuranin fisnik theksohet në mënyra të ndryshme se jeta e kësaj bote është provizore. Ndërsa për ahiretin, thuhet se është destinacioni i fundit, ku do të arrijnë njerëzit. Pastaj përshkruhen bukuritë e pashoqe të mirësive që do t'u jepen besimtarëve, të cilët nuk i kanë harruar këto paralajmërime, bashkë me ndëshkimin e tmerrshëm që do të marrin mohuesit dhe mohueset. Me në krye dy versetet e mësipërme, në Kuran përmenden shpesh gjendjet e ahiretit, duke filluar nga realiteti i vdekjes bashkë me ringjalljen dhe llogarinë.

Ajetet në lidhje me ahiretin përsëriten shpesh në suret mekase dhe medinase. Ne e dimë se Kurani fisnik ka përdorur mbi njëqind terma dhe shprehje për të theksuar rëndësinë e kësaj çështjeje nga aspekte të ndryshme.²

Siç kuptohet nga format e ndryshme, të përdorura në Kuranin fisnik, ndërmjet termit ahiret dhe jetës së kësaj bote ka një lidhje shumë të fortë. Në ajete kërkohet që njeriu t'i gjejë një përgjigje bindëse pyetjes: “Nga kam ardhur dhe ku do të shkoj?”

Kjo është e rëndësishme, sepse me anë të kësaj, njeriu e vendos çdo gjë në vendin e vet. Besimi në ahiret, bashkë me vetëdijen e dhënies së llogarisë, zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë te njeriu dhe ia mundëson t'i kontrollojë veprimet. E bën atë më të pjekur në jetë. Besimtarit i jep shansin për ta lartësuar shpirtin, duke e ngushtuar largësinë psikologjike të formuar ndërmjet dynjasë dhe ahiretit.

2. Enciklopedia Islame e Vakëfit të Komunitetit Mysliman Turk, Kapitulli i Ahiretit, Bekir topalogllu, Stamboll, 1988, vëll. 1, fq. 453.

1. Sureja el-Kehf 45-46.

Kurani fisnik u jep besimtarëve një besim të fortë ndaj ahiretit, saqë nuk mund të krahasohet me librat e tjerë hyjnorë. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, në këshillat e tij kërkon që dynjasë dhe ahiretit t'u jepet vlerë sipas asaj që meritojnë. Hz. Pejgamberi, thotë:

"Dyngjaja, në krahasim me ahiretin, ngjan me zhytjen e gishtit në det të ndonjërit prej jush. Kështu që, ai le të shikojë se sa pak ujë mund të marrë me gisht!"³

Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, kërkon një njeri me ekuilibër, që jeton pa u mashtruar ndaj njërës dhe pa nënvlerësuar tjetrën.

Faktikisht, ky hadith e shpreh në mënyrën më të qartë se sa pa vlerë është jeta që bëjmë në këtë botë, kur të krahasohet jeta e përhershme e ahiretit me jetën provizore të dynjasë. Jeta e ahiretit është si një det pa fund, ndërsa jeta e dynjasë është sa uji që merr gishti kur zhytet në atë det. E vërteta që mësojmë këtu, është kjo:

"Pozitat dhe pasuria, që fitohen në këtë botë, nuk ia

3. Muslim, Xhennet, 55.

vlen të lavdërohen." Sepse, siç shprehet edhe në disa hadithe të tjera, *"Jeta e vërtetë, është jeta e ahiretit."*⁴ Nga njeriu kërkohet të mos harrohet një e vërtetë: *"Njeri! Ti je në një lëvizje nga e përkohshmja te e përhershme, e cila nuk ripërsëritet."*

Allahu që na krijoi dhe na dha formën dhe i Cili e di zemrën tonë më mirë se ne, thotë:

"Por ju, përkundrazi, më shumë po parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amëshuar."⁵

Nisur nga ato që thamë më lart, ne duhet të jemi të zgjuar dhe të mos bëjmë gabim në zgjedhjet që mbarin rëndësi jetike. Puna më e mirë dhe më e dobishme, që mund të bëhet pa u mashtruar ndaj të sotmes dhe pa e neglizhuar të nesërmen, është vlerësimi i kohës së tanishme, në të cilën gjendemi. Feja jonë e bukur kërkon prej nesh të bëjmë një jetë, për të cilën mund të japim llogari.

4. Rijadu's-Salihin, Masat e jetës nga Pejgamberi, Botimet Erkam, Stamboll, 2004, vëll. 3, fq. 192.

5. Sureja el-Ala, 87/16-17.

Lexo, Mendo

Kurani ka zbritur për zemrat e gjalla

Veçoria e Kuranit fisnik, i cili quhet edhe "Furkan", është se e ndan në mënyrë të prerë të vërtetën nga e pavërteta. Në ajetin fisnik thuhet:

"E, kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh, thonë: 'Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!'" (Junus, 10/15.)

Në shikim të parë, ky ajet fisnik shtjellon në mënyrë të përgjithshme karakterin e pandryshueshëm dhe imagjinatën e mentalitetit të mendjes së mohuesve, që nuk ka ndryshuar përgjatë shekujve. Ajo është privimi nga sjellja për të dëgjuar bashkëfolësin, edhe nëse thotë të vërtetën më të qartë dhe kërkesa për të ndryshuar një thënie që nuk i përshtatet logjikës së ngushtë të tyre, edhe nëse është fjalë e Zotit...

Si rezultat i këtij ajeti fisnik, në Ruhul-Bejan tërhiqet vëmendja për gjendjen shpirtërore të mohuesit dhe për një specifi-

kë shumë të rëndësishme të Kuranit:

"Kjo shprehje tregon se ata nuk kanë dëshirë të kërkojnë të takohen me Allahun, sepse dashuria është veçori e zemrave të gjalla. Ndërkohë, zemra e mohuesve është e vdekur, ndërsa vetja e tyre është e gjallë."

Në Kurantin Fisnik ka gjëra që përputhen me zemrën dhe që bien në kundërshtim me veten. Për këtë arsye, robërit e vetes nuk mund ta pranojnë atë." (Ruhul-Bejan, Përkthimi dhe komentimi i Kuranit, Botimet Erkam, Stamboll, 2007, vëll. 8, fq. 57.)

Sa herë ta lexojmë, duhet t'ia hapim zemrën Fjalës së Allahut dhe çdo ajet duhet ta pranojmë si një sofër të bekuar që zbret nga qielli. Po ashtu, duhet të përpiqemi t'u ngajmë të devotshmëve, të qëndrojmë larg mohuesve dhe të përfitojmë prej atyre që lexojmë...

Këto duhet të jenë cilësitë dalluese të zemrës së gjallë.

Modestia

Prof. dr. Sulejman Derin



Modestia është njëra prej cilësive më të rëndësishme të personalitetit të myslimanit. Modestia është një cilësi që e lartëson njeriun siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem. E kundërta e modestisë është mendjemadhësia, e cila radhitet ndër cilësitë më të këqija që shkakton zemërimin e Allahut Teala. Shejtani u përzua nga mëshira e Allahut të Lartmadhëruar, pikërisht nga mendjemadhësia. Hazreti Mevlana thotë kështu, në lidhje me këtë çështje:

“O njeri i burgosur në burgun e cilësive të këqija! Shikoje nënshtrimin modest të Ademit dhe mendjemadhësinë e shejtanit! Pastaj ndaji dhe zgjidh nënshtrimin e Ademit!” (Mesnevi, 4, 3343.) Në këtë mënyrë, Hz. Mevlana njofton se modestët shkojnë pas gjurmëve të Hz. Ademit, ndërsa mendjemadhënjtë pas shejtanit. Kundërhelmi i mendjemadhësisë është modestia. Prandaj Sadiu thotë: “Nëse dëshiron të jesh i lartësuar, mos u hiq si i tillë!”

Miqte e Allahut Teala, të cilët modestinë e kanë kultivuar si parim të jetës së tyre, janë për ne shembuj të shkëlqyer. Një mëngjes feste, Bejazidi Bestami kishte dalë nga hamami dhe po ecte. Befas, nga një shtëpi iu hodh në kokë një legen me hi të nxehtë. Edhe pse Bejazidi u përlye i tëri, nuk shfaqti asnjë shenjë zemërimi, madje, ngriti duart për të bërë dua dhe e falënderoi Zotin (xh.sh.). Atyre që e pyetën për këtë, u tha: “A nuk duhet ta falënderoj Zotin (xh.sh.), që shpëtova me pak

hi të nxehtë, ndërkohë që nefsi meriton zjarrin?”

Hz. Hasan el-Basriu e ka përkufizuar modestinë në këtë mënyrë:

“Modestia është vetëpranimi se çdo mysliman që takon, është më i mirë se ti.” Siç thuhet edhe në Mesnevi, Allahu Teala e ka krijuar njeriun nga dheu dhe dëshiron që ai të jetë turabi, domethënë, modest si dheu. Në ajetin 55 të sures Taha, Allahu Teala njofton se në fund, njeriu do të kthehet në dhe, do apo nuk do ai, duke thënë:

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.”

Shumë njerëz mendjemadhënj, që e shihnin veten të lartë, janë kthyer në dhe të poshtëruar dhe në mënyrë të ulët.

Njëra prej sëmundjeve më të mëdha shpirtërore në ditët e sotme, është mungesa e modestisë. Mjekimi i kësaj sëmundjeje është me të vërtetë i vështirë. Ajo mund të shërohet vetëm me edukim shpirtëror. Edhe disa besimtarë në rrugën e përshtetshmërisë, nuk mund të shpëtojnë menjëherë nga sëmundja e mendjemadhësisë, e cila është fshehur nën perden e modestisë. Sepse egoja e njeriut gjithmonë dëshiron lartësim dhe respekt. Imam Gazaliu ka thënë:

“Njeriu dëshiron të vlerësohet nga të tjerët. Nëse vlerësohet, dëshiron që ta duan. Nëse e duan të gjithë,



atëherë dëshiron ta madhërojnë. Madje disa, siç ka ndodhur në shembullin e Faraonit, mund të duan që t'u bëjnë edhe sexhde." Për këtë arsye, myslimani duhet ta ketë të qartë pozitën e tij në shoqëri dhe të jetë i zgjuar kundrejt kurtheve të nefsit.

Një mik i Allahut Teala na paralajmëron në lidhje me këtë çështje, duke na thënë:

"Ii i kujdesshëm në dënimin e Faraonit, sepse, a do të ishe modest edhe ti po të kishe aq ushtri të madhe, aq saraje, aq pasuri dhe aq shërbëtorë?"

Ata që e dinë se në të vërtetë çdo gjë është e Allahut Teala, i cili është Maliku'l-Mulk, çdo lloj mirësie si pasurinë, bukurinë dhe dijen e shohin si mirësi të Allahut të Lartësuar dhe nuk ia atribuojnë vetes. Ndoshta këto i bëjnë ata të ulin ndikimin e egos dhe ta shtojnë falënderimin ndaj Krijuesit. Ndërsa, ata që kanë karakter të dobët, bëhen mendjemëdhenj dhe fillojnë të mburren, sapo t'u jepet ndonjë mirësi. Dëshirojnë, që çdo gjë të rrotullohet rreth tyre dhe të ulen në krye të vendit. Ata presin respekt dhe vlerësim, duke u mburrur me shërbimet, që pohojnë se i kanë bërë për hir të Allahut Teala.

Ne nuk duhet të mashtrohemi prej modestisë së rrejshme të njerëzve të tillë. Modestia e tyre i ngjan modestisë së lypësit. Ata kanë shumë respekt për të pasurit, por kur gjejnë ndonjë më të varfër, shfaqin sjellje krejt të tjera.

Allahu Teala në Kuran, njofton se thur kurthe. Sipas Ibn Arabiut, kjo tregon se Allahu Teala i sprovon robërit e Tij me mundësitë e kësaj bote, edhe pse e di cilësinë e tyre. Robi mund të jetë i varfër dhe bëhet i pasur. Mund të jetë nëpunës policie dhe bëhet shef. Mund të jetë njeri i zakonshëm dhe menjëherë mund të bëhet i famshëm. Ja pra, këto gjendje janë gjëra të ndryshme, që Allahu Teala ia jep njeriut për t'i matur modestinë.

Shumë pak njerëz i kalojnë me sukses këto sprova. Allahu i Madhëruar i përkufizon kështu këta robër të Tij në Kuranin Fisnik:

"Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: Paqe qoftë!" (Furkan, 63.)

Sipas Hz. Mevlanës, modesti do të thotë, që njeriu të shohë gabimet e tij. Vetëm ata që shohin gabimet e tyre mund të përparojnë në fushën e përshtetshmërisë. Ata që e pëlqejnë veten, duke u larguar nga deti i gjerë i modestisë, i bëjnë shumë dëme vetes dhe atyre që i rrethojnë. Nëse kësaj mendjemadhësie i shtohet edhe lakmia, siç thuhet edhe në hadith, shkaktojnë dëme më të mëdha se sa dëmet që një ujë i uritur i jep kopesë së deleve. Në Mesnevi thuhet:

Sado që njeriu i kapur nga sëmundja e mendjemadhësisë ta shfaqë veten modest dhe të thjeshtë, ti mos u

mashtro nga pamja e pastër e ujit të përroit që në fund ka papastërti... (3217)

O ti njeri, që e fsheh sëmundjen e egoizmit nën perden e modestisë dhe thjeshtësisë, nëse dikush të zemëron, të emocionon apo të ngatërron, me qëllim që të të sprovtojë, uji në të cilin gjenden papastërti, turbullohet dhe del në pah ngjyra e papastërtisë.

O ti i ri! Sado që lumi i ekzistencës tënde ta tregojë veten të pastër dhe pa llum, mos u mashtro! Në fund të tij ka papastërti, që po pret çastin e turbullimit.

Hz. Mevlana na këshillon të bëjmë kujdes ndaj shfaqjeve të modestisë së rrejshme, duke e analizuar njeriun si një psikolog. Sepse modestia e vërtetë del në pah, kur njeriu ka të bëjë me ndonjë gjë kundër vetes dhe interesave të tij.

Disa njerëz, që në kohë normale duken të butë dhe modestë, bëhen shumë ofendues dhe mendjemëdhenj kur ndodh ndonjë gjë kundër tyre. Fjalitë si: "A e di se kush jam unë?" – janë shenjat më të qarta të kësaj psikologjie. Ndërsa burrat që ndjekin rrugën shpirtërore, jo vetëm që nuk nxehen, por e mposhtin veten e tyre me shumë se çdokush. Ndërkohë që njeriu modest përhap ndjenjat e modestisë te njerëzit përreth, njeriu mendjemadh përhap iluzione boshe të mburrjes. Prandaj njeriu duhet të qëndrojë larg mendjemëdhenjve.

Sadiu transmeton në Bostan:

Një njeri mendjemadh erdhi te një shejh dhe i kërkoi diçka. Atë ditë shejhu nuk kishte asgjë për t'i dhënë. Ky njeri i paturpshëm, doli jashtë dhe filloi të flasë keq për shejhun. Kur njëri prej muridëve ia tregoi këto fjalë shehut, ai qeshi dhe tha:

"Fjalët e lypësit nuk janë asgjë. Ai ka thënë shumë pak gjëra në lidhje me gabimet e mia. Ato që ka thënë ai, janë vetëm një për qind e atyre që di unë. Ai është njohur me mua këtë vit. Nga do t'i dijë ai gabimet e mia përgjatë shtatëdhjetë viteve? Unë nuk kam parë njeri që mendon kaq mirë sa ai. Nëse në mahsher ai do të jetë dëshmitari i vetëm i mëkateve të mia, nuk do të frikësohem nga xhehenemi."

Njeriu duhet të marrë mësim nga historitë e miqve të tillë të Allahut Teala. Ai duhet të largohet nga mendjemadhësia, që është një sëmundje djallëzore dhe të përvetësojë modestinë. Sigurisht, nuk është e drejtë, që një mysliman ta poshtërojë veten duke menduar se do të bëhet modest.

Sjellja me modesti për interesa të kësaj bote, veçanërisht kundrejt të pasurve, është prej veprave që e vrasin fenë e njeriut. Për këtë arsye, njeriu duhet ta dijë mirë vendin dhe kohën e modestisë. Modestia nuk duhet të perceptohet si sjellje prej dallkauku. Nuk duhet të harrojmë se të shfaqësh mendjemadhësi kundrejt mendjemëdhenjve, konsiderohet një lloj sadakaje.



Sulbe të zgjedhura

Ferid Piku

ZOTI E PËLQEN përsosmërinë

Profeti (a.s.), thoshte gjithmonë: “Zoti ka dëshirë që, kur dikush prej jush të bëjë një punë, ta përsosë atë!”

Nëse ke dëshirë të dish se si do të flasin njerëzit për ty, atëherë mos fol për veten tënde, por lere punën të flasë për ty. Le të tregojë puna jote se kush je ti sa je gjallë dhe se kush ishe ti, pasi të vdesësh. Nëse doni të dini se si punon Zoti i gjithësisë, atëherë mjafton të ngremë sytë drejt qiellit e të shikojmë gjithë këtë hapësirë. A ka defekt apo boshllëk në të?

Dielli lind në një vend të caktuar dhe perëndon në një vend të caktuar. Po ashtu edhe hëna, yjet dhe planetet lëvizin në mënyrë të përsosur. Krijimi që bën Allahu (xh.sh.), është perfekt dhe i përsosur. Mjafton të shikosh veten tënde dhe do të bindesh për madhësitinë e Krijuesit. Sikur të lihej krijimi i njeriut në dorën e vetë njeriut, ai nuk do të kishte mundësi të bënte as 1/10 e asaj që ka bërë Zoti i gjithësisë.

Nëse shikon një vegël që ka dhjetë mekanizma, të cilat me kalimin e kohës vazhdojnë të punojnë në mënyrë perfekte, a nuk do t'i ishte mirënjohës atij, që e ka bërë këtë vegël, duke pohuar se ai është i përsosur në punën që ka bërë?

Tani shiko krijesat e Allahut (xh.sh.). Ato nuk janë 10, por janë me miliarda. Askush përveç Allahut, nuk e di numrin e saktë të krijesave të Tij. Të gjitha janë të përsosura dhe nuk mund të gjesh asnjë të metë në to.

Universi ku jetojmë është shumë i vjetër, madje ne nuk e dimë se sa është mosha e tij. Por megjithatë, nuk arrijmë të shohim asnjë përplasje, asnjë defekt, asnjë mangësi në gjithë universin, i cili është krijesë e Allahut (xh.sh.).

Njerëzit i ndërrojnë përditë makinat e tyre, telefonat dhe gjithçka kanë. Kjo do të thotë se njeriu gjithmonë

zhvillohet dhe e përmirëson punën e tij. Ndërsa njeriu si krijesë nuk ka ndryshuar dhe gjithmonë do të jetë i përsosur, sepse nuk ka defekt në krijesën e Allahut (xh.sh.). E si mund të ketë defekt, kur vetë Allahu thotë në Kuran: “**Kjo është krijesa e Allahut, i Cili ka përsosur gjithçka.**” (Sexhde, 7.) Ngriji sytë drejt qiellit dhe mundohu të gjesh ndonjë boshllëk. Të jesh i sigurt se do të të ulen sytë të lodhur dhe nuk do të kesh forcë për të shikuar përsëri, sepse nuk mund të gjesh mangësi në krijimin e Allahut (xh.sh.). Allahu është i përsosur, Ai është perfekt. Kur Ai krijon diçka, e krijon në formën më të mirë.

Këtë dëshirë edhe prej njeriut, krijesës së Tij më të privilegjuar. Dëshirë që kur unë dhe ti si njerëz të bëjmë një punë, ta bëjmë atë në formën më të mirë të mundshme. Zoti i do shumë ata që punojnë, por i do shumë më tepër ata, që kur punojnë, e bëjnë punën siç duhet. Zoti nuk i do ata njerëz, që e bëjnë punën e tyre shkel e shko.

Feja jonë asnjëherë nuk ka qenë fe e fjalëve, asnjëherë nuk ka qenë fe e librave apo e debateve. Ajo ka qenë fe e punës, fe e modelit, fe që e shikojnë njerëzit. Prandaj profetët kanë qenë njerëz, në mënyrë që t'i shohin të tjerët se si punon një besimtar. Hasan el Basriu thoshte: “Nuk matet besimi me fjalë të bukura, as me çfarë vesh ti, por besimi matet me çfarë ke në zemër dhe çfarë bën ti”. Besimin e vërteton puna. A ta vërteton puna atë që ke në zemër?

A e dini si e ka emrin grada më e lartë në fenë tonë? E ka emrin **IHSAN**, që do të thotë ta bësh punën të përsosur. Xhibrili (a.s.), e pyeti profetin Muhamed (a.s.): “Ç’është ihsani o Muhamed? Profeti (a.s.), tha: “*Ta adhurosh Allahun sikur po e sheh me sy e, meqë ti nuk e sheh me sy Atë, të jesh i bindur se Ai të shikon ty*”²

Kryejë adhurimin, bëje çdo punë prej punëve të

1. **Hadith i pranuar.** Bejhakui në Shuabul iman (4930, 4931). Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar.

2. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (9)

dynjasë sikur po të shikon Zoti në çdo moment dhe ji gjithmonë i vëmendshëm për këtë, sepse vetëm kështu do ta bësh punën perfekte dhe në formën më të mirë të mundshme. Këta janë myslimanët më të mirë, këta janë besimtarët më të mirë.

Feja jonë na fton që ta perfeksionojmë namazin tonë.

Kur të marrësh abdes, merre abdesin mirë, kur të vish në rresht, mbaje rreshtin drejt, se Zoti nuk e pëlqen atë saf (rresht), që është i shtrembër. Feja të fton të dëgjosh imamin, ta respektosh veprimin e tij, të bësh siç bën ai deri në fund. Ky është namazi i besimtarëve, prandaj Zoti nuk thotë **"Falni namaz"**, por thotë **"Kryejeni namazin"**. Ka një ndryshim të madh mes faljes, që e bën shpejt e shpejt për të kryer borxhin e mes kryerjes së namazit, gjatë të cilit ti përqendrohesh dhe mundohesh të jesh sa më i përqendruar para Zotit.

Shikoni gjithashtu edhe agjërimin apo zekatin. Gjithçka është në kohën e duhur, gjithçka ka rregullat e duhura.

Zoti i gjithësisë na fton të jemi njerëz perfektë me prindërit tanë.

Zoti nuk thotë thjesht respektoje prindin, thjesht jepi të hajë e të pijë e të mbushë barkun e tij. Allahu nuk kërkon prej nesh thjesht të mos i ofendojmë ata, por na urdhëron të jemi perfektë, të jemi të përsosur në sjelljen ndaj prindërve tanë. Për këtë ka forma nga më të ndryshmet. Mundohu t'i hapësh zemrën, që prindi të të nxjerrë hallet e jetës së tij, të të tregojë vuajtjet e jetës së tij, t'i puthësh dorën, t'i marrësh hallallëkun, t'i marrësh bekimin. Kjo është të jesh i përsosur dhe i respektueshëm ndaj prindërve.

Zoti na fton të jemi të përsosur në marrëdhëniet tona bashkëshortore.

Burri të mundohet jo vetëm të sigurojë ushqimin dhe strehën për gruan e tij, por t'i fitojë asaj zemrën, se mbi të gjitha është njeri. Por edhe gruaja të mundohet të fitojë zemrën e burrit dhe fëmijëve të saj. Ajo punon dhe gatuan gjithë ditën dhe kur vjen fundi, e servir ushqimin shkel e shko. Ky nuk është respekt, kjo nuk është përsosje e marrëdhënieve bashkëshortore.

Zoti na fton, që edhe në përshëndetje, të jemi më të mirët.

Allahu thotë: **"Kur të përshëndeteni me një përshëndetje, kthejeni në formën më të mirë"**. Nëse dikush të thotë "Esselamu alejkum", ti shtojë pak dhe thuaj "Ue alejkum selam ue rahmetullah", sepse jemi urdhëruar ta

bëjmë edhe më të mirë. Nëse dëshiron ta bësh edhe më të mirë se kaq, shikoje tjetrin në sy, jepi dorën, pyete si e ka hallin, si e ka punën. Bëji të gjitha këto, sepse Zoti ka dëshirë që kur dikush prej nesh bën punë, ta bëjë atë në formën më të mirë të mundshme.

Islami na mëson të sillemi në mënyrë të përsosur edhe me xhenazen, me kufomën.

Profeti (a.s.), ka thënë: *"Kush qefinos xhenazen, ta qefinosë mirë atë."*³ *Kush hap varrin, ta thellojë e ta përgatisë sa më mirë atë."*⁴ Kur njëherë vdiq një djalë i ri, profeti Muhamed (a.s.), u thoshte shokëve të vet: *"Rregullojeni këtë pjesë, futeni në këtë formë etj."* Kur vuri re se njerëzit po e shikonin me habi dhe mendoi se ndoshta këta njerëz po krijojnë përshtypjen, që kjo është kusht në varreza, tha: *"O njerëz, varri nuk i bën as dëm e as dobi njeriut, por Zoti ka dëshirë që, kur dikush prej nesh bën një punë, ta bëjë atë në formën më të mirë."*⁵ Edhe këtu në këtë vend tregohet respekti dhe korrektesa ndaj krijesave, që kanë ndërruar jetë dhe kanë shkuar tek Allahu (xh.sh.).

Në çdo punë mundohu të jesh i përsosur, të jesh korrekt, ta bësh në formën më të mirë të mundshme, sepse Profeti (a.s.), thoshte: *"Zoti ka obliguar të jeni të mirë e të përsosur në çdo punë që bëni. Edhe kur therni kurbanin tuaj, mpriheni mirë thikën tuaj dhe rehatojeni kurbanin tuaj"*⁶

Ky është myslimani. Ai mundohet të jetë korrekt në çdo aspekt të jetës së tij, mundohet ta bëjë punën e tij në formën më të mirë të mundshme, që ajo të ketë vlerë tek Zoti, por të ketë vlerë dhe respekt edhe te njerëzit.

Shikoni shembullin tonë, profetin Muhamed (a.s.). Ai nuk ishte vetëm profet i madh, por ishte njeri i madh, ishte korrekt. Shikoje rininë e tij! Ai ka qenë punëtor krahu, ka punuar bari, por të gjithë e përmendin për korrektesën e tij. E bënte punën e tij në formën më të mirë. Ai ka punuar tregtar, madje në fillim punonte për tregtarët më të mëdhenj, por të gjithë e përmendin si njeriun më besnik, njeriun më të shkathët e më të aftë. Për këtë arsye, Hatixheja (Zoti qoftë i kënaqur me të), pranoi të martohej me këtë njeri, sepse njerëz të tillë ishin të rrallë. Ai ishte bashkëshort i suksesshëm, njeri korrekt dhe prind i mirë. Kur u bë profet, ishte njeri që nuk priste mrekulli prej Zotit, por derdhte djersën e tij,

3. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (943)

4. **Hadith i vërtetë.** Tirmidhiu (1713) dhe Ibn Maxheh (1560). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

5. **Hadith i pranuar.** Bejhakui në Shuabul iman (4932). Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar.

6. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (1955)



jepte maksimumin e tij.

Shikoni hixhretin e tij!

Ai nuk tha: "O Zot më sill një melek t'i hipi në shpinë e të shkoj nga Meka në Medinë, por vendosi një plan strategjik, që rrallë njerëz mund ta vendosnin, pikërisht për t'u thënë të gjithë atyre që besojnë në Zot: "Tregojë veten tënde, bëje punën tënde".

Shokët e tij nuk kanë qenë të fjetur, kanë qenë njerëz shumë të shkathët, shumë të zotë, njerëz strategë. Halid bin Uelidi ishte strategu i madh i myslimanëve. Aftësia e tij ka dalë në pah në shumë raste. Mjafton të përmendim një rast në betejën e Muttës, ku 3.000 myslimanë ballafaqohen me 200.000 ushtarë nga pala kundërshtarë. Bëje vetë krahasimin: 3.000 para 200.000.

Tre komandatët e ushtrisë myslimane u vranë njëri pas tjetrit. Pas tyre, komanda i kaloi pikërisht Halid Ibn Velidit. Ai e pa se ishte e pamundur një fitore në kushte të tilla, kështu që mendoi t' i shpëtonte myslimanët. E kaloi krahun e djathtë të ushtrisë në anën e majtë, ndërsa të majtin në krahun e djathtë. Ata që ishin para i çoi mbrapa, ata që ishin mbrapa i nxori para. Ndau 300 kalorës në gjashtë çeta dhe u tha: "Përplasni këmbët tuaja dhe të kuajve tuaj dhe ngrini pluhurin lart, që armiku të mendojë se po na vjen ndihmë. Ndryshoni rrobat tuaja dhe bërtisni me tekbiir". Ushtarët filluan të përplasnin këmbët dhe kuajt filluan të ngrënë shumë pluhur. Në këtë moment, ushtria armike u bind se myslimanëve po u vinin në ndihmë. Sapo e vuri re këtë gjë, Halidi u sul në fushën e betejës dhe zuri rob 1000 kundërshtarë. Kështu ai arriti t' i shpëtonte besimtarët dhe Profeti (a.s.) e falënderoi për këtë. Këta ishin shokët e Muhamedit (a.s.), njerëz që i përmend historia dhe sot çdokush e studion taktikën ushtarake të Halid Ibn Uelidit.

Po ta shikojmë punën e pjesës më të madhe të njerëzve, do të shikojmë se ata nuk janë korrektë, nuk janë të ndërgjegjshëm, nuk kanë përgjegjësi në punën që bëjnë. Pse vallë? Kjo ndodh, sepse ka disa probleme dhe sëmundje në zemrat e tyre.

Sot ka pak besim te Zoti dhe njeriu që nuk ka besim te Zoti, nuk e bën punën me ndershmëri, pasi mendon se nuk e shikon askush. Ai që ka frikë Zotin, nuk e bën kurrë punën shkel e shko, sepse e di se mbi të gjitha është nën mbikqyrjen e Allahut (xh.sh.).

Njerëzit sot punojnë keq, sepse nuk kanë ndërgjegje. Tregtari nuk turpërohet, nëse ia kthen mbrapsht mallin, i cili mund të jetë i prishur apo i skaduar. Madje edhe nëse i thua: "Turp të kesh për punën që ke bërë", ai përgjigjet: "S'ka problem, se ia shes ndonjë tjetri".

Njerëzit sot janë të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm, sepse janë egoistë. Shumë njerëz i ngajjnë atij punëtorit, i cili thotë: "Çfarë fitoj unë duke u lodhur kaq shumë? Unë jam punëtor, pronari e merr fitimin,

prandaj nuk duhet të lodhem shumë." Kështu ai e bën punën e tij shkel e shko, sepse e mat punën e vet vetëm me paratë e tij.

Njerëzit sot janë të papërgjegjshëm, sepse janë të pangopur me pasuritë e kësaj dynjaje. Dikush e fillon punën në një vend dhe kur i del një variant tjetër, e bën të parën shkel e shko për të kapur punën e dytë. Por ai të jetë i sigurt se do të marrë vetëm rrizkun e vet, madje nëse vepron kështu, përveç rrizkut të tij do të marrë turpin përpara njerëzve në këtë botë dhe dënimin e përgjegjësinë te Zoti në botën tjetër.

Është një fakt i hidhur, që morali i papërgjegjshmërisë po shtohet dita – ditës në popullin tonë. Ne e shikojmë dhe nuk kemi çfarë të bëjmë. Shikojmë rrugë, që bëhen sot dhe pas një jave prishen dhe të duket se kjo rrugë është ndërtuar para 200 vjetësh.

Ne shikojmë ustain, që të vjen në shtëpi dhe rregullon një mobilje, por sapo ai del nga shtëpia, ajo prishet. Shikojmë pallate, për të cilët paguhen miliona e miliona, të cilët, po t'i shikosh me vëmendje, i gjen me defektet më elementare.

Ne shikojmë njerëz me profesion, që nuk respektojnë profesionin e tyre, qofshin këta mjekë, inxhinierë, mësues e kështu me radhë.

Morali i papërgjegjshmërisë është nga moralet më të këqija që mund të ekzistojnë. Njerëzit që nuk kanë përgjegjshmëri dhe nuk e ndjejnë se punën që po bëjnë, fillimisht po e bëjnë për veten e tyre e jo për të tjerët.

A dëshiron ta masësh punën tënde? A dëshiron ta masësh punën e popullit tënd?

Shikoje një mall, i cili thotë "Made in Albania" (prodhuar në Shqipëri). A do ta blije ti atë? A do ta preferojë atë apo një mall tjetër, që prodhohet në një vend tjetër?

Nëse në vendin tonë mbretëron neglizhenca e moskorrektesa, atëherë, si do t'i bindim ne njerëzit e tjerë të blejnë prej nesh, të na marrin ne punëtorë e të drejtojmë punët e tyre?

Unë i bëj një apel vetes sime dhe gjithë myslimanëve që i lexojnë këta rreshta, madje edhe atyre që nuk lexojnë, por që duan të arrijnë sukses, ta shohin më ndryshe këtë punë, se kurrë s'do të bëjmë përpara, nëse nuk e bëjmë punën me ndershmëri e me djersën e ballit, që tjetri të thotë: "Faleminderit prej filanit". Ndoshta mund të punosh tek dikush vetëm një herë në jetën tënde dhe nuk ke për ta shikuar më kurrë atë person, por në këtë kontakt ai e vlerëson punën tënde, prandaj mundohu të lësh shenja të mira tek ai, se hakun tënd do ta marrësh patjetër, por edhe llogari do të japësh për çdo gjë që ke bërë.

Unë e ftoj çdo njeri që fal namaz, të jetë korrekt me Zotin e gjithësisë në namazin e tij, të mundohet ta krye-

jë namazin në mënyrën më të mirë e të mos e falë atë shkel e shko. Mos e kryej namazin tënd si dhelpira, se je përpara Atij, i Cili është perfekt e i përsosur e t'i zbret të mirat e Tij një nga një. Ai nuk është neglizhent ndaj teje, kështu që edhe ti mos ji neglizhent ndaj Tij!

Nëse je punëtor, mundohu ta bësh punën tënde. Mundohu që, kur të derdhësh djersën e ballit, të futësh edhe kënaqësinë tënde, në mënyrë që ai njeri që do të shijojë punën tënde, të marrë dhe bekimin dhe hallallin tënd.

Nëse je pronar, mundohu të jesh korrekt dhe stimuloje punëtorin që është korrekt, që është i përsosur në punën e tij.

Nëse je mësues, jep mësim me kënaqësi, se ndoshta një nxënës do të ketë kontakt me ty vetëm njëherë, por gjithmonë do të të mbajë mend për mirë.

Nëse je nxënës, jepi hakun punës tënde, thellohu, mëso, derdhe djersën, se Zoti nuk u jep atyre njerëzve që nuk mundohen.

Nëse je prind, ji korrekt ndaj fëmijëve të tu dhe mundohu t'i mësosh ata, që kur ta bëjnë një punë, ta bëjnë mirë atë, të mos e bëjnë shkel e shko.

Nëse je bashkëshort, mundohu të jesh korrekt, kushdo qofsh ti.

Mundohu të jesh korrekt në punën tënde. Fundja, ti përgjegjësinë e ke me Allahun (xh.sh.). Njerëzit i neglizhojnë punët e vogla dhe thonë: "S'ka problem se punë e vogël është kjo", por është vërtetuar se e keqja e madhe ka ardhur gjithmonë nga punët e vogla.

Do tregoj dy ngjarje, që mendoj se kanë lidhje me këto që thamë.

E para bën fjalë për një fabrikë shumë të madhe makinash në Japoni. Ajo kishte qenë një fabrikë shumë e suksesshme, por me kalimin e kohës filluan të vijnë ankesa njëra pas tjetrës, filluan të ndodhin aksidente me këto makina dhe u ngritën shumë padi në gjyq.

Kur pronari i fabrikës analizoi situatën, pa që problemi ishte te njëra nga gomat e makinave, që dilte gjithmonë, kur makina arrinte shpejtësi të madhe. Ndodhnin përplasje dhe vdisnin njerëz. Ai analizoi dhe gjeti se problemi ishte te një punëtor, puna e të cilit ishte shumë e thjeshtë. Ai duhet të shtrëngonte vetëm bullonat e njëres gomë. Mirëpo, ai gjithmonë e neglizhonte punën e tij dhe thoshte: "Ç'problem ka? Aq e madhe sa është makina, çfarë problemi mund të shkaktojë një bullon?" Pronari pa që ky punëtor kishte marrë në qafë gjithë fabrikën me neglizhencën e tij. Ai nuk e dëboi atë nga

puna, por i mblodhi të gjithë punëtorët dhe u shpjegoi gjendjen, në të cilën ndodhej fabrika, e cila rrezikonte të mbyllej. Atëherë ky punëtor u ngrit dhe tha: "Unë jam përgjegjës sepse kurrë s'e kam menduar se puna ime kishte kaq shumë rëndësi!"

Ngjarja e dytë bën fjalë për një marangoz, i cili ishte mjeshtër dhe kishte punuar gjithë jetën e tij. Ishte njeri shumë i mirë. Kur erdhi koha që u plak, i tha pronarit: "Më jep leje, se dua të shkoj në shtëpi të rri me fëmijët, me nipërit e mbesat e mia. Pronari i lutet që të rrijë dhe i ofroi më shumë para, por ai këmbënguli që të largohej. Atëherë pronari i thotë për herë të fundit: "Kam vetëm një kërkesë përpara se të ikësh. Dua të më bësh një shtëpi prej druri, ashtu siç të ka hije ty, siç i shkon dorës tënde." Mirëpo punëtori ishte lodhur dhe, meqë kjo ishte puna e fundit, e bëri atë shpejt e shpejt. Zgjodhi një dru të kalbur, me qëllim që ta mbaronte punën sa më shpejt. Pasi e mbaroi shtëpinë, i thotë pronarit: "Urdhëro çelësin, tani unë po iki!" Pronari ia kthen:

"Unë dua të ta shpërblej dhe të të falënderoj shumë për këtë që ke bërë. Unë e kisha bërë nijet këtë shtëpi për ty, në mënyrë që të të falënderoja për punën që ke bërë deri tani për mua, prandaj merre se është e jotja." Ustai u mendua dhe tha me vete: "Ky paska qenë rrisku im, unë i tillë paskam qenë dhe të tillë shpërblim paskam merituar".

Kur besimtari ta bëjë punën dhe të besojë se e bën atë si për veten e tij, atëherë kanë për të ndryshuar gjendjet tona.

Po e mbyll me një hadith të profetit Muhamed (a.s.), i cili thotë: "Askush prej jush, nuk ka për të besuar plotësisht, derisa të dojë për tjetrin, atë që do për veten e tij".⁷

Kur të arrish këtë nivel, atëherë hallall të qoftë puna jote, hallall mudi yt dhe vetëm atëherë myslimanët do të ndryshojnë.

E lus Zotin e gjithësisë të na ndihmojë për mirë, të na largojë nga e keqja, të na bëjë njerëz të përgjegjshëm, korrektë, njerëz me ndërgjegje, njerëz që kur e bëjnë punën e tyre përpara të tjerëve të presin fjalën e mirë, por edhe kur të dalin përpara Zotit, të shpërblehen nga Allahu (xh.sh.). O Zot, na bëj njerëz, që qoftë edhe me një punë të vetme japin shembullin e bukur të Islamit. O Zot, na bëj shembull për mirë dhe mos na bëj shembull për keq.

Amin!

7. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (13) dhe Muslimi (45)



HURMA E ARABISË, MULTIVITAMINA MË E MIRË NË BOTË

Hurma shërben për një sërë sëmundjesh, si: anemia, dobësimi i përgjithshëm i organizmit pas kalimit të ndo-një sëmundje, gjëndrat tiroide, dhimbjet e barkut si dhe në lehtësimin e lindjeve normale të grave shtatzënë.

Ato janë burim i shkëlqyeshëm i fibrave natyrorë për organizmin dhe funksionim të mirë të zo-rrëve. Sheqeri natyror, i cili gjendet te hurma, është al-ternativë e përsosur për sheqerin e zakonshëm. Ajo përmban rreth 17 për qind sheqer kur është e freskët dhe 62 për qind kur thahet. Hurmat kanë spektër të gjerë të vlerave shëndetësore dhe ushqyese, për shkak të të cilave konsi-derohet si pema më e shëndetshme në botë.

Sipas përbërjes së tyre hurmat janë tableta të vër-teta multivitaminash natyrorë, që mund t'i përdorin fëmijët dhe të rriturit. Hurmat janë burim i shkëlqyer i hekurit, për shkak të përmbajtjes së luteinës dhe ze-aksantinë, hurma quhet edhe "vitamina për sy".

Në këtë rast anemie apo dobësimi trupor, këshillohet të përdoret mjekimi me hurma, ku çdo ditë konsumohen 6 deri në 15 kokrra të pjekura rreth një orë para ose pas



ushqi-
mit për 15 ditë deri në 25
ditë.

Hurmat kanë dhënë rezultate të mira në luftimin e sëmundjeve të aparatit tretës si dhe diarresë kronike. Gjithashtu, shumë të sëmurë nga gjëndrat tiroide, kanë pasur përmirësime të dukshme pas përdorimit me bollëk në racionin ditor të frutave të hurmës.

KOLESTEROLI DHE ARRAT

Për të funksionuar në mënyrë duhur, organizmi ynë ka nevojë për një sasi kolesterol. Ndërkaq, duhet të dimë që në gjak ka kolesterol të mirë dhe të keq, ku shumica e kolesterolit të keq, çon deri tek rreziku i sëmundjes së zemrës, rritjes së presionit të gjakut dhe të hemorragjisë në tru.

Kolesteroli i keq (LDL) është ai që krijon shtresa në arterie, ndërsa kolesteroli i mirë (HDL) është ai që sjell kolesterolin e keq përkatësisht yndyrën në mëlçi.

Niveli i kolesterolit në gjak tek njerëzit e shëndet-shëm është i balancuar. Për organiz-min është i mirë niveli HDL, më i lartë se sa niveli LDL. Kur niveli i kolesterolit të keq rritet, vjen deri tek rritja e depozitave në arterie dhe deri tek dëmtimi i rruazave të gjakut dhe kështu ka mundësi që këto rruaza të blloko-hen.

Në nivelin e kolesterolit ndikon neg-ativisht: pirja e du-hanit, alkooli,



mosaktiviteti fizik, ushqimi i parregullt, lodhja e tepërt, mbipesha, të ftohtit, infeksionet, stresi, lodhja psikofizike, lodhja kronike, rregullimet hormonale dhe disa faktor tjerë.

Kolesteroli i tepërt mund të ulet në sajë të përdorimit të arrave.

Hulumtimet e reja shkencore thonë, se nëse hani një grusht arra, në çast fitoni mbrojtje të sëmundjeve të zemrës. Konsumimi i rregullt i arrave do t'ju ofrojë mbrojtje afatgjatë.

Shkencëtarët kanë paraqitur përmirësim të dukshëm

të niveleve të kolesterolit dhe fleksibilitet të rruazave të gjakut, që ndihmon në qarkullimin e mirë të gjakut, vetëm katër orë pasi pacientët kanë konsumuar arra apo vajin e arrave.

Sipas fjalëve të doktoreshës Peni K. Eterton e cila punon në Universitetin e Pensilvanisë, konsumimi i një grushti arrash katër herë në javë, mund të ulë dukshëm rrezikun e sëmundjevetë zemrës.

Arrat janë të pasura me omega-3, gjithashtu përmbajnë sterole bimësh dhe vitamina E, e të gjitha këto ulin kolesterolin dhe mbrojnë rruazat e gjakut.

USHQIMET TË CILAT ULIN NDJENJËN E URISË

Për të reduktuar ndjenjën e urisë është e nevojshme të ndiqet një ushqyerje korrekte dhe të ekuilibruar. Më poshtë po ju paraqesim disa ushqime që zbusin ndjenjën e urisë e të cilat duhet t'i dini domosdoshmërisht për të marrë rezultatet që ëndëroni dhe sigurisht të humbni peshë.

Çaji jeshil: Është konsideruar i dobishëm për të larguar dëshirën e ngutshme për të ngrënë më shumë, edhe pse mund të ketë kaluar shumë pak kohë nga vakti i fundit. Sipas ekspertëve, katekina, e cila ndodhet në çajin jeshil, pengon transportimin e glukozës në qelizat yndyrore dhe në këtë mënyrë ngadalësohet edhe rritja e nivelit të sheqerit në gjak.

Molla: Mollët e çdo lloji kanë vetinë të zvogëlojnë ndjenjën e urisë për disa arsye shumë specifike. Në radhë të parë, ato janë të pasura me fibra të tretshme dhe pektin, e cila ndihmon për të rritur ndjenjën e ngopjes. Së dyti, mollët rregullojnë nivelin e glukozës së gjakut dhe rrisin energjinë tonë. Së fundi, ngrënia e një molle kërkon një kohë të gjatë për ta përtypur, gjë që e ndihmon trupin për t'i dhënë më shumë kohë atij për të kuptuar se si të mos jetë më i uritur.

Bajamet: Ngrënia e bajameve mund të konsiderohet si një bazë e mirë antioksidantësh magnezi dhe vitamine E. Bajamet mund të konsi-



derohen si një meze e lehtë e shëndetshme kundër urisë.

Xhenxhefli: Prej shekujsh, xhenxhefli është konsideruar si një ushqim i spikatur me veti tretëse. Xhenxhefli mund të përdoret në përgatitjen e pjatave të ndryshme në formën e erzës, por edhe në formën e tij të freskët.

Kanella: Kanella është konsideruar si një nga erëzat më të rëndësishme të kontrollit të oreksit. Veprimi i saj lidhet në mënyrë të veçantë me rregullimin e nivelit të sheqerit në gjak.

Spinaqi: Një ushqim tjetër që ul ndjenjën e urisë është spinaqi dhe në përgjithësi të gjitha perimet me gjethe jeshile. Ato janë të pasura me shumë kalori, e që pikërisht për shkak të kësaj karakteristike na ndihmojnë të ndiheni të ngopur për orë të tëra. Ata janë të gjitha të pasura me fibra dhe mund të hahen të papërpunuara, të ziera, ose të fërguara lehtë në një tigan me vaj ulliri ekstra të virgjër.

Speci i kuq: Sipas një hulumtimi të kohëve të fundit, një gjysmë lugë çaji me spec të kuq (piper të kuq) do të ishte e mjaftueshme për të përsheptuar metabolizmin tuaj dhe për t'i lejuar trupit të djegë 10 kalori ekstra. Tek ata që zakonisht nuk konsumojnë ushqimet pikante, shtimi i piperit të kuq mund të kontribuojë në një ulje prej 60 kalorive, gjatë vaktit tjetër. Në këtë mënyrë, ju mund të humbisni peshë thuajse pa e kuptuar, e ndërkohë do të zvogëloni ndjenjën e urisë.

NUMRI I BANKAVE ISLAMIKE NË RRIJTJE



Përdorimi i bankave islamike, i të ashtuquajturave banka me pjesëmarrje, po bëhet gjithnjë e më i preferuar në Turqi. Statistika e shoqatës turke të bankave me pjesëmarrje (TKBB) tregon, se që prej vitit 2006, sektori i bankave islamike në Turqi është rritur me 25 deri 30 për qind në vit. Në fillim të këtij viti ishin rreth 800 filiale me gjithsej katër banka islamike. Aktualisht numri i tyre ka arritur në 900. Ndër bankat me pjesëmarrje janë "BankAsya", "TürkiyeFinans", "KuveytTürk" dhe "AlbarakaTürk". Tri prej katër bankave janë të rajonit të Gjirit Persik.

Bankat me pjesëmarrje mbulojnë rreth pesë për qind të sektorit bankar turk. Për zëvendëskryeministrin Ali Babaxhan; "kjo përqindje është përtej asaj që pritej. Megjithatë bankat me pjesëmarrje duhet të zotëronin një pjesë më të madhe, për t'u mundësuar sa më shumë njerëzve këtu aksesin në financim. Në këtë mënyrë sektori financiar mund të bëhet më gjithëpërfshirës."

Bankat me pjesëmarrje bazohen në të drejtën islame. Sipas Kuranit, interesat bankare janë të ndaluara - ato as duhet të kërkohen, as duhet të paguhen. Në këtë mënyrë bankat islamike nuk lejohet të japin kredi me interesa. Por ndarja e fitimeve është e lejuar. Bankat e

zakonshme i mbledhin paratë me pagimin e interesave. Përkundrazi, bankat me pjesëmarrje i mbledhin paratë në kuadër të një marrëveshjeje fitim/humbje. Banka me pjesëmarrje në këtë mënyrë nuk jep para hua, por i nxjerr fitimet e saj nga tregtia. Marrëdhënia me klientin është në këtë mënyrë një marrëdhënie tregtare.

"Ne jemi shumë pranë klientëve tanë dhe e dimë me saktësi se për se përdoren paratë tona. Në institutet bankare të zakonshme, kredimarrësi mund t'i përdorë paratë që merr kur të dojë dhe për se të dojë. Rrjedha e parave është më pak transparente. Kurse llogaritë rrjedhëse bankare te ne janë partneritete. Këto llogari rrjedhëse mund të nxjerrin fitim, vetëm kur nxjerr fitim edhe banka. Kur banka shënon humbje, llogaria rrjedhëse duhet të bëhet pjesë e kësaj humbjeje", thotë Osman Akjyz, sekretar i përgjithshëm i bankave me pjesëmarrje.

Bankat islamike janë aktive edhe në vende jomyslimane. Në vitin 2010, "Kuveyt Turk bankë me pjesëmarrje" hapi një filial në Mannheim dhe që prej vitit 2004 ekziston "Banka islamike e Britanisë" me gjithsej katër filiale në Britaninë e Madhe.

SIRI, SHPËRTHEN POLIOMIELITI

Së paku 22 persona - shumica e tyre foshnje, janë sëmurë nga poliomieliti në Siri, ka raportuar Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Ky është shpërthimi i parë i sëmundjes në vend që prej 14 vitesh. Qysh kur lufta civile e Sirisë filloi në vitin 2011, rreth 95% e fëmijëve janë vaksinuar kundër sëmundjes, por Unicef vlerëson se rreth 500.000 fëmijë nuk janë imunizuar nga sëmundja e cila mund të rezultoj si fatale.

OBSH tha se qendrat e shpërthimit të epidemisë janë lagjet lindore të DeirEzzor. Dy raste tashmë janë

të konfirmuara nga analizat laboratorike, ndërsa OBSH pret konfirmimin përfundimtar laboratorik të mbi 20 rasteve të mbetura për javën e ardhshme.

Poliomieliti prek kryesisht fëmijët e moshës nën pesë vjeç. Kjo është një sëmundje shumë ngjitëse që shkaktohet nga një virus i cili sulmon sistemin nervor. Simptomat përfshijnë ethe, lodhje, dhimbje koke, të vjella dhe dhimbje gjymtyrësh. Një në 200 raste çon në paralizë të pakthyeshme. Ndonëse në zhdukje e sipër, poliomieliti vazhdon të jetë i pranishëm në Afganistan, Nigeri dhe Pakistan.

JAPONEZËT I MËSUAN ROBOTIT ECJEN E NJERIUT

Inxhinierët e Institutit japonez të "technikës robotike të ngjashme me njeriun" (HRI) i mësuhan robotit antropomorf "Wabian-2" ecjen njerëzore. Robotët ezakonshëm androide për hedhjen e hapit duhet të thyejnë fort gjunjët.

Ndërkohë që ecja në përgjithësi duket e pasigurt dhe me lëkundje. Si rezultat i studimeve të kryera nga HRI u morr vendimi për t'i shtuar rripit të

transmisionit të gjymtyrëve të poshtme të robotit disa shkallë lëvizshmërie. Nëveçanti, "Wabian-2" u pajis me një legen (pjesë e trupit) shumë të lëvizshme dhe një shkallë të madhe lëvizshmërie në artikulacionet coxale. Falë punimeve suplementare ecja e robotit "Wabian-2" tashmë të kujton më shumë atë të një qenie njerëzore.



DRITARJA "INTELIGJENTE" QË RREGULLON NXEHTËSINË



Një dritare "inteligjente" që rregullon nxehtësinë diellore mund të prodhojë më shumë energji duke qenë sa më transparente, koncept inovativ i prezantuar në revistën "Nature Scientific Reports" nga një ekip kinez.

Mjediset me dritare, mjaft të këndshme për komfortin e jetesës, që përdoren gjerësisht në ndërtimin e banesave, janë burim i humbjes në sasi mjaft të mëdha të nxehtësisë në dimër, ndërsa në verë pothuajse e transformojnë zyrën apo apartamentin në një furrë gatimi.

Parimi i dritareve të emëtuara "inteligjente", të cilat u quajtën kështu pasi ato përshtaten më së miri me kushtet e jashtme atmosferike dhe kështu reduktojnë shpenzimin e energjisë nëpër banesa, për ngrohje në dimër dhe ftohje në verë.

PLANETI "JETIM"

Një planet që lundron në hapësirë, pa ndjekur një orbitë: ky është zbulimi më fundit i shkencëtarëve të Institutit të astronomisë në Universitetin e Hawai. Ata kanë gjetur këtë trup qiellor "të vetmuar", që nuk rrotullohet rreth ndonjë ylli, rreth 80 vite dritë larg nga Toka.

"Nuk kemi parë kurrë një objekt që flluskon në gjendje të lirë në hapësirë. Pyesja shpesh veten nëse këto objekte ekzis-

tonin vërtetë, tani kemi konfirmimin", ka thënë Michael Liu, një prej shkencëtarëve që ka marrë pjesë në studim.

Në të vërtetë një planet i ngjashëm është zbuluar në vitin 2012 nga disa astronomë kanadezë. Trupi qiellor blu është arritur të vëzhgohet fal fashës së nxehtësisë së dobët. PSO J318.5-22 është një planet shumë i ri, i krijuar rreth 12 milionë vjet më parë dhe është rreth 6 herë më i madh se Jupiteri.

